



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 8 DHE 12 MARS 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 8. I 12. MARTA 2013. GODINE**

**MARS - MART
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
5. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2013,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit,
9. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje Akcionog plana za pregovaranja Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju,
5. Razmatranje Programa rada Skupštine Kosova za 2013. godinu,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Državnoj advokaturi,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o penzijskim fondovima Kosova,
8. Razmatranje Izveštaja Komisije za ljudska prava, ravnopravnost polova, nestala lica i peticije o nadgledanju sprovođenja Zakona protiv diskriminacije,
9. Razmatranje Izveštaja o radu Komisije za Izbornu reformu za period 22. april 2011. do 29. avgusta 2012. godine.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

Në koordinim me Grupin joformal të grave deputete, unë kisha propozuar që t'ia jepni fjalën kryetares së Gruas, sepse i kemi koordinuar qëndrimet, edhe pse ky propozim ishte nga ne si Parti Demokratike, por e falënderoj edhe kryetaren dhe koleget tjera nga grupet tjera parlamentare. Kështu që, do t'ia kisha deleguar fjalën kryetares së Grupit të Grave.

KRYETARI: Kjo pikë e rendit të ditës është: Koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Për mocion, pasi ta kryejmë këtë pikë, se edhe numrin e deputetëve për votim nuk e kemi. Fjalën e ka deputetja Teutë Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Sot është 8 Marsi. Është Dita Ndërkombëtare e Gruas. Dhe, në Grupin e Grave Deputete i kemi 40 gra, të cilat kanë shprehur dëshirë që ditën e 8 Marsit të mos e festojnë vetëm, por të jenë pjesëmarrëse dhe ta festojnë së bashku me ato gra, të cilat kanë më tepër nevojë që të festojnë, që të jenë me gratë nga vendet e tyre, që të jenë me gratë, të cilat nuk kanë pasur mundësi të kenë një mbështetje dhe kur të vijë koha e deklarimit për rendin e ditës ne do të kërkojmë shtyrje.

Por, pasi që është pika e deklarimeve jashtë rendit të ditës, unë do ta kisha shfrytëzuar rastin që të flas për 8 Marsin, që të vendos paralelen me herën e kaluar, kur një vit më parë në Kuvendin e Kosovës është mbajtur seanca e iniciuar nga Grupi i Grave Deputete dhe është mbështetur nga një numër i madh i burrave.

Seanca nuk ishte solemne, por ishte seancë pune, e cila bënte analizën e situatës së gruas kosovare, pozitën e saj, brengat dhe, si përfundim, dolën rekomandimet, të cilat u miratuan me konsensus, me pajtueshmëri të plotë, pa vota kundër.

Një vit më parë kërkuam drejtësi dhe trajtim të veçantë për gruan e dhunuar gjatë luftës, e cila nuk ishte vetëm viktimë rasti nga ndonjë huligan, por ishte shënjestër e planifikuar lufte, nëpërmjet së cilës mëtohej shkaktimi i plagëve të rënda dhe afatgjata në shoqëri.

Këto gra, të cilat e përshpejtuan ardhjen e lirisë dhe të cilat në shpirtin e tyre e mbajtën peshën e rëndë të plagëve të luftës, për të cilat u kujdes familja, shumë shpesh mbetën të vetmuara dhe të stigmatizuara dhe pa përkrahjen e familjes dhe shoqërisë.

Një vit më vonë shohim një mobilizim të shtuar edhe të shoqërisë civile, një ndjeshmëri të shtuar të të gjithë shoqërisë. Dhe, kërkojmë që këto gra të kenë trajtim të veçantë dhe dënimin e kriminelëve, që shkaktuan jo vetëm plagë në trup, po edhe plagë në shpirt.

Në rekomandimet e vitit të kaluar ishte edhe fuqizimi ekonomik i gruas dhe përdorimi i fondeve të veçanta strukturale për këtë, promovimi i barazisë gjinore nëpër tekste shkollore dhe largimi i pjesëve, të cilat ndikojnë në formimin e stereotipave në gjeneratat e ardhshme.

Dhuna në familje si njollë e zezë, e cila ende po merr buzëqeshjen nga fytyrat e grave dhe fëmijëve dhe familjen, e cila do të duhej të ishte vend i lumturisë, i përkrahjes, i ndihmës, po shndërrohet në vend të dhunës, të vajit, e jo në pak raste po përfundon me vrasje, si rasti i Diana Kastratit.

Rasti i Dianës tregon dështimin total të sistemit të drejtësisë në mbrojtje të qytetarëve, si në mbrojtjen fizike të saj, në mungesën e dënimit të vrasësit, por edhe në dhënien e fëmijës në familjen e dhunuesit.

Në fund të vitit 2012, GGD e propozoi Rezolutën për Parimet e Prishtinës, e cila përsëri kaloi pa vota kundër, rezolutë, e cila ndërmjet rekomandimeve kërkon që në vitin 2050 të kemi 50% të pjesëmarrjes së gruas në institucione, rezolutë kjo e cila ka hasur në interesim dhe përkrahje nga shumë institucione ndërkombëtare. Në largësi prej një viti vërejmë një angazhim të shtuar, por edhe një bashkëpunim më të ngushtë dhe më të koordinuar me agjendën dhe me strukturat e grave deputete me gra nga komunat, nga të gjitha partitë politike, nga të gjitha nacionalitetet, me gra nga Kosova dhe vendet e regjionit dhe më gjerë.

GGD vazhdon të ketë bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore, me shoqërinë civile shumë aktive, me gra nga Universiteti, nga biznesi, nga organizata ndërkombëtare.

Në largësi prej një viti vërejmë mirënjohje për punë dhe respekt për rezultate nga organizatat e ndryshme. Në raportin e Këshillit të Evropës për Kosovën, në mënyrë eksplicite përmendet kontributi i grave parlamentare dhe kërkohet involvimi më i theksuar i tyre në strukturat e Këshillit të Evropës. Nga ambasadori i OSBE-së, zoti Schlumberger, pastaj kemi pasur përkrahje nga zoti Zhbogar i BE-së, nga presidenti i BERZH-it, Chuk Rabatri, dhe vlerësim shumë i rëndësishëm për respektin ndaj punës dhe kontributit të gruas kosovare nga kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi, i cili kurrë nuk e ka kursyer përkrahjen për fuqizimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare. Dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdo fjalën!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit!

...në largësi prej një viti vërejmë që së bashku i kemi lëvizur gjërat, por gjithashtu vërejmë që kemi edhe shumë për të bërë dhe nëpërmjet fuqizimit të gruas ta fuqizojmë familjen, rrethin tonë dhe shtetin tonë.

Të nderuara gra dhe vajza të Kosovës,
Urime 8 Marsin, e në vitin e ardhshëm festofshim më shumë suksese!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Edhe unë, në emër të udhëheqjes së seancës, urimet më të mira për Ditën e Gruas, duke dëshiruar një fuqizim vërtet më të madh, edhe politik, por edhe ekonomik.

Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pas 14 vjetësh na thërret zëri dhe ndërgjegjja. Edhe pas 14 vjetësh, zëri i tyre është kudo mes nesh. Ato ecin, por ne nuk i shohim. Ato jetojnë, por ne nuk i vërejmë. Ato na thërrasin, e ne nuk i dëgjojmë. Emri i tyre nuk është si padukshmëria, që ne e kemi akorduar. Ato janë gratë dhe vajzat e dhunuara gjatë luftës së fundit.

Shumë prej jush këtu jeni dëshmitarë të dëshmive të tyre të heshtura, e shumë prej jush jeni dëshmitarë të rrëfimeve të tyre anonime në Gjykatën e Hagës, në raportet e hulumtimit të organizatave vendore e ndërkombëtare. Ju secili e dini, apo keni dëgjuar nga një histori, që ka ndodhur në fshatin a qytetin prej nga vini.

Ne e ndërmorëm një nismë, jo para shumë muajve, me shpresën se secili deputet në këtë legjislaturë do të ishte i gatshëm ta mbështeste, duke qenë se kjo është një mbështetje për to, e jo për ne.

Iniciativa quhet Projektligji për ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe për familjarët e tyre. Në të parashikohet nisja dhe rregullimi institucional i këtyre rasteve, si dhe mundësia e kompensimit të tyre, pas evidentimit.

Kjo iniciativë për momentin nuk ka gjetur mirëkuptimin tuaj, deputetë të Kuvendit të Kosovës. U referohem Komisionit për Shëndetësi dhe Komisionit për Financa, ku tashmë është shqyrtuar dhe është refuzuar ky projektligj.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ju bëj thirrje në emër të tyre, se e kemi për detyrë ta ndreqim këtë padrejtësi, e cila rëndohet çdo ditë nga heshtja e secilit prej nesh. Është në nderin e burrave dhe grave të këtij vendi, të të zgjedhurve të tyre, që t'ua njohin sakrificën, dhembjen dhe drejtësinë atyre vajzave dhe atyre grave.

Në rast se edhe ne, përfaqësueset e tyre në institucione, heshtim, ato do të heshtin përgjithmonë. Krimi ndaj tyre do të harrohet, sepse ai nuk u njoh kurrë, as në institucionet e Kosovës së çliruar.

Andaj, ju bëj ftesë grupeve parlamentare që t'i shqyrtojnë edhe një herë qëndrimet e tyre nëpërmjet këtij ligji, me të cilin do të njihej krimi ndaj tyre dhe do t'u mundësohej lehtësimi i jetës së tyre sadopak. Faleminderit!

KRYETARI: Po ju njoftoj deputetë, që e keni kërkuar fjalën. Sot është pika e deklarimeve jashtë rendit të ditës për gratë deputete. Fjalën e ka deputetja Donikë Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, sot edhe pse është 8 Marsi, unë do ta ngre një nevojë të përgjithshme të një reforme në shoqërinë tonë, e cila nuk lidhet vetëm me gratë, por me theks të veçantë për shkak të specifikave, edhe më tepër është barrë e rëndë për gratë e Kosovës, që janë 50%-shi i popullsisë dhe po e them atë që e thanë edhe koleget më parë, për shkak të së kaluarës dhe për shkak të së tashmes e bartin barrën më të rëndë.

Është shumë e vërtetë që në shoqërinë tonë ka nevojë për reforma të thella në ekonomi, në arsim, në shëndetësi, në zhvillim ekonomik dhe për më shumë mirëqenie. Këto ndryshime kanë nevojë të ndodhin, jo vetëm për gratë, por edhe për burrat. Mirëpo, duke marrë parasysh që gratë janë kapitali më i çmuar, profesionalizmi i të cilave nuk është shfrytëzuar nga kjo shoqëri, unë sot do të jap sloganin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me qëllim që t'u uroj festën e 8 Marsit të gjitha nënave, në rend të parë, dhe grave të Kosovës, me shpresë që shumë shpejt do ta kemi një shtet, ku burrat të kenë të drejta dhe asgjë më shumë dhe gratë të kenë të drejta dhe asgjë më pak. Edhe një herë, urime!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët dhe ministrat,

Duke marrë parasysh se sot është 8 Marsi, Dita Ndërkombëtare e Gruas, dua shumë pak të flas në këtë aspekt, për arsye se gratë janë ato të cilat vetë e pozicionojnë vendin e vet brenda shoqërisë dhe shoqëria në bazë të ligjeve, që ne i miratojmë brenda këtij Kuvendi të Kosovës, ua jep hapësirën në të cilën mund të kalojnë ato.

Uroj që vajzat, gratë dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, jo vetëm në këtë festë të grave sot, por edhe në të gjitha festat tjera, të mendojnë që në të ardhmen e kanë borxh të punojnë akoma për Kosovën, të punojnë për fëmijët e tyre dhe të punojnë për një Kosovë më të mirë, e cila do të jetë pjesë e BE-së dhe pjesë e NATO-s. Faleminderit!

KRYETARI: Nga SLS-ja, nuk ka të lajmëruar. Grupi "6+", kryetarja Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: Sayın Başkan!

Sayın Bakanlar, çok değerli milletvekilleri ve değerli hanımefendiler,

Bugün 8 Mart Dünya Kadınlar Günü. İnsanlığın varoluşundan bu yana kadın, erkeğiyle birlikte doğaya, topluma, ailesine eş değerde katkı sunmaktadır. Hatta birçok yerlerde kendini önde göstermektedir.

Kadının eğitilmiş, kültürlü, başarılı olması ailenin, toplumun başarılı olması demektir.

Eğitilmiş, çalışkan anne, eğitilmiş çocuk yetiştirir, eğitilmiş çocuk eğitilmiş birey demektir. Her eğitilmiş birey eğitilmiş toplum demektir.

Bu yüzden eğitilmiş, çalışkan, dünyanın en yeni ülkesi olan Kosova'nın, Avrupa ve dünya ülkelerine ayak uydurması için cinsiyet eşitliğini göz önünde bulundurarak, kadının yeri ve rolüne dikkat ememiz gerekir.

Yasalarımız gereğince 120 milletvekili yerine kotamızı yüzde 50'ye çıkararak 60 olmasını sağlamamız gerek.

Karar alma mekanizmalarında kadının sayısı artmalı.

Ancak anneler olarak da ailelerimizde kız çocuklarının erkek çocuklardan farklı değil, tam aksine eşit yetiştirilmesiyle başlaması gerekirken, kadının erkeklerden hiçbir farkı olmadığını göstermektedir.

Kadın kızımızdır, ablamızdır, annemizdir, kadın toplumun temelidir. Onu hak ettiği yere taşımamız gerekir.

Bu düşünce ve duygularla tüm kadınlarımızın 8 Mart Dünya Kadınlar Günü kutlar sağlıklı, huzurlu, başarılı olmasını temenni ederim. Saygılar!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë po u bashkohem këtyre urimeve të kolegeve të mia. Mirëpo, unë e kam një temë që sot nuk korrespondon me 8 Marsin. E kam një temë dhe do ta nge një çështje, për të cilën ditëve të fundit u rikërkua një sqarim për një symbyllje tonën si deputetë. Fjala është për legjitimitetin e të qenit kryetar të Komisionit të Pavarur të Mediave, zotit Shefki Ukaj.

Kërkesat e shoqërisë civile dhe një pjese të përfaqësuesve të mediave për të konstatuar në si anëtarë të Komisionit Parlamentar, nëse Shefki Ukaj vërtet e kishte fshehur postin e të qenit anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës në momentin e kandidimit, i përgjigjem me 'po'.

Në kohën kur Ukaj kishte aplikuar për anëtar të KPM-së, në CV-në e tij e kishte fshehur postin e këshilltarit komunal nga radhët e LDK-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës. Kjo është e ndaluar me Ligjin e KPM-së, ku neni 12, pika 1,3 e specifikon shumë qartë se personat që mbajnë post publik, të zgjedhur dhe të emëruar, apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy vjetëve të fundit nuk mund të jenë anëtarë të KPM-së.

Këtë CV si dosje, të nderuar kolegë të mi deputetë, mund ta shihni secili në Administratë. Dhe, aty vërtet, vendin ku kërkohet të deklarohet vendi aktual i pozitës, ai e lë të zbrastë. Pra, justifikimi i Ukajt se ka dhënë dorëheqje posa është zgjedhur, nuk ka asnjë logjikë, pasi që në start, kur e dorëzoi aplikacionin, ai ishte jashtë ligjit.

Anëtarët e Komisionit ad hoc normalisht që u kanë besuar deklaratave të secilit kandidat, derisa nuk është vërtetuar e kundërta. Shefki Ukaj e ka fshehur postin që e kishte pasur në Kuvendin Komunal të Prishtinës, pasi ky fakt do t'i pamundësonte zgjedhjen e tij anëtar i KPM-së.

Të nderuar kolegë deputetë,

Një institucion si Komisioni i Pavarur i Mediave, i cili është kategori kushtetuese, nuk besoj se mund të ketë në krye akoma një kryetar, i cili është i kontestuar në bazë zgjedhjes së tij.

Pra, ishte kundërshtim me ligjin, posaçërisht në momentin kur ai kandidoi. Nëse themi se ne e kemi votuar, ne vërtet e kemi votuar, mirëpo ne nuk e kemi ditur faktin se në momentin kur ka aplikuar, ai e kishte fshehur këtë të dhënë.

Mua më vjen jashtëzakonisht keq, nëse sot është 8 Marsi dhe nuk korrespondon me këtë ndjenjë të festës, megjithatë jam e detyruar si anëtare e Komisioni Parlamentar për Media të kërkoj që sot nga zoti Ukaj që të japë dorëheqje, të na lejojë ne që të vazhdojmë me procedurat tjera, ta zgjedhim një kandidat, i cili edhe mund të jetë pastaj anëtar apo simpatizues i ndonjë partie, mirëpo jo anëtar i Kuvendit Komunal.

Më lejoni ta theksoj nenin 12 të Ligjit të KPM-së, i cili decidivisht thotë: "Personat publikë, që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar, apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy vjetëve të fundit...". Pra, është e ndaluar që të aplikojnë, e lëre më të zgjidhen.

Po e përmend edhe një fakt. Zoti Ukaj, edhe kur kishte aplikuar, nuk e kishte vetëm këtë ndalesë, mirëpo komisioni e kishte anashkaluar faktin, sepse kur ai kishte aplikuar nuk kishin kaluar plotësisht dy vjet që kishte qenë si këshilltar i ministrit. Pra, ishin dy fakte, të cilat ia ndalonin këtë.

Kuvendi i Kosovës mund ta shkarkojë me shumicë të thjeshtë të votave, mirëpo unë shpresoj që zoti Ukaj e ka kuptuar që me të vërtetë nuk mund të qëndrojë në një pozitë, kur kontestohet legjitimiteti, pra kontestohen edhe vendimet që sjell ai. Faleminderit!

KRYETARI: Ju e dini rendin e ditës. Unë po e bëj një kërkesë për deputetët. Për çështjet e kësaj natyre, komisionet bëjnë raport dhe mund të radhitet në rendin e ditës, por jo të shfrytëzohet kjo pikë e rendit të ditës për çështje të tilla.

Ju lutem, nuk kemi debat. Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Kryetar, faleminderit!

Edhe unë sot pata të flas diçka krejt tjetër, jo për 8 Marsin, dhe nuk pata definitivisht të flas për Këshillin e KPM-së dhe shkeljet që i bën.

Foltorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës vetëm sa u keqpërdor nga deputetja Musliu. Është mirë që deputetët e PDK-së të dalin e të flasin se si është zgjedhur Blerim Rexha kryeshef ekzekutiv i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Është ky institucion, i cili po shet gjithë pasurinë e Kosovës dhe e kemi njeriun i cili është në Këshillin e Përgjithshëm, në Këshillin Drejtues të PDK-së.

Mandej, dje në Komisionin për Buxhet dhe Financa ka ardhur propozimi për guvernator i zotit Bedri Hamza. Nëse dikush nga kjo seancë mund të tregojë dhe mund të dëshmojë që Bedri Hamza, që ishte ministër i Financave deri dje në Qeverinë Thaçi dhe zëvendësministër në Qeverinë një të Thaçit, nëse mund të thotë që është person apolitik, atëherë unë koleges deputete Izmaqu duhet t'i them 'të lumtë'.

Kreu XII i Kushtetutës, përkatësisht neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës tregon që Banka Qendrore e Kosovës është institucion i pavarur dhe duhet të udhëhiqet nga persona apolitikë.

Neni 40 i Ligjit për Bankën Qendrore të Kosovës, pika e 3 e tij, thotë definitivisht që këta persona, personat vendimmarrës në Bordin e Bankës Qendrore të Kosovës nuk duhet të jenë persona politikë, dhe dje ne kemi pasur 'luftë' në komision duke treguar që Bedri Hamza e meriton mbështetjen e komisionit, sepse ka qenë shumë korrekt në raport me Komisionin. Thuhet se ne jemi deputetë që duhet respektuar kolegalitetin. Ne duhet ta respektojmë korrektësinë. Kjo domethënë që keqpërdorimet e tilla nuk mund të bëhen dhe ne nuk lejojmë që qytetarëve të Kosovës t'u hidhet pluhur syve, se kinse Shefki Uka qenka këshilltar në Asamblenë Komunale të Prishtinës, e paska shkuar në KPM dhe qenka bërë nami.

Duhet shikuar disa gjëra më të mëdha. Kush është ai që po e shet pasurinë publike dhe ndërmarrjet shoqërore të krejt Republikës së Kosovës, nën agjendën e kujt dhe nën dirigjimin e kujt? Pikërisht nën agjendën e PDK-së dhe të kryeministrit Hashim Thaçi. Prandaj, mos lejoni më që foltorja të keqpërdoret. Faleminderit!

KRYETARI: Unë kam drejtë t'ia tërheq vërejtjen, por fjala është juaja. Fjala është juaja, nuk mund ta ndryshoj. Jo e dini cila pikë e rendit të ditës është. Ju lutem! Kymete Bajraktari e ka fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Thonë se durimi ka rrënjë të thella për frytet e ëmbla. Por, për çështjen që dua ta ngre sot, kjo thënie është e kotë.

Një vendim i zotit kryeministër, i datës 15.5.2008, në atë kohë me siguri ishte mirëpritur dhe përshëndetur, duke e admiruar vullnetin dhe përkushtimin e tij. Por, ç'ë do zoti kryeministër, edhe vendimi juaj nuk u respektua nga vartësit tuaj. Është dëshpëruese që 5 vjet më vonë iniciativa e marrë nga punëtorët arsimorë të përsëritet.

Deputetëve të Kuvendit, kryeparlamentarit, MASHT-it, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, nga punëtorët e arsimit do t'u dërgohet një kërkesë për vlerësimin e sistemit arsimor shqiptar në Republikën e Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin 1998/99 për zgjidhjen e statusit të punës dhe barazimin e statusit të tyre me personat e merituar kundër pushtetit okupues serb.

Shqetësuese është se përse vendimi i datës 15.5.2008, i marrë nga kryeministri, nuk u realizua.

Vendimi në përmbajtje është i qartë, kur thuhet: "Miratohet iniciativa që t'u njihet stazhi i punës të gjithë mësimdhënësve, stafit administrativ dhe teknik në institucionet arsimore, të cilët kanë punuar në periudhën që nga viti 1990 deri më 1999. Për zbatimin e vendimit obligohet MASHT-i".

I kujt është faji? Me siguri, i burokracisë që zhvillohet në institucionet tona. Në thonjëza kjo. Mjaft, zoti kryeministër, kemi pritur që të realizohet vendimi juaj. Me siguri që të gjithë janë kureshtarë për ta ditur arsyen e moszbatimit të këtij vendimi dhe kështu, zoti kryeministër, na epni mundësinë që të supozojmë se ndoshta këtë herë në fushatën elektorale nuk mund t'u premtoni punëtorëve të arsimit rritje të rrogave. Dhe, ju kështu po e ruani asin nën mëngë: "Për kontributin, punën dhe përkushtimin tuaj, ne do të jua njohim stazhin e punës dhe ta barazojmë statutin me personat e merituar për rezistencën që keni treguar gjatë okupimit serb". Ky do të jetë premtimi i zotit kryeministër. E ne do të merremi me llogaritjen e shumave, në varësi me stazhin e punës. Ata që e ruajtën frymën dhe shpirtin e këtij populli pritën plot 5 vjet në zbatimin e vendimit tuaj. Ta ruajmë dinjitetin dhe sakrificën e atyre që krijuan optimizëm për rezistencën aktive dhe të mos i lëndojmë në vazhdimësi, zoti kryeministër. Nuk e di se si po ndiheni ju, por moszbatimi i vendimit të kryeministrit mua më bënë të ndihem keq. Mospërfillje totale!

Zoti kryeministër, e ritheksoj: ke marrë vendim më datën 15.5. 2008, që mësimdhënësve t'u njihet stazhi i punës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!

S obzirom da je danas Međunarodni dan žena, želim da se od srca pozdravim i čestitam svim pripadnicima lepšeg pola, bez obzira na nacionalnu i versku pripadnost, svim ženama na Kosovu ovaj međunarodni dan žena, da ih požalim puno sreće, zdravlja i uspeha u životu, i da ih pozovem da se uključe u sve tokove demokratskog društva, da budu deo reforme u našu zemlju i tranziciji. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Faleminderit për mundësinë që na e dhatë sot që edhe një herë për nder të Ditës së Nënës ne ta ndajmë kuptimin me të gjitha ato gra, me ato nëna dhe motra, të cilat e kanë ruajtur me shekuj familjen shqiptare, por edhe kanë kontribuar shumë në rezistencën dhe për të mirën e shtetit tonë.

Është mirë që një vit më parë është mbajtur një debat i gjatë, kur ka pasur diskutime të shumta, nga të cilat kanë dalë edhe rekomandimet, të cilat edhe ne si deputetë i kemi votuar. Dhe, ajo që unë sot dua të them është që ne ta kemi parasysh një rezolutë, e cila është miratuar dhe e cila mbështet Parimet e Prishtinës që kanë dal nga Samiti Ndërkombëtarë i Gruas, që është mbajtur në Prishtinë, dhe të kontribuojnë që gratë sadopak të jenë të lira dhe të jenë të përfaqësuara në të gjitha instancat, duke përfshirë nivelin qendror deri te niveli lokal, ato të jenë të përfaqësuara denjësisht. Faleminderit!

KRYETARI: Me këtë diskutim është shteruar koha për këtë pikë. Më vjen keq prej deputetëve burra që janë lajmëruar për fjalë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në këtë seancë janë parashtruar 11 pyetje parlamentare. Deputetja Ganimete Musliu, nuk është këtu. Deputeti Berat Buzhala, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministri nuk është këtu. Deputet, do ta bësh pyetjen? Jo.

Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputete, do ta marrësh fjalën? Urdhëro!

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja ime është drejtuar për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Rashiq.

Zoti ministër! Në vitin 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë rritjen e pensioneve në Kosovë. Pyetja ime është: Si po implementohet kjo rritje në praktikë dhe a ka vështirësi gjatë implementimit?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo,

Narodni poslanice,

Poštovane gospođo,

Kako što je već poznato, u prethodnoj godini, od septembra meseca usvojeno je odlukom Vlade povećanje za penzionere u svim kategorijama, odnosno u kategoriji za one koji su plaćali doprinos 40%, u drugim kategorijama - u kategoriji osnovnih penzije i privremenih penzija za 33%, i od tad, od septembra prošle godine mi smo bili u obavezi, koju smo poštovali, koju smo ispunili, to je bilo plaćene retroaktivno od 1. januara 2012, i sve su kategorije dobile retroaktivno, kao što je bilo predviđeno svim što je početkom ove godine, odnosno od 1. januara ove godine, napravljeno ono povećanje dodatno koja je bilo predviđeno za onaj paket do 40%, koji sam ponemuo.

Znači mi smo sve naše obaveze ispunili, koja su bili predviđene odlukom Vlade. Nismo imali maltene nikakvih problema, i mislim da ih neće biti. Tako da skraćem odgovor na vaše pitanje je da je Odluka Vlade sprovedena na 100 procentno, da nije bilo nikakvih problema i naravno da u buduće takođe očekujemo da će biti drugih koraka, koji će imati onako za cilj tu neku bolju, da kažem bolji cek penzionera. Hvala!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? E ke fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Zoti ministër, meqenëse Projektligji për pensionet e financuara nga shteti është në Kuvend në fazën e amendamentimit, dhe unë konsideroj se duhet të bëhet kategorizimi i pensionistëve tatimpagues, dua të di a keni evidenca për këtë dhe a keni planifikuar sa do të jetë kostoja shtesë për këtë projektligj?

KRYETARI: Ministër, urdhëro!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala na pitanju!

Da, ja sam već nekoliko puta rekao da je predviđeno da posle usvajanje Zakona, pod zakonski akti koji će biti prvi usvojeni, će biti baš u vezi kategorizacije, tako da moji saradnici kažu da bi taj period treba da bude negde od godinu do godinu ipo dana. Kad kažem to, mislim od usvajanja prvih pod zakonski akata koji su bitni, da bi utvrdili pravila na osnovu kojih će penzioneri aplicirati, i pozivaćemo da apliciraju. Što bi trebalo znači, da u jednom određenom periodu, kad budu onih aplicirali, mi ćemo moći da baratamo konkretnim podacima i naravno brojkama koliko njih može biti u prvoj kategoriji, drugoj, trećoj ili četvrtoj, naravno pod zakonski akti treba da odredi koliko će kategorija penzionera biti, tako da će sve to biti usklađeno.

Moja procena i procena mojih saradnika da kategorizaciji može biti završena u periodu od godinu do godinu ipo dana. Tako da mislim, u svaki slučaj, da ne bi bilo problema bolje računati na godinu ipo dana da to ceo proces bude završen, što je i u skladu sa onim što smo bili obećali prilikom podnošenja zakona. Da će prvi korak koji biti preduzet posle usvajanja zakona, biti u stvari kategorizacija, koja naravno jeste dobro došli. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri, pyetje për zëvendëskryeministrin. Nuk është i pranishëm. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministri nuk është i pranishëm. Doni ta bëni pyetjen, deputete? Gjithashtu deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Fehmi Mujota. Edhe kjo shtyhet për më vonë. Deputeti Hashim Deshishku, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryetar!

Pak javësh, ministri Rashiq dhe homologu i tij nga Maqedonia, Spiro Lisovski, e kanë nënshkruar marrëveshjen, sipas së cilës sigurohet realizimi i së drejtës për pension për të gjithë ata që kanë punuar në shtetin e Maqedonisë dhe anasjelltas. Do të thotë, shtetasit e Maqedonisë që i kanë paguar kontributet pensionale në Kosovë e realizojnë të drejtën për pensione në bazë të kontributit. Unë këtë e vlerësoj si një gjest të mirë, meqenëse e drejta për pension është e garantuar dhe e pamohueshme për të gjithë kontribut-dhënësit. Mirëpo, zgjidhja që është ofruar paraqet model të veçantë dhe vetëm për një kategori të caktuar të pensionistëve. Unë e pyes ministrin Rashiq se cila është baza ligjore për një marrëveshje të këtillë, sa është numri i përfituesve nga Kosova dhe shuma vjetore e pensioneve që u paguhen, si dhe anasjelltas, a ka ndonjë iniciativë që modeli i aplikuar me këtë rast të jetë formë edhe për zgjidhjen e problemeve që kanë të gjithë pensionistët kontribuues. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Hvala gospodine poslaniče na pitanju. Biću vrlo konkretan. Zakonska baza povezano sa međunarodnih sporazuma za period osiguranja između Republike Kosova i Republike Makedonije ustavnom normama člana 17. i 18. Ustava Kosova.

Takođe druga zakonska baza za povezanost ovog i drugih ličnih sporazuma su odredbe člana 4. i 12. Zakona broj 04/L-052 za međunarodne sporazume. Prema ovim odredbama, ministarstvo, odnosno visoki održanih organi unutar njihovih nadležnosti mogu povezivati bilateralne međunarodne sporazume.

Projekat ovog sporazuma treba da revidira Ministarstvo spoljnih poslova i da daju pisani pristanak za povezanost ovih sporazuma, koja su potpisana od strane ministarstava određenih vlada.

Na osnovu ovog sporazuma, izraz periodi osiguranja podrazumeva, u slučaju Kosova periodi za koji su plaćeni doprinosi za penzijske invalidsko osiguranje, i to:

1. Registrovani u bazi podataka do 31.12.1999. godine;
2. Registrovani u bazi podataka kao staž osiguranja, što se smatra za produženim trajanjem do 31.12.1991. godine, i
3. Potvrđeni period pomoću aplikacije M4 do 31.12.1998. godine, kontrolisani i potvrđeni od strane nadležne institucije, sa zapisom od strane završne kontrole.

Što se tiče broj korisnika, ne raspolažemo sa tačnim statističkim podacima, da budemo jasni zbog toga što je period tek u apliciranju, i verovatno ćemo znati kada taj ukupan zbir aplikacija bude kod nas, ali se procenjuje, kažem da to nije konačni zbor, to se procenjuje kao jedan od brojeva, bi trebalo da bude negde oko 5 hiljada radnika, koji su u nekom određenom momentu radili u Makedoniji. Sada, koliko će od njih biti ispuniti taj uslov da apliciraju kod nas, ja u ovom momentu stvarno ne znam, ali koliko god ih bude bilo, mi ćemo tu informaciju objaviti čim bude došla to nama. A što se tiče same Makedonije, oni su bili vrlo konkretni u tim njihovim proračunima, i već su naglasili da oni imaju tačno 1 564. zahteva za penzije što čekaju za potvrđivanje perioda za osiguranje koje imaju na Kosovu. Znači, mi još uvek ne možemo da se obratimo tačnim ciframa, ali oni već imaju jednu dobro određenu šifru.

Što se tiče ovog samog dokumenta i primera forme, mi smo već ovu formu upotrebili i poslali smo i Crnoj Gori, poslali smo i Hrvatskoj, koja će biti primer za dalju saradnju, jer mislim da u delu koje sada gde se može implementirati da je vrlo funkcionalni i dobar dokument, tako da će ovo biti baza...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shitesë?

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, zotëri ministër!

Pyetje shitesë, nga cili buxhet do t'i merrni mjetet për pagesën e pensioneve maqedonase, për ata të cilët kanë punuar në Kosovë, kurse ne e dimë që buxhetin e pensioneve e ka marrë apo e ka vjedhur Serbia dhe tash nga cili buxhet do t'i paguani ju, meqenëse ende nuk e dini numrin e saktë të pensionistëve, as sa do të kushtojë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala na pitanju!

To je, vi sigurno znate, ova je takozvana priznavanja staža. Oni naši sugrađani koji su radili u Makedoniji, njima ćemo mi ovde priznati staž, i svaki budžet od sistema će se postarati za plaćanja tih penzija. Pošto ovaj broj u ovom slučaju našem, pričam za naš kosovski, nije zahvaćujući, nije toliko veliki da ne možemo da ga mi financiramo, tako da ovo samo povećanje koje ćemo mi eventualno imati, moćićemo postojećim budžetom da registrujemo, mislim da ispuštujemo. Na osnovu načela, u tom penzionom povezivanju da naj osnovniji i najveći problem predstavljaju zemlje u okruženju, kao što je u našem. Tada smo mi smatrali da je najbolje prvo da povezivanjem sa Makedonijom, Hrvatskom, Slovenijom i ubuduće nadamo se verovatno desi će se nadam se na ovom momentu i sa upravom Srbije, da možemo da naše te osnovne one probleme da prevaziđemo, da bih kasnije, kada budemo stigli do nekih zemalja koja verovatno realno gledano nisu imali veliki broj državljana da rade tamo, bude mnogo lakše.

Oću da kažem da imamo budžeta za to. To nisu velika sredstva, ali moguće je da datom momentu kada budemo vezivali više tih broja bilateralnih sporazumna, može da bude

malo nekoliko skromnije zahteva u Ministarstvu financija, ali je uglavnom sve pod kontrolom. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Alma Lama, nuk është pranishme. Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Beqir Beqaj. Deputet, e ke fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Ja bih ponovo pitao ministra Bećaj: u kojoj fazi je završetak dalekovoda koji se radi iz Gračanice prema selima u Dobratinu, Gušterici i Gornjoj Gušterici, i zbog čega do sada nije završeno?

MINISTRI BESIM-BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Ju e dini që unë edhe më herët kam njoftuar Kuvendin që KEK-u e ka bërë një marrëveshje me Komunën e Graçanicës lidhur për ndërtimin e largpërçuesit, marrëveshje e cila ka qenë në zbatim dhe marrëveshje e cila kanë filluar të implementohet, por në ndërkohë kanë dalë probleme pronëso- juridike, meqë një numër i fshatarëve i këtyre fshatrave nuk ka lejuar që largpërçuesi të kalojë nëpër pronat e tyre dhe tani KEK-u ka kërkuar përgjigje juridike nga Komuna që këto çështje të zgjidhen dhe pas zgjidhjes së tyre puna do të vazhdojë. Pra, puna ka filluar, por për shkak të problemeve pronëso- juridike, Komuna e Graçanicës mbetet t’i japë shpjegim Distriktit të Prishtinës lidhur me mundësinë e realizimit të këtij investimi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë? Faleminderit! Vazhdojmë. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po bëhen gati 20 muaj prej se është vrarë polici Enver Zymberi, ndërkohë që vrasësit e tij vazhdojnë të jenë të lirë. Në anën tjetër, më 24 tetor 2012, në emisionin “Rubikon” të KTV-së, në lidhje me vrasjen e Selver Haradinajt, ju keni deklaruar se: dihet diçka, që kjo nuk është bërë nga serbët, dhe se këto të dhëna janë gati të sigurta. Ju po në këtë emision keni deklaruar edhe se vrasja nuk ka ndodhur për arsye ndëretnike, për këtë mund t’ju garantoj. Andaj, pyetja parlamentare është se deri në cilën fazë kanë shkuar hetimet për vrasjen e Enver Zymberit dhe Selver Haradinajt? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket rastit të vrasjes së heroit Enver Zymberi, hetimet janë zhvilluar në bashkëpunim me policinë e EULEX-it, të mbikëqyrur nga Prokuroria e EULEX-it dhe prokurorët vendorë të Prokurorisë së Qarkut në Mitrovicë. Deri më tani janë identifikuar

6 persona të dyshuar, për të cilët është lëshuar fletarresti vendor dhe ndërkombëtar, mirëpo ende nuk është arrestuar asnjë nga të dyshuarit.

Sipas informacioneve që i ka Policia e Kosovës, këta të dyshuar strehohen në Serbi dhe mungesa e bashkëpunimit me shtetin serb krijon pengesa për arrestimin e tyre. Me autorizimet e Prokurorisë është duke u punuar ende me qëllim të identifikimit të personave tjerë të përfshirë në këtë rast si të dyshuar të mundshëm. Ndërkohë, Policia e Kosovës ka arritur ta identifikojë edhe të dyshuarin e shtatë, për të cilin është bërë kërkesa për lëshimin e urdhër-arrestit. Të gjitha veprimet hetimore që ndërmerren në këtë rast janë realizuar në përputhje me letër-rekomandimet e Prokurorisë.

Ndërsa, sa i përket rastit të të ndjerit Selver Haradinaj, është marrë autorizimi për fillimin e veprimeve hetimore nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, konkretisht nga kryeprokurori Shyqyri Syla dhe prokuroja e EULEX-it, Meta Amin. Rasti është kualifikuar si vepër penale penale, kryerja e veprës terroriste nga neni 109 dhe 110 të Kodit Penal. Rasti hetohet nga një grup i veçantë punues, i cili përbëhet nga Drejtoria e Hetimeve nga niveli qendror, Skuadra e hetimeve rajonale në Mitrovicë dhe Task-Forca e EULEX-it në Mitrovicë.

Është bërë intervistimi i dëshmitarëve dhe familjarëve dhe personave të tjerë që mund të japin informacione për rastin. Janë ekzaminuar dëshmitë nga vendi i ngjarjes, janë zhvilluar disa operacione për mbledhjen e dëshmive dhe intervistimin e personave në veri të Mitrovicës në bazë të planit të hartuar dhe në bashkëpunim me kolegët e EULEX-it.

Këto veprime janë duke vazhduar nga ekipet e lartcekura. Në fazën e tanishme, Policia e Kosovës është duke zhvilluar dhe analizuar disa informacione të pranuar me autorizim të prokurores së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

VJOSA OSMANI: Çfarë presioni ndërkombëtar po bëni ndaj Serbisë për dorëzimin apo për kapjen e të dyshuarve, pra në rastin e parë, dhe a qëndroni prapa fjalëve që i keni thënë në “Rubikon”.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Mundësitë e presionit, edhe ndërkombëtar ndaj Serbisë, mundohemi t'i shfrytëzojmë dhe të gjithë jemi të vetëdijshëm se sa mund të bëjmë në këtë drejtim. Unë qëndroj pas fjalëve të thëna, por njëkohësisht nuk dua që tragjedinë e njerëzve të pretendoj ta shfrytëzoj për poenë politike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Në seancën e mbajtur më 14 qershor 2012 është miratuar Ligji për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Pyetja është kjo: A janë

duke i marrë personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër pagat për efekt verbërie, ashtu siç është e paraparë me këtë ligj?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hala predsedniče!

Poštovani poslanici,

Poštovana gospođa Gaši,

Od strane odgovornih zvaničnika Ministarstva za rad i socijalna staranja pripremljen je predlog odluke za utvrđivanje mesečne finansijske kompenzacije za slepe osobe, dok je od strane drugog odgovornog zvaničnika pri kraju je priprema početnog nacrtu administrativnog upustva za formiranja delokruga i funkcionisanje mediko-socijalne komisije, preko koje komisije će biti procenjivana stepen slepih osoba koja predvida mesečno finansijsku nadoknadu.

Takođe prema zahtevu koju je uputio Ministarstvo za rad i socijalno staranje, i druga odgovarajuća ministarstva, jesu u procesu izrade zakonskih podataka iz svojih delokruga, dok pripreme posebno izrada pod zakonskih akata za sprovođenje Zakona za slepe, teču po planu. Glavni problem ostaje na obezbeđivanju budžetskih sredstava za sprovođenje pomenutog zakona. Ovo znači konkretno da u okviru Ministarstva za rad ne postoje alocirana sredstva koja su namenjena za sprovođenje Zakona za slepe osobe. Naravno na okviru naših nadležnosti angažiraćemo se da ponovnim pregledom budžeta za 2013. godinu, sredstva budu obezbeđena, tako da će zakon može biti sproveden onako kao što je bilo i planirano.

Procenat je da ima negde oko 500 slepih osoba na Kosovu, koji bi trebalo da imaju benefite od ovog zakona. Takođe iznos finansijski, koji bi trebao da bude zaokupljen, odnosno da bude alociran za provođenje ovog zakona oko 400 evra, i to bi bio generalni utrošak za godinu 2013. Hvala!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

ALBANA GASHI: Po kryetar. Faleminderit!

Ministër! Pagat është dashur të ekzekutohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Në anën tjetër, ju po thoni që ende nuk kanë përfunduar aktet nënligjore ose udhëzimet administrative, ndërsa tjetra që po thoni ju është se nuk ka buxhet dhe në buxhetin e vitit 2013 do të përfshihet kjo kategori e personave të verbër dhe pjesërisht të verbër. Nëse nuk ka buxhet atëherë, pika e parë, ministër pse po i mashtroni këta personat e verbër?

Tjetra, nëse në korrik, pra kur të bëhet rishqyrtimi i buxhetit, do të fillojë ekzekutimi i pagave, a do të merren këto paga në mënyrë retroaktive, pra nga 1 janari dhe në lidhje me përfundimin e akteve nënligjore a do ta përcaktoni një afat kohor për përfundimin e këtyre akteve. Faleminderit!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala!

Inače zakonski pod-akti, ja sam rekao u delo da nisu samo oni koje trebalo ministarstvo da radi. Bilo je i drugih tehničkih elemenata koji su trebale biti urađeni od drugih institucija i drugih ministarstava. To do sada nije bilo završeno zbog tehničkih problema koji su druga ministarstva imala. Uglavnom, Zakon će biti sproveden od datuma kada je usvojen, od 1. januara 2013. godine, a zakonski pod-akti će verovatno biti završeni u narednih dva meseca, što znači da ćemo mi verovatno imati predlog na rebalancu, imati predlog za alociranje ovih dolaznih sredstva koje sam malo pre pomenuo da treba da osiguramo sa financiranje zakona, što znači, ukratko rečeno da, nadamo se da će tehnički, ustvari apsolutno verujem da će tehnički za 2 meseca zakonski pod-akti biti spremni i da ćemo mi moći u nekom momentu, u junu ili eventualno julu, da taj predlog predložimo sa usvajanje, i time će Zakon o slepima biti praktično sproveden. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Ferid Agani.

HALIT KRASNIQI: Zoti ministër! Komplimentet e përshkruara që i kam bërë në formulimin e pyetjes qëndrojnë dhe me pak përmirësime, gabime që i ka lëshuar stafi teknik i Grupit Parlamentar, mund t'i përsëris dhe jashtëzakonisht qëndrojnë, janë të sakta dhe nuk janë vetëm komplimente. Përgatitja profesionale, vokacioni i juaj spiritualist edhe gjithë performansa e ministrit kanë gëzuar dhe kanë pritur sukseset, të cilat në vazhdimësi besoj se nuk do të mungojnë në të ardhmen, deri në fund të mandatit tuaj.

Kësaj radhe unë e kam një pyetje, e cila e përcjell interesimin e një pjese të qytetarëve të Kosovës, kryesisht nga regjioni i Prizrenit, me epiqendër Malishevën, një pjesë të Drenasit, dhe një pjesë të disa fshatrave të komunës së Klinës, e që lidhen me humbjen më se 30 jetëve nga epidemia e rriqrave për këto 10 vjet. Meqenëse jemi afër sezonit kur shfaqet kjo epidemi, kisha dashur që para deputetëve, por edhe para qytetarëve, të mësojmë diçka çfarë keni në agjendën tuaj për këtë vit para se të fillojë goditja nga kjo mortajë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëroni!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Krasniqi,

Faleminderit për vlerësimet! E keni ngrehur një çështje me rëndësi të veçantë për shëndetin publik dhe ju siguroj se Ministria e Shëndetësisë në vazhdimësi është duke zhvilluar aktivitete, në mënyrë që sezoni gjatë të cilit kemi më shumë probleme me ethet hemorragjike krime-kongo të jetë sa më mirë e ballafaquar në aspektin profesional.

Deri më sot, prej vitit 2006, kur ka filluar edhe konfirmimi i sofistikuar i diagnostifikimit laboratorik të etheve hemorragjike krime-kongo në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik janë raportuar gjithsej 1 754 pickime nga rriqrat, prej të cilave janë sëmure gjithsej 70 persona me ethe hemorragjike krime-kongo në tërë Kosovën, prej të cilave 36 raste

klinike në komunën e Malishevës me 6 raste të vdekur; në komunën e Drenasit vetëm një person është sëmurë dhe asnjë rast i vdekjes, dhe në komunën e Klinës kemi pasur 9 raste të sëmundjes dhe një rast të vdekur. Gjithsej, nga viti 2006 kemi pasur 14 raste të vdekjes nga kjo sëmundje.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, si institucion referent i Ministrisë të Shëndetësisë, po e përcjell në mënyrë permanente situatën epidemiologjike në të gjitha vatrat e infeksionit, ku ekipet e epidemiologëve janë në vazhdimësi në terren dhe bashkë me mjekët dhe punëtorët shëndetësorë të qendrave kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë dhe Rahovec po vazhdojnë mbikëqyrjen dhe hulumtimin epidemiologjik të të gjitha vatrave, përfshirë këtu edhe vatrat endemike të komunave Klinë, Skenderaj dhe Suharekë.

Ekipet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik janë të gatshme për ndihmë profesionale dhe në mënyrë të pakursyer me të gjitha mjetet në dispozicion. Edhe sivjet, Instituti Kombëtar është përgatitur për t'u përballur me ethet hemorragjike krime-kongo në të gjitha vatrat e Kosovës. Deri sot, ekipet e institutit kombëtar kanë mbikëqyrur dhe hulumtuar të gjitha vatrat aktive, ku ka pasur pickime të rriqrave dhe kanë mbajtur ligjëratat në 44 shkollat e komunës së Malishevës dhe në 25 shkollat e komunës së Rahovecit, duke e bërë edhe dezinfektimin në të gjitha hapësirat ku janë regjistruar pickimet nga rriqrat. Sipas raporteve të Institutit nga terreni i Malishevës, janë spërkatur kryesisht hapësirat publike, ku është shprehur vullneti nga pronarët dhe oborret e tyre, duke lënë material për ata që kanë dashur t'i spërkasin vetë pronat e tyre. Me spërkatje janë mbuluar 39 zona të planifikuara dhe është bërë edhe në komunën e Rahovecit.

Në aspektin e kompetencave të aktiviteteve të mbyjtjes së rriqrave, kjo veprimtari i takon Ministrisë së Bujqësisë, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës dhe Komunës së Malishevës, por Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka qenë vazhdimisht në terren në të gjitha aktivitetet parandaluese, edhe në asgjësimin e rriqrave, dhe do të jetë edhe sivjet për të bërë dezinfektimin dhe dezinfektimin në komunën e Malishevës. Ministria e Shëndetësisë vjet, edhe pse nuk e ka nën kompetencë kujdesin parësor në aspektin e financimit të drejtpërdrejtë, ka ndarë për dy komunat nga 10...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetë, keni pyetje shtesë?

HALIT KRASNAIQI: Jo, nuk kam pyetje shtesë. Faleminderit për përgjigjen. Përveç vdekjeve që kanë ndodhur, këto 30 që i përmenda, edhe mijëra të hospitalizuar të tjerë, kanë qenë shqetësimet e gjithë kësaj popullate të shtrirë në këtë zonë, e cila besoj se këtë vit nga Qeveria jonë edhe nga Ministria përkatëse, gjithashtu edhe nga Ministria e Bujqësisë, do të kenë përkujdesje të veçantë dhe kujdes permanent. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputet,

I nderuar ministër,

Banorët e 50 fshatrave nga Lugu i Baranit deri në Lugë të Leshanit kanë mbetur pothuajse të izoluar edhe në këtë kohë dimri jo shumë të vështirë. Qarkullimi i tyre me automjete është bërë çdo ditë e më i vështirë. Komuna e Pejës e ka të vështirë ndërtimin e kësaj rruge si e vetme. Pyetja ime është: Kur do të fillojë ndërtimi i kësaj rruge jetike për këta banorë, të cilët ishin edhe pikë strategjike në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë, zonja Haxhiu,

Unë ju falënderoj për angazhimin tuaj dhe kujdesin që keni treguar për projektet e infrastrukturës. Duke u bazuar në pyetjen tuaj për gjendjen e rrugëve lokale në Lugun e Baranit deri në Lugun e Leshanit të komunës së Pejës, ju informoj se rruga nga Lugu i Baranit deri në Lugun e Leshanit, në bazë të hartave për rrugët në Republikën e Kosovës, nuk e ka statusin e rrugës nacionale apo rajonale, të cilat janë në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës.

Rruga për të cilën ju parashtroni pyetjen, është e kategorizuar si rrugë me karakter lokal dhe është në kompetencë të Komunës së Pejës. Mirëpo, megjithatë, për hir të publikut dhe drejtpërdrejt në përgjigje për ju, ju informoj se Ministria e Infrastrukturës i ka përkrahur komunat në realizimin e shumë projekteve rrugore në nivel lokal nëpërmjet programit të bashkëfinancimit, ndërsa vitin e kaluar, përveç 4 projekteve që i ka investuar plotësisht Ministria e Infrastrukturës në rrugën Lutogllavë-Sverkë e Thatë, në rrugën Vitomiricë, në rrugën Kuçishtë-Bogë dhe në rrugën Raushiq-Turjakë, ne e kemi bashkëfinancuar me Komunën e Pejës edhe rrugën në fshatin Dugajevë të Rugovës.

Këtë vit, përveç vazhdimit të zgjerimit të rrugës nacionale 9, nga Gjurgjica në drejtim të Pejës, në gjatësi prej rreth 9 kilometra, ne do të fillojmë ndërtimin edhe të dy projekteve tjera në komunën e Pejës, në rrugën nga transiti deri në hyrje të qytetit dhe atë Pejë-Tërstenik.

Sidoqoftë, në kuadër të pyetjes suaj konkrete, meqë keni precizuar se është edhe një rrugë me strategji të veçantë për komunën e Pejës, për mua dhe publikun do të mbetet një dilemë se si është e mundur që për 13 vjet të mos jetë e adresuar si rrugë me karakter lokal dhe prioritet në Komunën e Pejës dhe më pas të bartet ndoshta edhe në nivelin qendror që të përkrahet edhe kjo rrugë, sikur dhjetëra e dhjetëra rrugë në Republikën e Kosovës, pse jo edhe në komunën e Pejës.

Prandaj, shpresa ekziston që nëse Komuna e Pejës e bën përgatitjen e projektit deri në rishikimin e buxhetit, ne me kënaqësi do ta marrim në konsideratë dhe do ta procedojmë në procedurat parlamentare dhe ta sigurojmë buxhetin për këtë rrugë, ndërsa juve personalisht ju njoftoj se e kemi shtruar një çështje rreth ndërtimit të një ure, po ashtu në këtë zonë, dhe unë ju konfirmoj se e kemi marrë në konsiderim dhe ajo do të realizohet.

Sidoqoftë, edhe ky projekt për të cilin po flisni, atëherë kur të jetë Komuna gati, atëherë kur i respektojmë procedurat parlamentare dhe miratimin e buxhetit ne si ministri, jemi të gatshëm ta realizojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar! Meqë e përmendi edhe ministri, pra urën në fshatin Resujë, ministër, e dini në çfarë gjendje është. Projekti ka ardhur. Ju e përmendët, por kisha dashur ta di saktë se kur do të fillojë ndërtimi i kësaj ure.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit! Me siguri se një pyetje që shtrohet gjithmonë a duhet të punojmë sipas ligjit dhe respektimit të procedurave, sigurisht se përgjigjja është 'po'.

Prandaj, ne i respektojmë këto procedura dhe tash është faza kur përgatiten projektet, kërkohet kalimi i një faze të caktuar, derisa të vijë deri te shpallja e operatorit që do ta ndërtojë urën dhe ne besojmë se brenda këtij viti kjo urë do të kryhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo pikë e rendit të ditës është shteruar. Ju njoftoj se të pranishëm janë 73 deputetë, prania fizike, 95 janë me kartela.

Ju lutem, unë po ju njoftoj që të pranishëm janë 73 saktë, tash erdhën edhe 3, 76 gjithsej. Ju njoftoj se sa herë ta themi praninë fizike është ashtu si themi ne, sepse numërimet janë të sakta. Prandaj, mos dezinformoni askund se prania nuk është e saktë. Ata që kanë dezinformuar, e dinë vetë.

I kemi dy mocione:

Mocioni i parë është nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Unë e kam me shkrim. Kryetari i Grupit, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeverisës,

Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit, përkatësisht në nenin 42, pika 2, si dhe në kërkesën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, të datës 6.3.2013, kërkojmë që sot si pikë e rendit të ditës të futet

raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës për takimin e fundit në Bruksel, të mbajtur me kryeministrin e Serbisë, për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, kërkesa është me shkrim, edhe nga kryeministri, edhe nga Grupi Parlamentar. Kishim shkuar në procedurën e votimit.

Për deklaramë jashtë rendit të ditës, a kjo për mocion? Po, bën edhe kjo. Sido që të jetë, ne duhet ta votojmë mocionin. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne nuk e përkrahim mocionin e tillë, sepse nuk është çështje urgjente, është çështje e ndjeshme bisedimet, por absolutisht në këso forme të raportohet, të vijmë në sallë sot dhe të na thuhet kjo është e drejtë e Grupit Parlamentar që e propozoi, ne nuk e përkrahim dhe do të votojmë kundër futjes në rend dite të këtij mocioni.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Visar Ymeri, në emër të Grupit “Vetëvendosje”, kryetar.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Po ashtu as ne nuk jemi që kjo pikë të futet në rendin e ditës. Mendojmë që kjo kërkesë, siç kemi vepruar deri tash, kjo gatishmëri e kryeministrit që është shprehur nëpërmjet atyre letrave, duhet të shkojë në Kryesi, ta diskutojmë aty dhe pastaj mund ta futim në rend dite në seancë. Nuk është çështje urgjente, siç e tha edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe mendoj që kjo vetëm sa po shkon në dëm të idesë së raportimit të kryeministrit për shkak se çdoherë e më shumë po ngushtohet hapësira që deputetët të jenë të informuar, duke luajtur këso lojërash, duke mos sjellë dokumente dhe, në anën tjetër, duke e ngutur aty për aty pikën vetëm sa ta kalojë formalisht si obligim që e ka.

Prandaj, konsiderojmë që kjo nuk duhet të votohet për shkak se edhe nuk është shumë në përputhje me Rregulloren, meqenëse duke mos qenë çështje urgjente, nuk duhet të kërkojmë që të futim pika të rendit të ditës aty për aty. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, kryetari i Grupit Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendojmë se nuk ka nevojë as Kuvendi, as opinionin, të befasohen kështu, duke na vënë në këso situatash të papërgatitur. Nuk është nevojshme të hiqet ‘derti’ sot, më falni për këtë shprehje, për ta bërë një informim, në të cilin kurrkush nuk është i përgatitur për të, prandaj nuk e mbështetim këtë mocion të Grupit Parlamentar të PDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Shkojmë me grupet tjera. Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kryeministër,

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Duke marrë parasysh që çështja e raportimit të kryeministrit dhe çështja e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është një çështje e cila duhet të jetë permanente në çdo kohë dhe në çdo moment për të gjithë deputetët dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, atëherë edhe raportimi i kryeministrit sot nuk do të jetë jashtë Rregullores së Kuvendit.

Nuk e di ku është arsyeja, mirëpo për raportimin e kryeministrit brenda seancës plenare ne duhet të jemi të përgatitur çdo herë, në çdo rast çfarë ndodh në Kosovë dhe rreth Kosovës.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah.

KRYETARI: Faleminderit, kryetare! Në emër të SLS, kryetari i Grupit, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržava predlog PDK-a, i mi smo da danas nas premijer izvesti o poslednjem susretu sa gosopodinom Dačićem. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, nuk ka të lajmëruar. Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryeparlamentar Krasniqi, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht, edhe mua më lejoni që, në emër të Qeverisë t’ua uroj sot Ditën e Gruas të gjitha grave shqiptare, kosovare dhe të të gjithë botës.

Ju e dini se ka qenë e instaluar një praktikë jashtëzakonisht e mirë, me kërkesën tuaj, duke e respektuar gjithmonë Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim të rregullt dhe raportim të rregullt të Qeverisë së Kosovës, të kryeministrit të Kosovës, për deputetët në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Unë dëshiroj të ju drejtohem me mesazhin e kryeministrit të vendit, jo në baza partiake, për përgjegjësitë që i kam marrë nga ky Kuvend, për hir të transparencës, por edhe për përgjegjësitë shtetërore që i kemi.

E para, realisht po. Kosova dhe ky proces janë duke kaluar në një moment vendimtar dhe unë mendoj e besoj në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme se qytetarët e Kosovës dhe ju duhet të jeni të informuar në detale, gjë për të cilin keni kërkuar gjithmonë.

Çështja e dytë, është e vërtetë se ka lëvizje drejt përsheptimit të përmbylljes së këtij procesi.

E treta, dëshiroj të ju theksoj se javën e ardhshme do të jem në udhëtime zyrtare në shtetet e ndryshme të Evropës dhe jashtë saj në takime bilaterale shtetërore, agjenda të konfirmuara më herët. Ne i jemi drejtuar edhe Kryesisë, edhe juve. Unë dëshiroj që ky debat apo informim të jetë në pajtueshmëri me të gjithë, e jo të kemi ndarje në baza partiake sa i përket informimit, por dëshiroj të theksoj dhe ju lus që do të ishte me interes të informoheni për takimin e fundit, sepse takimi i fundit në të njëjtën kohë ka qenë i rëndësishëm. Unë nuk po flas për urgjenca, por po flas për transparencë, prandaj unë nuk dëshiroj që ta përdor përsëri të drejtën time kushtetuese dhe ligjore për caktimin e datës dhe orës për seancë të jashtëzakonshme, por ju lus që të gjithë, pa dallime partiake, ta dëgjoni informatën dhe raportin e kryeministrit të Kosovës.

Është në interesin e Kuvendit, është në interesin e institucioneve të Republikës së Kosovës, është në interesin e transparencës së plotë para qytetarëve dhe të gjithëve. Kështu që, natyrisht se ndoshta ndokujt nuk i intereson ta dëgjojë informatën, sepse ata që flisnin javën e kaluar për Republikë Serbe, e dinë që nuk do të ketë, as ndarje të Kosovës, as autonomi, as status special, as status të veçantë, as status të Tirolit apo të Katalonisë, as Ahtisari Plus, as ndonjë projekt të asociacionit me të drejta legislative ekzekutive dhe pushtet të tretë, por do të ketë vetëm funksionim normal të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Unë kam për të thënë shumë gjëra dhe nëse ka mirëkuptim, ju ftoj që ta mirëkuptoni kërkesën e kryeministrit, përkatësisht të Qeverisë, që të ju informojmë, të raportojmë, t'i dëgjojmë shqetësimet tuaja. Ne sot, gjithashtu, jemi takuar edhe me liderët partiakë, edhe me kryetarin Mustafa, edhe me kryetarin Haradinaj, së bashku me koordinatorin politik, zotin Shala. Mendoj që i ndajmë në të njëjtën kohë përkushtimet e përbashkëta, por edhe shqetësimet e përbashkëta, prandaj mendoj se Kuvendi është vendi ku duhet të dëgjohet kjo informatë. Prandaj, edhe një herë, në emër të transparencës, ju lus të gjithëve, pa dallime partiake, të keni mirëkuptim dhe të dëgjoni informatën. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, debat më nuk ka! Është mocioni. E dëgjuat edhe fjalën e kryeministrit dhe arsyetimin e tij. Shkojmë në procedurën e votimit. Votat janë ato që vendosin.

Të pranishëm janë 85 deputetë, prania fizike, 93 me kartelë, dhe është mirë që kartelat e atyre që nuk janë të pranishëm të tërhiqen. Votojmë tash!

Konstatohet se 41 kanë votuar për, 41 kanë votuar kundër dhe 1 ka abstenuar.

E kemi Rregulloren dhe unë do ta lexoj Rregulloren. Siç thotë Rregullorja, ashtu do të vendosim.

Unë nuk e kam ndërmend ta ndryshoj Rregulloren për hatër të askujt. Neni 51, pika 6, thotë se kur kemi numër të barabartë të votave për dhe kundër, konstatohet se propozimi nuk është miratuar.

Kemi kërkesë për një mocion të dytë. Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç paralajmëruam edhe në fillim, jo vetëm unë, por edhe gratë e grupeve tjera parlamentare, kanë kërkuar që pasi është 8 Marsi dhe jemi 40 gra, më shumë se 1/3 e Parlamentit janë gra, ato kanë nevojë që të shkojnë të takohen me gratë e dëshmorëve, me gratë viktima, me gra të cilat kanë nevojë për përkrahjen tonë, mendojmë që do të kishte qenë e rendit që kjo seancë të vazhdojë një ditë tjetër dhe të na jepni mundësi të shkojmë të takohemi me gratë tjera për fuqizimin e tyre. Kërkoj që kjo të hidhet në votim, dhe për këtë kemi pasur edhe përkrahjen e të gjithë shefave të grupeve parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetët dhe deputetet janë këtu, edhe për gra, edhe për burra, edhe për fëmijë, edhe për pleq, por vendimi juaj është vendim final.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Kryetari i grupit Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë se është një ditë e veçantë për gratë, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah kërkesën e Grupit të Grave Deputete.

KRYETARI: Kryetari i Grupit të LDK-së, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Duke uruar festën e Ditës së Gruas, edhe ne e përkrahim kërkesën që kjo seancë të vazhdojë një ditë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Alma Lama e ka fjalën, në emër të "Vetëvendosjes".

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e dini, sot është Dita Ndërkombëtare e Grave, është një ditë proteste, është një ditë për të vlerësuar dhe për ta vënë në balancë se ku është barazia gjinore, kështu që edhe ne e përkrahim këtë kërkesë dhe e ftoj kryeministrin që të shkojë në zyrën e tij, sepse po e presin gratë e Krushës së Vogël, të cilat kanë ardhur enkas sot për t'i kërkuar të drejtat e tyre dhe për të kërkuar llogari se si kryeministri po e mbështet këtë kategori të shoqërisë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit të AAK-së, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht u tha që të gjithë shefat e grupeve janë pajtuar. Sinqerisht mua s'më ka pyetur kush, por tash po flas me Grupin dhe në rregull është. Për mendimin tim, kjo nuk është festë ndërkombëtare, për shkak se as në Unionin Evropian, as në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk festohet. Është festë komuniste, por sidoqoftë gratë duan ta festojnë. Ne pajtohemi me ato që ta festojnë. Në emrin tim personal, po ju them - No Comment! Faleminderit!

KRYETARI: Kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se edhe para se të hyjmë në seancë ne e patëm një takim dhe dihet që deputetet i përfaqësojnë edhe fëmijët, edhe të rriturit, edhe të gjithë, mirëpo pse është festa ka atakuar sot seanca me këtë festë, për arsye se siç u tha është një numër i madh i grave deputete, atëherë do t'i përkrahim që seanca të vazhdojë një ditë tjetër.

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem! I Parlamentarna grupa “6+” podržava predlog žena poslanica da se sednica Skupštine odloži za neki drugi dan. Hvala!

KRYETARI: Tani do ta votojmë mocionin, por arsyetimi dua të them se nuk më pëlqeu, sepse deputetet kanë pasur tri ditë në dispozicion për t'i vizituar familjet e dëshmorëve. Nëse kërkesa është për festë, unë e mirëkuptoj kërkesën, por jo edhe arsyetimin.

Të pranishëm janë 89 deputetë, prania fizike. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 53 vota për, 12 kundër dhe 4 abstenime, seanca do të vazhdojë të martën, në orën 10:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, më 12 mars 2013

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 8 mars 2013.

Konstatoj që në sallë janë të pranishëm 77 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Vazhdojmë me pikat e mbetura, përkatësisht:

- Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Ka mbetur pa u miratuar procesverbali i seancës së datës 28 shkurt dhe 1 mars 2013. Pyes nëse keni vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Atëherë konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 28 shkurt 2013 dhe të mbledhjes

plenare të mbajtur më 1 mars 2013, si dhe procesverbalin e mbledhjes së jashtëzakonshme, të mbajtur më 1 mars 2013.

Për rend dite, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Duke pasur parasysh rëndësinë e një çështjeje që është preokupim i të gjithë qytetarëve të Kosovës, pra rrjedhën e bisedimeve në Bruksel ndërmjet dy kryeministrave, unë propozoj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që raportimi i kryeministrit të futet sot si pikë e parë e rendit të ditës. Këtë e them edhe për faktin se duke pasur parasysh agjendën e kryeministrit, meqë në ditët në vijim ka angazhime të tjera dhe nuk ka mundësi të jetë i pranishëm që të raportojë në seancën e ardhshme, mundësitë janë që të na raportojë sot. Prandaj, unë besoj se të gjithë deputetët kanë nevojë dhe kanë interes që ta dëgjojnë një informatë nga bisedimet e fundit në Bruksel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka kërkuar fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë propozoj që pika e nëntë, që sot e kemi në rend dite, të hiqet nga rendi i ditës, sepse nëse një punë e një komisioni nuk është përfunduar nuk ka asnjë arsyeshmëri që të flitet për punën e kryer për këtë periudhë në të cilën figuron, 22 prill 2011 - 29 gusht 2012. Kjo ka mundur të jetë një informatë për Kryesinë, por në asnjë variant nuk shohim asnjë arsyeshmëri që sot të debatohet çka është bërë e çka nuk është bërë, nga fakti se nuk është kryer, plus duhet ditur edhe një punë, që është edhe Komisioni për Reformë Kushtetuese, dhe kur të vijnë, kur ta përfundojnë, të shkojmë me të dy raportet.

Prandaj, unë propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, sepse nuk ka asnjë bazë që kjo sot të jetë në rend të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Unë po deklarohe në emër të grupit për të dy çështjet.

KRYESUESI: Jo, mos u deklaro për këto çështje, nëse keni diçka si grup për të propozuar.

VISAR YMERI: Jo, jo.

KRYESUESI: Në rregull, pak më vonë. Alma, t'i nuk ke diçka në emër të grupit? Në rregull.

Atëherë, kërkoj nga kryetarët e grupeve parlamentare që të deklarohen lidhur me mocionin e Grupit Parlamentar të PDK-së, që kryeministri i Kosovës, zoti Thaçi, të raportojë sot lidhur me takimin e fundit që ka pasur në Bruksel. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne nuk po e dimë a është këtu kryeministri, se javën e kaluar ka thënë që nuk do të jetë, por nëse është, herën e kaluar ne nuk e kemi parë të arsyeshme dhe arsyeja ishte e qartë pse nuk e kem përkrahur të futet në rend të ditës, ndërkaq sot e ka obligim kushtetues dhe që ia ka përcaktuar edhe Rezoluta, prandaj ne nuk shohim arsye që ai të mos raportojë nëse ka diçka të na thotë.

KRYESUESI: Zoti Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Ne mendojmë natyrisht që është obligim i kryeministrit që të raportojë në Kuvend, e veçanërisht për këtë proces të negociatave, i cili qartë po e sakaton, të themi ashtu, Kosovën për së brendshmi. Mirëpo, jemi kundër kësaj mënyre të raportimit. Jo vetëm që po kërkohet të futet tash si pikë e rendit të ditës, gjë që u kërkua edhe kur filloi kjo seancë javën e kaluar dhe kur nuk i mori votat, por edhe për shkak se nuk po shohim njëlloj gatishmërie e të kryeministrit për raportim të vërtetë.

Pra, këto raportime që deri tash i kemi pasur janë vetëm një lloj mundësie që kryeministri të na flasë për disa fraza boshe dhe të japë premtime, të cilave nuk u përmbahet fare, ndërkohë që disa herë deputetët këtu kanë shtruar pyetje të ndryshme për dialogun dhe po ashtu kanë kërkuar, madje kanë insistuar që të sjellë me shkrim marrëveshje, të cilat do t'i lexonim dhe pastaj të diskutonim, e të tilla nuk po shoh as sot. Rrjedhimisht, ne mendojmë që sot kryeministri nuk është i gatshëm për të raportuar dhe jemi kundër kësaj mënyre të raportimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendojmë që sot kryeministri duhet të raportojë në Kuvend para deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh obligimin kushtetues, të cilin e ka kryeministri dhe Rezoluta, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës, Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah propozimin që kryeministri të raportojë sot në seancë plenare.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Miletic, në emër të Grupit Parlamentar SLS.

PETAR MILETIĆ: Slažemo sa predlogom da premijer danas izvesti o dijalogu.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

MYFERA SHINIK: Sayın Başbakanım!

Görüşmelerden Rapor sunulmasını Anayasal görevi olarak kabul ediyoruz ve bugün bu Raporun sonunda teklifin “6+” Parlamenter grubu olarak desteklemekteyiz. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë unë e hedh në votim propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, nëpërmjet kryetarit zoti Grabovci.

Në sallë janë të pranishëm 84 deputetë. E votojmë tani mocionin e Grupit Parlamentar të PDK-së, që kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, të raportojë sot në Parlament lidhur me takimin e fundit në Bruksel me kryeministrin e Serbisë. Votojmë tani! Faleminderit!

Konstatoj se me 55 vota për, 12 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi mocionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që kryeministri të raportojë në Kuvend sot lidhur me takimin që e përmenda më herët.

Mocioni i dytë është mocioni i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por para se ta votojmë këtë, kërkoj që si pikë vijuese të radhitet raportimi i kryeministrit.

Grupi Parlamentar i LDK-së kërkoi që pika e nëntë të hiqet nga rendi i ditës për arsyet e cekura më herët nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, pas shqyrtimit dhe propozimit që e kemi bërë edhe në grup, e përkrah propozimin e Lidhjes Demokratike dhe japim mundësi që në mbledhjet e radhës të diskutohet më e kompletuar kjo pikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, zoti Ymeri.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne mendojmë që nuk kemi material të mjaftueshëm për ta zhvilluar një debat të tillë, edhe pse mendojmë që është shumë i rëndësishëm, pra Kuvendi do të duhej ta debatonte punën e këtij komisioni dhe çfarë është bërë në përgjithësi me këtë reformë zgjedhore, por nuk mund ta bazojmë këtë raport apo informatë që i është dorëzuar Kryesisë për shkak se është shumë e mangët, mendoj edhe në informatat për punën edhe rezultate, nëse ka rezultate që i ka arrit ky komision. Prandaj, konsiderojmë që është e udhës që sot të mos e bëjmë këtë gjë, por mirë do të ishte që ta bëjmë në seancat e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne do ta mbështetim këtë mocion të Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe pse ajo që po kuptojmë është se nuk ka materie për të diskutuar, meqenëse komisioni nuk e ka përfunduar punën. Kjo do të thotë që ose nuk do të diskutojmë për pikën derisa komisioni ta përfundojë punën, ose duhet të riformulohet kjo pikë në një prej seancave të ardhshme dhe ne të diskutojmë për temën, e jo për këtë mënyrë se si është shtruar ky mocion. Sidoqoftë, sot e mbështetim mocionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh punën e Komisionit për Reformën Zgjedhore dhe punën e Komisionit për Ndryshime Kushtetuese, atëherë presim që puna e këtij komisioni të përfundojë dhe pastaj të vijë në Kuvendin e Kosovës. Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah mocionin dhe besoj që në seancat e ardhshme do ta kemi një raport të kompletuar të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Miletic, në emër të SLS-së.

PETAR MILETIĆ: Podržavamo predlog.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, në emër të "6+".

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar "6+" e përkrah mocionin e LDK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të pranishëm janë 85 deputetë. E votojmë mocionin. Votojmë tani!

Konstatohet se me 76 vota për, 1 abstenim dhe 2 kundër u miratua mocioni i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që të hiqet nga rendi i ditës pika e nëntë: Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012.

Radha është të fillojmë me pikën, të cilën e futëm në rend të ditës:

- Raportimi i kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, lidhur me takimin e fundit në Bruksel me kryeministrin e Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve

Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Përfaqësues të medieve,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në fillim të ju falënderoj edhe një herë, të nderuar deputetë, për mundësinë e krijuar për t'iu adresuar juve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës lidhur me procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë, që po zhvillohet në Bruksel, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, pra baroneshës Katrin Eshton, dhe me përkrahjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Unë herën e fundit raportova para juve, të nderuar deputetë, në detaje dhe në mënyrë kronologjike për gjithë procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe për rezultatet që janë arritur deri më tani.

Prandaj, sot, do të përqendrohem vetëm në raportin që ndërlidhet me takimin e gjashtë në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili u mbajt në Bruksel, më 4 mars 2013. Mirëpo, mbetem i hapur për të dhënë sqarime shtesë për gjithë procesin sa herë që ju e konsideroni të nevojshme dhe të dobishme.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Njësoj si në takimet e kaluara, fillimisht delegacioni i Kosovës kishte një takim bilateral me baroneshën Eshton dhe ekipin e saj. Në këtë takim, baronesha Eshton shprehu përsëri konsideratën e saj të lartë për punën serioze dhe racionalitetin e lartë që ka dëshmuar delegacioni shtetëror i Kosovës gjatë gjithë këtij procesi.

Gjithashtu, e theksoj faktin se është në dijeni të të gjitha reagimeve politike në Kosovë që ndërlidhen me ndjeshmërinë që mbart me vete procesi për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Në këtë drejtim, ajo e shprehu gatishmërinë e saj që të vijë së shpejti në Kosovë për të takuar liderët institucionalë dhe politikë, për t'i dhënë të gjitha sqarimet e nevojshme për temat që janë duke u adresuar në kuadër të këtij procesi.

Pas konsultimeve që kam pasur me baroneshën Eshton, unë e kam ftuar që ta bëjë një vizitë në Kosovë më 14 mars, pra të enjten, me qëllim që bashkërisht të kemi mundësi ta dëgjojmë nga vetë baronesha Eshton për rrjedhën e procesit dhe pritjen për përmbylljen me sukses të këtij procesi jashtëzakonisht të rëndësishëm.

Pra, këtë javë të gjithë liderët politikë të partive parlamentare do të kenë mundësi të drejtpërdrejtë nga vetë baronesha Eshton të marrin përgjigje për ndonjë shqetësim eventual, që do të mund të kenë lidhur me procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, natyrisht ata që meritojnë të dëgjohen.

Dhe, unë pajtohem, të nderuar deputetë, keni nevojë të dëgjoni edhe nga vetë baronesha Eshton, pra nga liderët tuaj që do të kenë takim me të, se çdo zgjidhje eventuale për problemet që janë duke u diskutuar në kuadër të këtij procesi, të gjitha do të jenë në

kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës dhe në pajtueshmëri me parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisje Lokale.

Tani po kthehem përsëri te takimi bilateral, që gjithmonë i paraprin takimit të përbashkët.

Kësaj radhe si pjesë e agjendës së takimit të gjashtë, baronesha Eshton, si ndërmjetësuese, insistoi që të diskutohet, ndër të tjera, për çështjen e themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Sipas baroneshës, kjo çështje duhet të jetë thelbësore për Serbinë, dhe në rast se arrihet marrëveshje për themelimin e këtij asociacioni, atëherë duhet të jetë më lehtë për të gjitha problemet tjera.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Në vazhdim të këtij takimi bilateral, delegacioni i Kosovës e ka theksuar edhe njëherë domosdoshmërinë se përfundimi i këtij procesi duhet të rezultojë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila do të nënshkruhet nga kryeministrat e të dyja vendeve - në cilësinë e garantuesit do të nënshkruhet nga baronesha Eshton, në emër të Bashkimit Evropian, dhe me mbështetje të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Marrëveshja përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë do të duhet të jetë një dokument i përgatitur mirë, duke përfshirë parimet bazë, obligimet e palëve, planin e detajuar implementues, obligimet e garantuesit e kësaj marrëveshjeje, të gjitha anekset për marrëveshjet e arritura në fushat e caktuara, duke përfshirë edhe marrëveshjet që duhet të arrihen në fushat e energjisë, telekomunikacionit, transportit dhe të tjera.

Delegacioni i Kosovës ia ka bërë të qartë baroneshës Eshton se një proces i tillë kaq i rëndësishëm, i zhvilluar në një nivel më të lartë ndërshtetëror, patjetër që duhet të përfundojë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, në të kundërtën i gjithë procesi mund të mos prodhojë rezultatet e pritura.

Kemi theksuar se Republika e Kosovës dëshiron që nëpërmjet këtij procesi t'i japë fund problemit që Serbia ia ka shkaktuar Kosovës për 13 vjet me radhë.

Prandaj, ne jemi këmbëngulës që në fund të procesit të ketë një marrëveshje gjithëpërfshirëse të nënshkruar.

Të nderuar deputetë,
Pas përfundimit të takimeve bilaterale ndërmjet delegacionit të Kosovës dhe baroneshës Eshton, pastaj takimit bilateral ndërmjet baroneshës dhe kryeministrit të Serbisë, Daçiç, atë pasdite e filluam takimin e përbashkët për t'i diskutuar modalitetet për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe të Kosovës.

Ne përsëri, edhe në këtë takim, e shprehëm gatishmërinë tonë për të mundësuar themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, në përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Ne kemi prezantuar në detaje strukturat që do të mund të kishte një asociacion i tillë, funksionin dhe detyrat që do të mund t'i ushtrojë brenda fushëveprimit të vet për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale.

Unë dua ta ritheksoj faktin se struktura dhe funksioni i këtij asociacioni nuk mund të jenë ndryshe, krahasuar me asociacionin ekzistues të komunave të Kosovës.

Unë besoj se ju të gjithë e keni të qartë strukturën e asociacionit të komunave të Kosovës dhe funksionin që ushtron ai, duke përfshirë edhe mënyrën sesi zgjidhet ai.

Prandaj, nuk do ta elaboroj këtë aspekt, por vetëm mund të them se, njësoj sikur te mekanizmi ekzistues i komunave të Kosovës, edhe asociacioni i komunave me shumicë serbe, që do të themelohet, mundësia për të ushtruar funksione të ndryshme, që ndërlidhen me vetëqeverisje në nivelin lokal, është shumë më e madhe, përfshirë fusha të ndryshme në nivelin lokal.

Në rastin konkret, përveç fushave të veprimit që ndërlidhen me vetëqeverisjen lokale dhe në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, asociacioni i komunave me shumicë serbe mund të emërojë: një përfaqësues të vet për anëtarë të Bordit Zhvillimor për Veriun e Kosovës, i cili kuptohet që është një bord i përkohshëm; mund ta emërojë një përfaqësues të vetin për anëtar të Këshillit Presidencial për Komunitete; mund të mbajë kontakte ose të krijojë partneritete me asociacionet e ngjashme në Serbi dhe vende të tjera; mund t'i koordinojë ndihmat financiare që Serbia i dedikon për komunat me shumicë serbe në Kosovë, e të cilat duhet të jenë transparente dhe vetëm brenda kompetencave të komunave; mund të aplikojë për fonde të BE-së dhe mund të grumbullojë fonde tjera për nevoja të projekteve infrastrukturore në nivel të komunave të tjera.

Të nderuar deputetë,

Baronesha Eshton shprehu miratimin e saj për gatishmërinë tonë që duke e respektuar Kushtetutën dhe ligjet tona, duke e respektuar Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, ne jemi të gatshëm për themelimin e këtij asociacioni të ri.

Në anën tjetër, kryeministri Daçiq, i cili duket qartë përsëri se nuk kishte asnjë miratim apo autorizim për të arritur ndonjë marrëveshje në këtë çështje, fokusin e prezantimit të tij e kishte përsëri te mënyra e zgjedhjes së këtij asociacioni dhe te kompetencat ekzekutive që duhet të ketë ky asociacion.

Serbia, pra, sipas kryeministrit Daçiq, dëshiron që asociacioni, apo siç Serbia preferon ta quajë 'bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë', të jetë një trup politik, i cili

zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ka kompetenca ekzekutive. Pra, këto janë kërkesat dhe dëshirat e Serbisë.

Natyrisht, që një propozim i tillë të Serbisë ne e kemi hedhur poshtë si tërësisht të papranueshëm dhe të parealizueshëm në shtetin e Kosovës.

Ju e dini, ashtu siç e di edhe unë, se de facto dhe de juro, propozimi i Serbisë synon krijimin e nivelit të tretë të pushtetit dhe rrjedhimisht themelimin e një Republike Sërpska të dytë, që kurrë nuk do të pranohet nga ne, sepse kjo do ta minonte shtetin tonë. Prandaj, një gjë e tillë as që do të diskutohet, as që do të pranohet, e as që do të mund të realizohet kurrë në Kosovë.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj

Baronesha Eshton, pasi i dëgjoi diskutimet dhe pozicionet e Republikës së Kosovës dhe Serbisë, kërkoi një pauzë për të bërë përpjekje për t'i përmbledhur në letër çështjet kryesore që ndërlidhen me formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Pas pauzës, ne u takuam përsëri, kësaj radhe në formatin një plus tre nga të dyja palët. Ne si delegacion i Kosovës kemi qenë të gjithë. Në këtë pjesë të takimit, baronesha edhe në formë të shkruar një draft-dokument, i cili përmbledh parimet bazë për themelimin e asociacionit dhe funksionet apo detyrat që një asociacion i tillë do të mund të ushtronte.

Me bindje të plotë po konfirmoj përpara jush, deputetë të nderuar dhe qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, se draft-dokumenti i propozuar nga baronesha Eshton lidhur me krijimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovës është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Të gjitha funksionet që do t'i ushtrojë ky asociacion janë të njëjta me ato që ushtron edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Ndërsa, ajo që është kryesore të theksohet dhe që është thelbi i kësaj problematike, është fakti se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë plotësisht në përkrahje të qëndrimit parimor të delegacionit të Kosovës, që ky asociacion nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk mund të jetë një mekanizëm, i cili do të shërbejë si zëvendësim për kompetencat që ushtrohen nga secila komunë, veç e veç.

Prandaj, asociacioni do të zgjidhet në mënyrë indirekte, njësoj siç zgjidhet edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, dhe do të ketë strukturë të njëjtë dhe do të ushtrojë funksione të njëjta.

Për më tepër, komunat me shumicë serbe në Kosovë mund t'i bashkëngjiten këtij asociacioni me dëshirën e tyre dhe mund të largohen nga i njëjti përsëri me dëshirën e

tyre. Një komunë mund të jetë pjesë e dy mekanizmave të tillë, apo asociacioneve, varësisht prej vullnetit të tyre.

Komunat me shumicë serbe në Kosovë mund të zgjidhen të bëhen anëtare e cilitdo asociacion që ekziston në Kosovë, bazuar në vullnetin e tyre, por natyrisht se mund të bëhen anëtare të një apo më shumë asociacioneve, ashtu siç e mundësojnë ligjet tona, që e rregullojnë vetëqeverisjen lokale.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Si përfundim, tashmë baronesha Eshton, pra mbrëmë, është takuar në Bruksel edhe me presidentin e Serbisë Nikoliq, kryeministrin Daçiq dhe zëvendëskryeministrin Vuçiq, për të marrë pajtueshmërinë e tyre për propozimin e bërë.

Ne kemi dëgjuar deklaratat kontraverse mbrëmë nga presidenti Nikoliq lidhur me rezultatet e takimit dhe presim qartësi zyrtare nga Brukseli sot gjatë ditës.

Gjithashtu, të enjten, pra pasnesër, ne do ta kemi mundësinë të dëgjojmë drejtpërdrejt nga baronesha Eshton për rezultatet e takimit të mbrëmshëm në Bruksel dhe për mënyrën se si pritet të vazhdojë procesi në të ardhmen.

Si do që të jetë, ne e dimë se Serbia do të vazhdojë me manovrimet deri në pafundësi, prandaj me të drejtë presim që në takimin e radhës, që do të mbahet më 20 mars në Bruksel, ne ta mbyllim edhe këtë çështje dhe të kalojmë në përpilimin e zbatimit e marrëveshjes në praktikë.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka hyrë pothuajse në fazën e vet përfundimtare.

Unë, siç e theksova në fillim, në emër të institucioneve të Kosovës, në Bruksel do të insistojë që ky proces të përmbyllet me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila duhet të nënshkruhet nga të dy kryeministrat, dhe garantues të zbatimit në praktikë duhet të jetë Bashkimi Evropian dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë, që janë në Kosovë.

Në javën e ardhshme unë pres që ekipi i Bashkimit Evropian të përgatisë në detaje aspektet teknike të kësaj marrëveshjeje dhe planin e detajuar të afateve kohore për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në temat që janë diskutuar në kuadër të këtij dialogu.

Në këtë aspekt, ne kemi marrë garanci nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ky proces do të përmbyllet me marrëveshje të shkruar dhe garantues të zbatimit të saj patjetër që do të jenë BE-ja, me mbështetje të SHBA-së.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që edhe një herë të ju falënderoj për mundësinë që më keni krijuar për t'iu informuar për rrjedhën e bisedës deri më tani.

Më lejoni në të njëjtën kohë të ju falënderoj për idetë dhe këshillat tuaja të çmuara, që i keni dhënë deri më tani, në shërbim të këtij procesi. Unë dëshiroj të ju siguroj se delegacioni i Kosovës me saktësi do t'i përmbahet vetëm mandatit të dhënë nga ju, të nderuar deputetë, nëpërmjet Rezolutës të miratuar për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Gjithashtu, i falënderoj edhe liderët e LDK-së dhe AAK-së për mirëkuptimin që kanë treguar për t'i dëgjuar opinionet tona, shqetësimet tona, shqetësime që i kemi ndarë bashkërisht dhe për mbështetjen që i kanë dhënë këtij procesi në takimet e përbashkëta të mbyllura që i kemi pasur këto ditë.

Natyrisht, edhe liderët z. Petroviq, z. Yagcilar, dhe të gjithë liderët e komuniteteve tjera.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që të vazhdoj të flas edhe për një çështje gjithashtu të freskët. Ashtu siç edhe ishte paralajmëruar, baronesha Eshton mbrëmë është takuar zyrtarisht me delegacionin e Serbisë, të kryesuar nga presidenti Nikoliq, në Bruksel.

Ky takim, sipas informatave të mia zyrtare, ka pasur një qëllim të vetëm: që Serbisë t'i ofrohet edhe një herë mundësia për ta pranuar propozimin që e ka bërë delegacioni i Kosovës në takimet e kaluara për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Ky asociacion, siç e kam thënë tashmë disa herë, është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.

Propozimi ynë për formimin e këtij asociacioni përkrahet plotësisht nga BE-ja dhe SHBA-ja. Në të njëjtën kohë, dëshiroj të risqaroj se ky asociacion do ta ketë të njëjtin rol, funksion dhe strukturë, siç e ka edhe projekti tjetër i komunave të Kosovës.

Nga kjo që thashë më lart, dëshiroj të qartësoj, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, gjithë skenën politike kosovare, qytetarë të Republikës së Kosovës, opinionin publik ndërkombëtar, se deklarata e mbrëmshme e presidentit të Serbisë, Nikoliq, përveç që tregon një papjekuri të madhe politike nga ai, po ashtu është krejtësisht e pavërtetë, pra një gënjeshtër e kulluar tradicionale e politikës së Beogradit.

Ju e dini se ata humbjet i shpallin vazhdimisht fitore, prej Betejës së Kosovës, në Rambuje, Marrëveshjes së Kumanovës, kur është larguar ushtria dhe policia serbe më 1999, ata ngrinin dollin e shampanjës në Beograd, prandaj aq sa është e vërtetë deklarata e Slobodan Milosheviqit, në qershor '99 për luftën në Kosovë, po aq e vërtetë është deklarata e Nikoliqit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe

Serbisë.

Pra, është një gënjeshtër tipike tradicionale, e kulluar, e politikës zyrtare të Beogradit, që humbjet gjithmonë i prezanton si fitore.

Si do që të jetë, ne jemi këtu, vazhdojmë, në çdo angazhim tonin do ta respektojmë në plotësi Kushtetutën e Kosovës, ligjet e Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Tani fjala është e juaja, të nderuara zonja dhe zotërinj,

Sipas renditjes, po ua japë fjalën në emër të grupeve parlamentare atyre që e kanë kërkuar. Zoti Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari kryeministër,

Ministra, kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është informuar në detaje për takimin e fundit të kryeministrit dhe i jep mbështetje të plotë vazhdimit të procesit të gjetjes së një zgjidhjeje për normalizimin e raporteve. Ne përsëritim mbështetjen që në vazhdimësi i kemi dhënë këtij procesi si një proces shtetëror, si një agjendë shtetërore, e cila ka për qëllim shtrirjen e sovranitetit faktik të Republikës së Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, procesin e normalizimit me Serbinë dhe fillimin e një agjende evropiane për Kosovën.

Ne e morëm një informatë mjaft të detajuar të kryeministrit dhe tani kur procesi po shkon drejt finalizimit është jashtëzakonisht me rëndësi që debatet në Parlament të jenë më të shpeshta dhe më gjithëpërfshirëse, sidomos në vigjilje të finalizimit të marrëveshjes. Të kyçen të gjitha partitë politike dhe ato ta japin kontributin e vet në këtë marrëveshje. Dhe, është jashtëzakonisht mirë që baronesha Eshton do të jetë në këtë javë këtu në Kosovë, do të takohet me tërë spektrin politik. Është një mundësi e mirë që të jepet kontributi, sugjerimet e të gjitha partitë politike dhe ne presim që të gjitha partitë politike ta luajnë një rol konstruktiv në këtë proces, sepse definitivisht ky është një proces shtetëror, nuk është një agjendë qeveritare, nuk është një agjendë partiake, por një agjendë shtetërore, ku kërkohet edhe unitet, edhe vendosmëri, edhe një përgjegjësi e lartë.

Më lejoni që të ndalem në dy momente që i ngriti kryeministri në informatën e dhënë me këtë rast.

Momenti i parë ka të bëjë me finalizimin e këtij procesi me një marrëveshje ndërkombëtare dhe ne e mbështetim plotësisht qasjen që kryeministri e prezantoi, që procesi duhet të finalizohet me një marrëveshje ndërkombëtare, të garantuar nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Dhe, ne kërkojmë që kjo marrëveshje të hartohet me kritere të larta profesionale, të shikohet detajisht, të shikohen elementet legale dhe kushtetuese, në mënyrë që kjo marrëveshje të jetë plotësisht në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e Kosovës dhe t'i nënshtrohet sistemit kushtetues dhe legjislativ të Kosovës.

Kjo marrëveshje ndërkombëtare duhet t'i mundësojë tri gjëra.

E para, fillimin e vendosjes së gjendjes kushtetuese dhe ligjore në veri. Atje e kemi një gjendje plotësisht jashtë-kushtetuese dhe jashtë-ligjore.

Momenti i dytë, shpërbërja e të gjitha strukturave jokushtetuese që veprojnë atje, filluar nga strukturat e sigurisë, krijimi i strukturave qeverisëse legjitime, në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, funksionalizimi i sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe të gjitha segmentet tjera që i parasheh Kushtetuta e Kosovës, e që deri më tani nuk janë zbatuar në pjesën veriore, edhe për shkak të një cenimi të integritetit bazues në Kushtetutë, që e ka bërë Serbia.

Do të ndalem në një çështje, në të cilën kryeministri me të drejtë edhe konsumoi më së shumti kohë – në çështjen më të përfolur – në çështjen e asociacioneve të komunave.

Të nderuar kolegë,

Tani po shohim se kanë rënë të gjitha ato përpjekjet, retorika politike e krijimit të një autonomie, statusi special të një Republike Sërpska, dhe ato po shihen se kanë qenë një retorikë, sepse kanë qenë të pamundshme, sepse ato, jo vetëm që do ta cenon rendin kushtetues, por do ta cenonin edhe kualitetin e pavarësisë tonë, të cilën e kemi negociuar dhe për të cilën kemi bërë kompromise të rënda në procesin e koordinimit të pavarësisë.

Sa i përket asociacionit, duhet dhënë tri elemente politike, të cilat janë shumë të rëndësishme.

E para, ky mekanizëm ka bazë legale në pakon e ligjeve të qeverisjes lokale në konceptin dhe Pakon e Ahtisarit, por edhe në praktikat evropiane dhe ne insistojmë që ky asociacion të themelohet dhe të funksionojë brenda pakos legjislative të Kosovës dhe brenda praktikave të mira evropiane për qeverisje lokale dhe ne urojmë që praktika të mira të bashkëpunimeve ndërkomunale të mos vlejnjë vetëm për Kosovën, por të shtrihen në tërë regjionin, e sidomos në Republikën e Serbisë, ku qeverisja lokale fare nuk është funksionale.

Momenti i dytë, absolutisht zbërthimi i kompetencave të asociacionit, që do të bëhet, besoj tani në këto takime, duhet të jetë një proces shumë i vëmendshëm dhe duhet të kemi kujdes nëse nuk ka autonomi, të mos kemi as simetri sa i përket këtij asociacioni. Të mos kemi diçka që mund ta cenojë funksionimin unik të sistemit kushtetues të Kosovës dhe ne kërkojmë që kompetencat e këtij asociacioni të jenë tri llojesh.

E para, të jenë kompetenca kryesisht të bashkëpunimit ndërkomunal. Ne i kemi të qarta kompetencat e qeverisjes lokale dhe kërkojmë që ky asociacion të merret me bashkëpunimin ndërkomunal brenda Ligjit për qeverisje lokale.

Çështja e dytë e këtij asociacioni është sesi ky asociacion do të integrohet në strukturat që i përmendi kryeministri.

E para, ky asociacion nuk guxon të zgjidhet drejtpërdrejt. Përfaqësuesit e këtij asociacioni duhet të jenë kryetarët e komunave, të dalë nga zgjedhjet lokale, një proces që duhet të zhvillohet brenda ligjeve të Kosovës, e assesi të lejohet një cikël i zgjedhjeve ku këta përfaqësues të asociacioneve do të zgjidhen drejtpërdrejt, sepse kjo do ta cenonte rendin kushtetues. Ne e kemi edhe asociacionin e komunave shqiptare dhe ne e dimë si funksionon. Funksionon me kryetar të zgjedhur të komunave dhe i njëjti princip duhet të formohet edhe sa i përket këtij asociacioni.

Integrimi i këtij asociacioni në Këshillin e Komuniteteve, që e përmendi kryeministri, është diçka normale. Integrimi eventual, një përfaqësues i tyre në disa mekanizma tjerë, është e lejueshme, derisa këta nuk krijojnë strukturë qeverisëse ekzekutive. Dhe, duhet pasur kujdes - asnjë kompetencë e cila asocion në çfarëdo procesi të vendimmarrjes ekzekutive të këtij asociacioni nuk duhet lejohet, sepse do ta cenojë seriozisht rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Jemi të sigurt se debatet që do të zhvillohen për këtë asociacion se do të jenë debatet kryesore tani, sepse Serbia definitivisht e ka parë që nuk mund të flitet për kurrfarë statusi të ndonjë autonomie apo statusi special, apo Ahtisari plus, por ata janë duke kërkuar edhe një rrugë dalje nga iluzionet që kanë krijuar te opinioni serb për Kosovën dhe në atë rrugë dalje ata po japin edhe deklarata kontraverse retorike, të cilat i dëgjuam dje dhe ne i sugjerojmë kryeministrit që të mos merret shumë me këto deklarata apo thjesht ta çojë procesin përpara me përvojën që e ka dhe ne jemi të sigurt se kryeministri me lidhshirëpin e treguar në procese edhe më të vështira, në procese shumë më të vështira, kur Kosova ka qenë në gjendje të vështirë, do të arrijë që ta udhëheqë këtë proces dhe do të arrijë që t'i mbrojë interesat e Kosovës dhe do të arrijë që në këtë marrëveshje të paktën të fillojë ta funksionalizojë plotësisht sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe në një mënyrë do të fillojë edhe një agjendë e re evropiane për Kosovën, sepse do të ju vijë fundi destruksioneve serbe.

Pakoja e Ahtisarit ka ofruar gjithçka për serbët. E ka ofruar një pozitë asimetrike për komunitetin serb, por jo pozitë asimetrike territoriale, jo mundësinë e krijimit të ndonjë hibridi territorial, apo të ndonjë sistemi territorial të qeverisjes. Dhe, ne u bëjmë kërkesë të gjitha partive politike që të kyçen, të japin kontribut tani në finalizim të procesit. Ne po e implementojmë një proces shumë të rëndësishëm për Kosovën, prandaj t'i japin sugjerimet e veta, në mënyrë që ky proces të finalizohet edhe me një konsensus, apo unitet të të gjitha partive politike, në mënyrë të veçantë përgjegjësi kanë partitë shtetformuese, partitë që kanë qenë pjesë e procesit të Ahtisarit, pjesë e procesit të përgatitjes dhe koordinimit të pavarësisë së Kosovës, në mënyrë që ne në Kuvend, me një konsensus çfarë na duhet në çështjet e karakterit shtetëror, ta përmbyllim këtë proces dhe ta hapim një epokë, një agjendë të re për Republikën e Kosovës në proceset e integrimit evropian.

Edhe një herë konkludoj, grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i jep mbështetje procesit të deritashëm dhe është e sigurt që në këtë proces Qeveria e Kosovës, kryeministri, Parlamenti do t'i mbrojnë interesat shtetërore të Kosovës, do t'i mbrojnë interesat Kushtetuese dhe do të mundësojnë që pjesa veriore, më në fund, të fillojë të

integrohët, të vendosim sundimin e ligjit, sundimin e Kushtetutës, të vendosim pavarësinë e Kosovës edhe në atë pjesë, e cila deri më tani, për shkaqe që të gjithë i dimë, ka qenë e penguar me destruksione. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sinqerisht që në fillim po e them se nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga ajo që herën e kaluar kemi dëgjuar në këtë Kuvend, prej raportit të kaluar nga zoti kryeministër, dhe po ashtu edhe ne, të gjithë që jemi këtu, duke filluar prej vetes, po e them se nuk kem shumë nevojë të moralizojmë, në kuptimin e asaj se s'ka diçka të re që ne do të duhej të thoshim, e që nuk e kemi thënë, por po e përsëris edhe një herë qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Që të gjithë e dinë, ne kemi qenë dhe mbetemi që çështjet e kontestueshme, nëse mund të thuhet ashtu, ose çështjet që kanë të bëjnë me normalizimin e marrëdhënieve të bëhen me dialog, por që kjo në asnjë rrethanë nuk nënkupton që të shkelen sovraniteti dhe integriteti, tërësia territoriale e vendit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe Rezoluta e miratuar në këtë Kuvend.

Edhe herën e kaluar, edhe sot, e përsëris që asociacioni i komunave me shumicë serbe si asociacion është i normuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. E kemi thënë, edhe sot e them, nuk është ndonjë urgjencë. Mund të bëhet pasi të mbahen zgjedhjet atje, nëse është i nevojshëm të bëhet, por si duket presioni kryesor është në këtë që të bëhet, por presioni nuk duhet të nënkuptojë që edhe ne të pranojmë dosido çfarëdo asociacioni në kuptimin e kompetencave. Këtë e kemi thënë dhe asnjëherë nuk është e tepërt ta përsëritim që për ne është shumë i papranueshëm dhe sigurisht nuk do ta përkrahim asociacionin, i cili del jashtë asaj që e përcakton Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, asociacion i cili eventualisht në çfarëdo mënyre e cenon sadopak Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, po ashtu edhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Edhe një arsye tjetër që nuk e shohim që ky asociacion është i dobishëm nga fakti se gjithë politika e këtij vendi, vendore dhe ndërkombëtare, ka qenë angazhimi shumë i madh që të ketë integritet të komunitetit, në këtë rast atij serb, në jetën institucionale dhe ne e shohim që me këtë asociacion e bëjmë të kundërtën. Ne kështu punojmë kundër integritetit të tyre, sepse tash vjen koha që ata ta bëjnë një asociacion, të mblidhen bashkë dhe të punojnë në një mënyrë apo tjetrën ndaras nga asociacioni që e kemi aktualisht. Domethënë, kjo është kundër një politike integruese dhe është absolutisht kundër parimeve për të cilat e kemi pasur vazhdimisht gojën plot, po pse jo edhe angazhimin e plotë të të gjitha institucioneve, duke përfshirë të gjithë ata që i kanë përfaqësuar institucionet, në këtë rast edhe vetë zotin Thaçi.

Edhe një herë e përsëritim që asnjë pranim, asnjë pajtim nga ne nuk do të jetë që nëse krijohet ky asociacion të ketë ingerenca legjislativë, aq më pak ekzekutive. Ne dëshirojmë t'i besojmë këto që i thotë zoti Thaçi, por derisa nuk i kemi të shkruara sot

është bërë vështirë vetëm me fjalë, sepse fjalët po luajnë, po ndryshojnë, e kjo është e keqja e gjithë kësaj.

Ne kërkojmë sërish që çdo marrëveshje e arritur të vijë dhe të ratifikohet në këtë Kuvend. Ky është, fundi i fundit, obligim i yni kushtetues, ky është mandat yni dhe ne asgjë më shumë, as më pak nuk kërkojmë nga zoti Thaçi, përveç asaj që ta respektojë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ta respektojë Rezolutën e këtij Kuvendi dhe që, sikur ky që e ka këtë obligim kushtetues, e kemi edhe ne si Kuvend që ta mbrojmë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, ta mbrojmë Rezolutën, prandaj edhe insistojmë dhe kërkojmë që në fund të këtij procesi dialogues çdo gjë që arrihet të vijë në këtë Kuvend, sepse ky është mandati ynë, ky është obligimi ynë kushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Negociatat që po zhvillohen ndërmjet kryeministrit Thaçi dhe Ivica Daçiçit, përveç që po e çojnë Kosovën drejt thellimit të ndarjes, përbëjnë edhe negociatat më jotransparente që kanë ndodhur ndonjëherë në këtë vend. Ato janë edhe më të fshehta bile se negociatat e Vjenës, sepse në Vjenë të paktën dilnin dokumente të caktuara, të cilat binin në dorë të medieeve, e pastaj publikoheshin dhe kështu mund t’i lexonin qytetarët dhe ta dinin më saktësisht se çfarë po ndodh me vendin e tyre.

Në negociatat e Brukselit flitet nga 4-5 orë për veriun e Kosovës, e nuk ka kurrfarë transkripti se çfarë është biseduar, dhe krejt kjo përfundon me një komunikatë të shkurtër nga zyra e zonjës Eshton. Për shembull, komunikata e fundit e Eshtonit e ka pasur vetëm një fjali. Një komunikatë vetëm me një fjali! Tash merreni me mend çfarë transparence mund të zhvillohet vetëm nëpërmjet një fjalie se çfarë ka ndodhur në takimet, të cilat kanë zgjatur ndonjëherë edhe dy ditë. Vetë Bashkimi Evropian do të duhej të shqetësohej me nivelin e transparencës kaq të mjerueshme të negociatave me Serbinë.

Mungesa e transparencës tregon se këto negociata kanë qenë më shumë të koncentruara në marrëveshje xhentëlmene ndërmjet dy kryeministrave sesa në prodhimin e dokumenteve konkrete dhe të shkruara. E Kosova historikisht ka kujtesë shumë të lidhur prej marrëveshjeve xhentëlmene.

Por, me aq sa ka kuptuar opinionin publik, në rundin e fundit i këtyre negociatave mësohet se po flitet për krijimin e një mekanizmi të përbashkët të komunave serbe brenda Kosovës. Këtë mekanizëm, Qeveria jonë po e quan asociacion, kurse Serbia bashkësi. Por, thelbi është se janë pajtuar të krijohet një mekanizëm institucional etnik në Kosovë.

Unë me këtë rast dua t’i shtroj tri pyetje, dua t’i shtroj tri çështje shumë të rëndësishme lidhur me relativizmin që po ua bën kjo Qeveri këtyre veprimeve të veta.

E para, kur flasim për negociatat me Serbinë dhe krijimin e asociacionit të komunave do të shtrohet një pyetje: A do të ishte krijuar ky asociacion i komunave serbe po të mos

kishte qenë kjo ide në platformën e Serbisë për Kosovën? Shtrohet pyetja. A do të ishte krijuar? Sepse po të ishte kjo punë qejfi dhe për të mirën e Kosovës, me siguri që Qeveria jonë nuk do ta kishte pritur Serbinë për të dhënë ide kaq të mira.

Pra, është e qartë se këtu po negociohet dhe po bëhet kompromis mbi idetë, të cilat po vijnë faktikisht prej Serbisë.

E dyta pyetje që do të shtrohet: Pse Serbia të na tregojë neve si shtet se në çfarë mënyrë duhet të jenë të rregulluara asociacionet tona të komunave. Nëse kjo qenka çështje veç e Kosovës, atëherë pse të dialogohet me Serbinë kjo punë? Pse Serbia të na tregojë që t'i kemi dy asociacione të komunave?

Kur do të pavarësohemi ne nga Serbia, që ajo të mos vendosë më për çështjet tona, që ne të jemi të pavarur në vendimmarrje për çështjet tona? Sepse, kur je i pavarur nuk ke nevojë ta pyesësh një shtet tjetër, aq më tepër një shtet armiqësor, siç është Serbia, se çfarë asociacioni të komunave duhet të krijojmë ne.

Dhe, çështja e tretë, pyetja e tretë që do ta shtrojnë qytetarët e Kosovës, e me siguri që e shtrojnë është: Nëse ky asociacion i komunave, siç po thotë kryeministri dhe kjo Qeveri, i ka kompetencat e asociacionit aktual të komunave, këtij asociacioni që e kemi ne aktualisht, atëherë pse të mos funksionojë brenda këtij asociacioni?

Kompetencat qenkan të njëjta! Asociacioni qenka i njëjtë! Pse, të mos jetë i njëjti trup? Pse të krijohen dy trupa?

Kjo logjikë, që institucionet në Kosovë të dyfishohen me bazë etnike, është shumë e dëmshme për shtetin e Kosovës. Kjo logjikë është antishtetërore. Kjo është sikur të thuhet njëjtë, ky asociacion i komunave duhet ta ketë edhe policinë e vet, dhe mos u frikoni se policia do t'i ketë të njëjtat kompetenca me Policinë e Kosovës. Kjo është e njëjta logjikë.

Kjo nuk është logjikë shtetndërtuese, sepse shteti i ka autoritetet e tij qendrore, shtetërore, kurse autoritetet lokale janë të nënrenditura. Dhe, kjo ndodh në çdo shtet normal. Këtu po ndodh krejtësisht e kundërta!

Vetë fakti se kjo Qeveri po shkon atje dhe me Serbinë po negocion se çfarë kompetencash do të ketë ky lloj mekanizmi që po krijohet, është shqetësuese sa të doni. Sepse, ne jemi dëshmitarë se këta nuk janë politikanë që shkojnë në negociatave për të dalë prej negociatave. Këta nuk janë politikanë që i refuzojnë negociatat atëherë kur nuk pajtohen. Këta ne i njohim mirë. Këta janë politikanë të kompromisit dhe të marrëveshjeve edhe atëherë kur këto marrëveshje na dëmtojnë ne si shtet.

Prandaj, këta politikanë, po të kishin qenë që nuk pajtohen që ky asociacion të kishte kompetenca ekzekutive, do të kishin dalë prej negociatave: “Nuk po pajtohemi me idenë e Serbisë, po dalim prej negociatave, edhe ditën e mirë!” Por, halli është se këta janë aty për ta arritur marrëveshjen. Ky është halli. E marrëveshja do të jetë edhe më e keqe se Plani i Ahtisarit.

Në një paraqitje të fundit për media u tha po ashtu edhe nga ministri, edhe nga Qeveria, se nuk do të krijohet republikë serbe në Kosovë. Kështu po thotë edhe Serbia. Vulini tha nuk do të krijohet republikë serbe në Kosovë, sepse arsyetimi i tij, tash merreni me mend, tha nuk do të ketë ushtri, ajo që po e krijojnë nuk do të ketë ushtri. Po, tamam puna po të ketë edhe ushtri, kur ushtri nuk ka as Kosova që është republikë. Atë entitet, që Serbia synon ta krijojë në Kosovë, nuk do ta quaj republikë, mos u frikoni, por pavarësinë do ta ketë të shkëputur nga Prishtina, e ky është problemi - jo a do ta quaj republikë, a si do ta quaj.

Po ashtu, ajo që po e dimë tashmë, është që kryeministri dhe Daçiçi janë pajtuar që ky institucion i komunave që po krijohet do ta kapërcejë veriun dhe do t'i përfshijë edhe komunat tjera. Ky është lajmi, që e kemi marrë. Pra, Serbia në Vjenë ka kërkuar të krijohen komuna të reja serbe. Këto komuna janë krijuar me Planin e Ahtisarit dhe në emër të kompromisit. Tash, këto komuna Serbia po synon t'i përfshijë në institucionin që do ta kontrollojë vetë. Merreni me mend çfarë rrjedhe e proceseve.

Kurse, në anën tjetër, Serbia vazhdon të mos e pranojë edhe Planin e Ahtisarit, edhe po i arrin kompromiset, edhe po i merr komunat që janë krijuar me planin e Ahtisarit e po i fut në asociacion, edhe nuk po e njeh pavarësinë e Kosovës, po vazhdon të mos e njohë Pavarësinë e Kosovës. Atëherë, shtrohet pyetja: Ku është çmimi i gjithë kësaj? Pse po bëhen të gjitha këto?

Ideja e qeveritarëve dhe e ndërkombëtarëve, ju e mbani në mend kur është pranuar Plani i Ahtisarit, ka qenë që veriun do ta bëjmë sikur pjesa tjetër; veriun do ta bëjmë sikur këto komunat, që janë integruar mirë.

Tash merreni me mend çfarë po ndodh! Këto komuna që paskan qenë shembull i mirë, janë ato që po i bashkohen veriut të Kosovës, këtij asociacioni që do ta ketë bazën në veri të Kosovës. Marrëveshja që po duan ta arrijnë për veriun, nuk është shpërbërje e strukturave të paligjshme të Serbisë, siç po thuhet, por është legalizim i këtyre strukturave.

Qeveria po ua fsheh të vërtetën qytetarëve. Tashmë e keni dëgjuar se si kryeministri i ka amnistuar të gjitha strukturat tjera, përveç ato të sigurisë, që po përmenden. Të tjerat nuk po përmenden.

Kjo do të thotë që Qeveria e Kosovës është pajtuar që strukturat e shëndetësisë, të arsimit, të fushave tjera, do të vazhdojnë të punojnë me ligjet e Serbisë. Arsimi do të funksionojë nëpërmjet teksteve mësimore të botuara në Beograd. Por, do të bëjnë marrëveshje që pjesëtarët e MUP-it dhe strukturave tjera kriminale të sigurisë, që po kontrollohen nga Beogradi, të bëhen mekanizëm që e siguron asociacionin e komunave që do të krijohen.

Kjo nuk është shpërbërje e strukturave të Serbisë. Kjo nuk ka lidhje me shpërbërjen e strukturave të Serbisë. Kjo është njohje e strukturave të Serbisë.

Shtetet e ndryshme dhe popujt e botës, kur kanë probleme siç kemi ne, të kësaj natyre, kur kanë problem me një pjesë të territorit të vet, ato të paktën bëjnë përpjekje që problemin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjala është e kryetarit të Grupit Parlamentar të AAK-së, zotit Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se deri më tani po provojmë që të kemi besim, se në këto që po thuhet, do të qëndrojmë si Kosovë. Do të thotë, që asociacioni i komunave, i cili krijohet në bazë të ligjeve që i kemi, nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe definitivisht nuk do të ketë kompetenca legislative, të cilat do të ishin më problematike.

Por, sidoqoftë, ne po shohim se në bisedimet në Bruksel ka dy lloj planesh për vendin tonë fqinj.

Çështja e parë është normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën dhe çështja e dytë është avancimi i marrëdhënieve me Unionin Evropian.

Mendoj se edhe Kosova duhet filluar të mendojë në këtë plan për avancimin e marrëdhënieve me Unionin Evropian dhe ajo fjali, që e tha kryeministri, që ka të bëjë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, duhet të fillojë të qartësohet, cila është ajo pjesë tjetër, përpos normalizimit eventual të marrëdhënieve me Serbinë, që do t'i avanconte marrëdhëniet e Kosovës me Unionin Evropian, përkatësisht me Bashkimin Evropian.

Ne, edhe pse në opozitë, me kënaqësinë më të madhe do ta kishim mbështetur një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi ndërmejt Kosovës dhe Unionit Evropian. Edhe pse jemi në opozitë, me kënaqësinë më të madhe do ta kishim mbështetur një marrëveshje për liberalizimin e vizave, edhe pse e kemi tepër të qartë që pas raportit të fizibilitetit i cili ka ardhur, kjo gjë është goxha e vështirë për shkak të gjendjes në Kosovë, jo për shkak të Unionit Evropian.

Edhe një herë mendoj se kryeministri duhet ta ketë të qartë se i ka 19 ministra në Kosovë dhe nuk janë të gjithë në Bruksel, se këta të tjerët mund të kryejnë punë këtu. Do të thotë, nuk është krejt Qeveria në negociata dhe nuk mund të justifikohet se për shkak të agjendës së bisedimeve dhe të Unionit Evropian, të tjerët nuk mund t'i kryejnë punët e veta. Përndryshe, pse i ka këtu 19?

Edhe një herë po e përsëris, për Aleancën është jashtëzakonisht me rëndësi që të shihet edhe plani tjetër, jo vetëm normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Por, të shihet edhe avancimi i marrëdhënieve të Kosovës me Unionin Evropian, si pjesë e një marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E dëgjuam raportimin e kryeministrit nga takimi i radhës në Bruksel. Dhe, me këtë rast mund të them se kryeministri e përfaqëson Kosovën edhe në bazë të Kushtetutës, edhe në bazë të Rezolutës, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Dhe, në këtë aspekt, ne duhet t'i japim përkrahje, ndoshta edhe vërejtje, për arsye se Kosova është e të gjithëve, dhe në këtë rast Kosova është e të gjitha subjekteve politike, që marrin pjesë me deputetët e vet në Kuvendin e Kosovës dhe atyre tjerëve, që janë jashtë Kuvendit.

Në rast se e shohim raportimin e kryeministrit, kryeministri tregoi se si ka shkuar procesi i dialogut kësaj radhe në Bruksel, ndërmjet baroneshës Eshton dhe përfaqësuesve të shtetit serb. Dhe, u pa që kryeministri gjatë raportimit tregoi se çështja e bisedimeve është kah vjen nga fundi i finalizimit të marrëveshjeve, marrëveshje të cilat do të jenë ndërkombëtare, të garantuara nga BE-ja dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës.

Mirëpo, gjatë diskutimit të kryeministrit u kuptua se çështja e këtyre marrëveshjeve, të cilat do të finalizohen në fund të bisedimeve dhe pas ardhjes së zonjës Eshton në Kosovë, do të flasë me të gjithë liderët e partive politike. Shihet se komplet çështja është fillimi i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, shpërbërja e strukturave të të gjitha llojeve në veri të Kosovës dhe formimi i asociacionit të komunave serbe me shumicë, për çka dashtë Zoti që të jenë garantues BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe që ky asociacion të mos kenë kompetenca të veçanta, por si të gjitha asociacionet tjera që i kemi.

Shpresojmë dhe besojmë që finalizimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, të garantuara nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, të jenë në harmoni me Rezolutën, e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe me Kushtetutën dhe ta kemi një stabilizim-asociim të marrëdhënies ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Miletij, në emër të Grupit Parlamentar SLS.

PETAR MILETIĆ: Poštovani gospodine potpredsedniče Skupštine,

Članovi Vlade,

Koleginice i kolege poslanici,

Danas po peti put imamo priliku da od premijera Kosova, gospodina Tačija, budemo informisani o toku dijaloga, koji u Briselu vodi sa premijerom Srbije, gospodinom Dačićem.

Takođe, po peti put u ime Samostalne liberalne stranke, pružam sa ovog mesta naj snažniju podršku i ohrabrenje svim učesnicima ovog procesa, da što pre dođu do rezultata i implementiraju dogovoreno.

Iako mislim da nema političke zainteresovane osobe na Kosovu, koja ne prepoznaje politički stav Samostalne liberalne stranke, o njenoj potpunoj posvećenosti dijalogu, kao jedinom načinu rešenja problema na Kosovu i regionu, smatram da i danas treba da sa ovog mesta podržim učesnike Briselskog dijaloga. To ne radim da bih dao puku podršku pregovaračima, jer je ono od strane Samostalne liberalne stranke pitanje principa, i nije ničim uslovljena. Ovo radim zbog toga što aktuelna tema, koja je pred pregovaračima naj složenija, a politički i bezbednosno najosetljivija.

Teme severa Kosova i paralelizma institucija zahtevaju mnogo mudrosti, pragmatičnosti i političke hrabrosti. Ne spadam u ljude koji događajima čiji su savremenici daju istorijsku dimenziju, ali je nesporna činjenica da će od kvaliteta rešenja u ovoj rundi razgovora direktno zavisiti kvalitet života generacija.

Koristeći autoritet ove institucije i ove govornice, želim te predložiti poziciju srpske zajednice pred nastupajući sastanak u Briselu. Nisu isti ni problemi, ni okolnosti, ni doživljaji Briselskih dogovora kod srba južno i srba severno od Ibra. Na to se danas mora gledati kao na datu činjenicu. I pored toga, mi smo isti narod, čiji se interesi sa svim njihovim specifičnostima moraju sagledavati u celini.

Odgovornost premijera, kao i odgovornost njegovog kolege Dačića u Briselu, ogleda se u kvalitetu rešenja po građane, koje ta rešenja tangiraju.

Takođe, moraju se uvažiti interesi zajednica, čije postojanje i prosperitet garantuje Ustav Kosova.

Do kakvog god dogovora bude došlo oko funkcionisanja ili transformacije institucija, posebno se mora voditi računa da dogovoreno bude sprovodivo, bez ostavljanja prostora za pravni vakum, ili zloupotrebe nedovoljno preciznih ili nereálnih rešenja. Rešenje će, to nas iskustvo uči, biti osporavano sa mnogih strana. Iskustvo mi takođe daje za pravo da tvrdim da se osim kritike neće nuditi nova i bolja rešenja.

Busanje u grudi profesionalnih patriota, zajedničko i srbima i albancima, ali nam ozbiljnost problema koji sticajem okolnosti baš mi moramo rešiti, zahteva da se izdignemo iznad toga, bez obzira na buduće političke napade.

Mi iz Samostalne liberalne stranke smo podneli najveći teret izgradnje opština sa srpskom većinom, i na tom poslu radimo i danas. Postoje vidljivi rezultati tog rada. Baš ti rezultati moraju se razmatrati u dijalogu kao iskustvo, koje može pomoći u novim izazovima. Pri tom mislim i na pozitivna i na negativna iskustva.

Mislim da su dragocena iskustva kako su to opštine Gračanica, Štrpce, ili Parteš postali lokalni i administrativni centri srba južno od Ibra. Kako se u ovim opštinama radilo na

smirivanju tenzija, a povećanju infrastrukturnih radova? Gde se i zašto grešilo? Kako su to danas baš opštine sa srpskom većinom u vrhu kosovskih opština po procentu naplate poreza, taksa, troškova električne energije?

Posebno želim da istaknem da je peti sastanak premijera Tačija i Dačića za nas važan, jer je to po prvi put u Briselu bio predsednik Samostalne liberalne stranke i zamenik premijera, Slobodan Petrović. I to je posebno važno da su zbog toga, da su iskustva koje mi predstavnici srba u institucijama Kosova posedujemo jako važno, kako se ne bi lutalo i grešilo u implementacijama dogovora.

U nadi da će nastupajuće nedelje doneti dobre vesti za građane, i da će se postići kvalitetna, prihvatljiva i održiva rešenja, još jednom se zahvaljujem premijeru na redovnom informisanju Skupštine o ovom važnom poslu, koju u Briselu obavlja.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “6+” nuk është paraqitur askush. Vazhdojmë me deputetët. Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Të nderuar deputetë dhe të nderuara deputete,

Si edhe të gjithë qytetarët e Kosovës, veçanërisht ne deputetët kemi obligime që me vëmendje t’i përcjellim takimet, të cilat mbahen në Bruksel, të kryesuara nga kryeministri ynë dhe përfaqësuesit e Serbisë.

Takimi i fundit, që tani është duke u trajtuar në këtë Kuvend, takimi më 4 mars, ma ka tërhequr vëmendjen edhe në aspektin vizual, fotografitë dhe imazhet që kanë ardhur nga ai. Dhe, me këto të dhëna tani që na i plotësoi edhe kryeministri, bashkë me ato imazhe, do të përpiqem të shkoqis disa aspekte asimetricke dhe simetrike të takimit, siç do të thoshte një koleg yni.

Unë, për veten time, dëshiroj ta dëgjoj kryeministrin, sikur edhe qytetarët e Kosovës, që të thotë çdo herë pas takimit: ‘Kurrë, kurrë, kurrë nuk do të cenohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës!’. Dhe, sa herë që ai e përsërit këtë, neve këtu në këtë sallë dhe qytetarët e Kosovës në çdo cep të saj do të jemi më të relaksuar dhe besueshmëria do të jetë gjithnjë e më e lartë.

Sa herë që të thuhet se do të respektohet Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, ligjet e pushtetit lokal dhe Kushtetuta e Kosovës, si akt themeltar i shtetit të Kosovës, dhe do të bëhet vendosja e rendit dhe ligjit, respektimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në ato pjesë ku deri më tani nuk është respektuar, natyrisht se nuk ka dilemë aspak në ecurinë e këtyre bisedimeve dhe në epilogun e tyre.

Nuk ka transkript më përmbajtjesor, nuk ka mesazh më kuptimplotë, nuk ka transparencë më të madhe sesa fotoja e takimit të fundit nga këto bisedime, e cila e krijon imazhin asimetric dhe zbërthimin simbolik të epilogut të takimit. Dikujt edhe mund të mos i duket i rëndësishëm në aspektin protokollar, dikujt dhe shumëkujt i është dukur si lëshim i

delegacionit tonë që në tavolinat e tyre nuk ka figuruar asnjë letër. Për mua, për të gjithë analistët e vëmendshëm, për të gjithë qytetarët e përgjegjshëm dhe të gjithë qytetarët e emancipuar, kjo foto dhe ky fakt flasin shumë.

Flasin shumë për qëndrimin e delegacionit tonë dhe për takimin simbolik, i cili rrezaton në aspektin politik dhe në leximin e gjithë asaj që mund të lexohet mbi tavolinë dhe nën tavolinë. Në të gjitha ato mesazhe që thuhën dhe në ato që nuk thuhën. Për mua, ishte mjaft impresiv. Asnjë deklaratë e kryeministrit tonë, asnjë deklaratë e delegacionit tonë nuk do të më impresiononte më shumë se sa fotoja e këtij takimi, e cila është atakuar në shtypin tonë të verdhë, është atakuar shumë nga ata që e kanë analizuar këtë takim.

Për veten time, dëgjoj trajtime nga më naivet, për qëllime të cilat manifestohen në opinionin tonë publik dhe bëhen me qëllim për ta përvetësuar, për ta manipuluar. Kjo, përveçse është përpjekje e kotë, është edhe fyese për emancipimin tonë politik, nacional e qytetar të shtetasve të Kosovës, sepse s'mund të spekulohet diçka që të gjitha vrojtimet nga qytetarët e Kosovës, nga të gjithë ata që janë involvuar në përgatitjen, në përcjelljen dhe në dizajnimin e epilogut të këtyre takimeve, të mos dihet paraprakisht për të gjithë ata që janë të vëmendshëm se çfarë po bisedohet dhe cilat janë qëllimet.

Hiq karizmin e lidërshiptit tonë, hiq shkallën e përgjegjësisë, hiq nivelin e përgjegjshmërisë, ngaqë këto takime bëhen me transparencë, bëhen para opinionit publik vendor dhe ndërkombëtar, qytetarët e Kosovës absolutisht nuk e kanë as më të voglin argument që të dyshojnë në sinqeritetin e qasjeve të përfaqësuesve tanë.

Madje, kur dëgjoj deklaratat pas takimit, edhe të përfaqësuesve tanë, edhe të përfaqësuesve të delegacionit të Serbisë, ma kujtojnë një fakt, që më sjellin në mesin e viteve të '80-ta, kur për herë të parë u takuan nivelet intelektuale të Kosovës dhe të Serbisë, në takimin e shkrimtarëve në Novi-Sad. Atje, në atë takim, shkëlqyen të gjitha mendjen e ndritura dhe korifentë e letrave shqipe, të cilët u vlerësuan jashtëzakonisht nga të gjithë përfaqësuesit, madje edhe nga një shkrimtar i Serbisë, i cili nuk mundi të mos e thotë dhe nuk mundi ta fshehtë, natyrisht, nivelin shkëlqyes të përfaqësuesve tanë, të shkrimtarëve të Kosovës.

Gjithashtu, këtë dallim dhe këtë disnivel e hetoj edhe në deklaratat e përfaqësuesve tanë dhe të Serbisë. Aty, jo vetëm që shoh një qëndrim të ngurtë të përfaqësuesve të Serbisë, por shoh edhe një deficit në formimin e tyre të gjithanshëm, politik, profesional, edukativ dhe madje-madje e shoh një naivitet të papërshkrueshëm, sepse bëhet për ta manipuluar oponencën e tyre të brendshme. Por, natyrisht, është fyese edhe për vetë përfaqësuesin e një populli, të cilin ata, jo vetëm klasën politike, por edhe popullin e tyre e përfaqësojnë.

Unë, për veten time, do ta përforcoja idenë e të gjithë atyre që kanë besim në këto bisedime, se këtu nuk mund të ketë dhe nuk guxon të ketë asnjë lëshim nga përfaqësuesit tanë, sepse vetë përkushtimi dhe përgjegjësia e tyre e deritashme tregon se në bisedime e kanë krijuar një eksperiencë dhe në këto bisedime do të shkëlqejnë edhe kësaj radhe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Sot, edhe një herë po diskutojmë për një temë, që kemi pasur rastin sa herë t'i themi mendimet tona. Dhe, unë edhe një herë përkujtoj mbështetjen e këtij Parlamenti që dialogu të jetë si një qasje për arritjen e progresit dhe rezultateve, sidomos në dy fusha: në forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës, dhe integrimin e komunave Leposaviq, Zveçan, Zubin-Potok në sistemin e Kosovës.

Pra, janë rezultate që ne i presim dhe mendojmë se është në interes të të gjithëve dhe të institucioneve, por në interes edhe të qytetarëve.

Dhe, tani flasim për dialogun nganjëherë në kuptimin e ngushtë, nganjëherë në kuptimin e gjerë, për idenë e asociacionit të komunave, por edhe shumë çështje tjera, që nganjëherë edhe nuk diskutohen, siç janë çështjet e resurseve nacionale në atë pjesë, hekurudha, transporti, telekomunikimi, rezervat ujore, e tjera e të tjera, që nuk e dimë se a janë temë, por që sigurisht edhe në ato fusha kemi interes që të sigurojmë pozicione të fuqishme, të qarta dhe bashkërisht me funksionimin e sektorit të drejtësisë, të pushtetit lokal, pastaj qasjes së institucioneve në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre në këto fusha.

Unë shumë pak do të mbetem brenda idesë së asociacionit të komunave. Realisht, në shpjegimin e parë, që konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 31, e drejta e komunave që të organizohet në asociacione, neni 32, që përshkruan mënyrën e bashkëpunimit të komunave, pastaj neni 4 i Ligjit për bashkëpunime ndërkomunale, dhe në disa nene, format dhe procedurat e atij bashkëpunimi, që lidhen me nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, pra të kompetencave dhe fushave ku komunat mund të bashkëpunojnë.

Por, ka dy parime themelore, që kjo të mund të funksionojë ashtu siç duhet:

E para, dihet saktësisht se cilat janë kompetencat komunale dhe ato nuk duhet të preken. Dhe, gjithsesi gjithë ky bashkëpunim, qoftë asociacioni i komunave, apo marrëdhëniet bilaterale, apo multilaterale ndërmjet komunave duhet të ndërtohen mbi parimin, në fushat ku komunat janë përgjegjëse me miratimin e ministrisë përkatëse, pra përgjegjëse, dhe njëkohësisht gjithmonë duke ditur se ky është organizim dhe bashkëpunim vullnetar. Dhe, vendimmarrja nuk mund të zhvendoset nga niveli komunal, nuk mund të zhvendoset nga një nivel që një nivel tjetër të përcaktojë se cili është vullneti i komunave dhe procedurat që duhet ndjekur.

Prandaj, automatikisht përjashtohet, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, mundësia që ky asociacion i komunave apo ky bashkëpunim ndërkomunal të ketë kompetenca legjislative. Në anën tjetër, nuk parashikohet, jo vetëm me ligjet e Kosovës, po fare me ligje të pushtetit lokal, as konform Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, që një institucion, cilido qoftë i mesëm, a qendror, të marrë

vendime që t'i obligojnë komunat se si do t'i ushtrojnë ato përgjegjësi të veta dhe si do të bashkëpunojnë ato më tutje. Prandaj, me këtë e eliminojmë, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, në mënyrë automatike mundësinë që ky asociacion, konform ligjeve tona, të ketë kompetenca legjislativë dhe ekzekutive.

Dhe, tani shtrohet pyetja: Problemi qenka i thjeshtë? Në realitet, cila është brengosja dhe cila është dilema që po krijohet te të gjithë ne. Gjithmonë, kjo është si një preventivë. Ne nuk kemi marrëveshje që do të kishte mundur të dëshmonte se po cenohet kjo. Nuk e dimë. Por, cila është brengosja jonë që ne paraprakisht po diskutojmë?

Pikërisht, duhet ditur se si kanë funksionuar këto komuna gjatë këtyre 13-14 vjetëve, pra në forma të jashtëligjshme, voluntere, bazuar në terror, bazuar në krim politik dhe ekonomik. Pra, krijohet baza se edhe aty ku mund të konsiderohet se po arrihet marrëveshje, ne kemi dilemë se si do të funksionojë ajo pjesë e Kosovës.

Në anën tjetër, deklaratat që vijnë nga Beogradi dhe nga disa zyrtarë nga Brukseli dëshmojnë se cila është ambicia. Ambicia pra është që të krijohet pavarësi financiare, që të krijohet organizim politiko-territorial, që të menaxhohet me resurset nacionale, jo vetëm ato lokale dhe që në mënyrë artificiale të krijohet një fuqi në nivelin qendror, që sa do ta kishte rritur fuqinë artificialisht pra, konform numrit të banorëve, po ashtu të bëhet pengesë e funksionalizimit të shtetit të Kosovës, duke filluar nga ky Parlament, Qeveria, asociacioni i komunave dhe nivelet komunale atje.

Unë do të përkujtoj edhe diçka. Ata që kanë qenë, ka këtu në këtë sallë që kanë qenë, jorastësisht ka ardhur deri te varianti përfundimtar i Pakos së Ahtisarit, që ne sot e kemi Kushtetutën dhe ligjet dhe është një komponentë jashtëzakonisht e rëndësishme e pathënë, por shumë lehtë e lexueshme përbrenda.

Përveç që me Pakon e Ahtisarit konstatohet se status quo-ja është e paqëndrueshme dhe e dëmshme, ajo jep mundësi që të lëvizet më tutje në vullnetin politik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, që ka rezultuar me pavarësinë e Kosovës, pastaj definimi i qartë i të drejtave jashtëzakonisht të fuqishme, jo vetëm për mentalitetin ballkanik dhe për një shtet të ri, siç është Kosova, por edhe për shtetet që e kanë një demokraci shumë më të zhvilluar, që flitet për komunitete, në rend të parë për komunitetin serb.

Mirëpo, jo që nuk e ka nuhatur presidenti Ahtisari dhe ekipi, por edhe delegacioni i Kosovës, se cilat janë rreziqet eventuale në Kosovë. Është pikërisht kjo, që tani pretendohet nga Beogradi të bëhet, pra lidhja e komunave.

Prandaj, të gjitha ato kompetenca të fuqishme nuk kanë mbetur në nivelin e mesëm, por ua ka dhënë komunave dhe kjo tani është letër e djegur, në mënyrë që konform Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës atje të organizohet një nivel i tretë, sepse është anakronike. E gjithë Evropa dhe bota shkon në decentralizim - delegimi i kompetencave ekzistuese nga niveli qendror te niveli lokal, ndërsa në ato tri komuna tani tentohet të merren kompetencat nga komunat dhe të dërgohen në nivelin lokal.

Dhe, çka nëse kjo ndodh në gjithë Kosovën. Ne do ta shuajmë komunën e Graçanicës, Parteshit, Ranillugut, Shtërpçës?

Pra, nëse vërtet dëshirojmë sistem unik, i cili jep përgjigjen kryesore, jo vetëm se cilat marrëveshje do të bëhen. Çka një ditë pas marrëveshjes? Çka një vit pas marrëveshjes?

A do të jenë ato marrëveshje që do t'i realizojnë këto qëllime dhe do ta krijojnë një shoqëri funksionale, me të drejta të fuqishme për të gjithë qytetarët e saj dhe do të krijojë një perspektivë, edhe të integritit, jo zgjedhje të cilat e çimentojnë këtë gjendje, ndoshta edhe, përkundrazi, ushqejnë ambicie për një dezintegrimit të mëtejshëm.

Prandaj, duke marrë parasysh edhe çështjet e resurseve nacionale edhe të këtij asociacioni të komunave, që ne po themi, normalisht që ne, po flas tani personalisht, i mbështetim dhe ne dëshirojmë, urojmë, sepse ky është delegacion i Kosovës, në krye me kryeministrin dhe të tjerët.

Urojmë që këto të jenë zgjedhjet që janë këtu. Mirëpo, duhet edhe një diçka ta kemi parasysh të gjithë, duke e ditur se cila është ndjeshmëria dhe këto tentime, marrëveshjet duhet të jenë shumë precize, sepse edhe një presje degradon, edhe një presje lë vend për interpretime bivalente, por në anën tjetër edhe tendenca që të krijohet sovranitet bivalent atje, nuk është rrezik i vogël.

Prandaj, nuk do të kisha dëshiruar që dikush pas një viti të tregojë se ne patëm menduar kështu, por në realitet kjo zgjidhje po na del kështu.

Prandaj, urojmë që fjala e kryeministrit, që pas nënshkrimit të marrëveshjes të jetë kjo që e dëgjuam, sepse do ta japim mbështetjen. Por se ka rreziqe, ka rreziqe dhe ne dëshirojmë që për ato rreziqe sot të bisedojmë, por jo të bisedojmë pas marrëveshjes.

Prandaj, edhe një herë dhe, në fund, do ta them edhe këtë: isha në lajthitje kur e dëgjova deklaratën e presidentit të Serbisë, që ne do të japim aq të drejta, pra kërkojmë aq të drejta të serbëve sa do t'u japim shqiptarëve. Dhe, ndoshta nga adrenalina e shtuar, shpresova se është një ndërrim i madh në Serbi dhe ajo thënia, që dikush ia thoshte më herët Milosheviqit, ki kujdes ku po e çon këtë popull, mendova se këtu po ndërpritet, sepse e kemi tani një strukturë, që do të diferencohet nga ajo e kaluar.

Ne nuk kemi fuqi që t'ia imponojmë kërkim-faljen Serbisë dhe pagesat e dëmeve të luftës e të gjenocidit, pastaj të prishjes së raporteve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve si fqinjë, por llogarita se është një ndryshim dhe, kur i shikova prapë lajmet, ai bëri lojë fjalësh dhe tha: ato të drejta që po ua japim shqiptarëve në Kosovë.

Ato të drejta nuk i ka dhënë, por sikur të thoshte, se kaq të drejta do t'u japë shqiptarëve në komunat Preshevë e Bujanoc, sikur do të kishim filluar të besojmë se atje po ndodh diçka tjetër. Por, fundja, ne i kemi punët tona, ata i kanë punët e veta. Ne besojmë në rrugën tonë, por duhet fuqimisht të qëndrojmë në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së

Kosovës, sepse fundja kemi edhe garanci të ndërkombëtarëve e të partnerëve, me të cilët kemi ardhur deri këtu, se kjo do të jetë zgjedhja e qëndrueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

E dëgjova me shumë vëmendje raportimin e kryeministrit, të cilin nuk mund ta quaj as përshkrim gazetaresk, sepse ishte aq deskriptiv për gjëra të parëndësishme, sa m'u duk tamam nga ato raportimet sa për ta larë gojën, nuk kishte përmbajtje, nuk kishte thelb dhe nuk shihej se po raporton një kryeministër, por ndonjë shkruar ose përshkruar takimesh.

Si do që të jetë, shumë gjëra i kam thënë në lidhje me asociacionin dhe marrëveshjet që po pretendohen të arrihen në seancën e kaluar dhe nuk kemi shumë çfarë të shtojmë, por ajo çfarë desha të theksoj unë është që, në fakt, ia tërheq vëmendjen kryeministrit në lidhje me një çështje, të cilën vetëm sa e konfirmova nga një vizitë në Sllovaki, por jam e bindur që edhe në vende të tjera.

Arsyeja se pse disa vende nuk e pranojnë Pakon e Ahtisarit ka të bëjë pikërisht me precedentin që ka vendosur kjo pako, ose me frikën, në fakt, që ngjall për vendosjen e një precedenti, për shkak se i trajton në mënyrë të tillë minoritetet. Pra, u jep jashtëzakonisht shumë të drejta. Të drejta që asnjë vend i Bashkimit Evropian, s'po flasim për vende të tjera, nuk ua ka dhënë minoriteteve. E kam fjalën këtu për të drejtën e vetos, për shembull për ndryshimin e Kushtetutës, për vendet e garantuara, për eksterritorialitetin dhe mendoni tani edhe për një pushtet të asociacionit të komunave serbe, që është një nivel i mesëm i pushtetit.

E vërteta është që edhe vetë Serbia nuk e pranon Pakon e Ahtisarit pikërisht për shkak të kësaj frike, jo se nuk i pëlqejnë të drejtat që kjo paketë i jep komunitetit serb në Kosovë, por për faktin e thjeshtë se nëse do ta pranonte dhe do ta nënshkruante, duhet që të njëjtën gjë ta aplikojë edhe për minoritetet që janë në Serbi, për shembull, për shqiptarët në Luginën e Preshevës.

Por, Serbia sigurisht që është e vendosur që atje, jo vetëm që as përfaqësohet të mos ua japë këto të drejta, por t'i diskriminojë dhe t'i detyrojë ata që ta braktisin vendin e tyre.

Prandaj, ajo që unë desha t'i atërheq vëmendjen kryeministrit, është se ka shkuar tepër larg me Pakon e Ahtisarit dhe imagjini tani, sikur të shkojë edhe më tutje, siç është për shembull kjo që mund ta quajmë Ahtisari plus, edhe pse ka kërkesa për të mos e quajtur ashtu, mirëpo ne i dimë dhe i kuptojmë proceset.

E vërteta është që çfarëdolloj negociatash, çfarëdolloj marrëveshjeje që arrihet tani është mbi këtë marrëveshje, pra shkon përtej kompetencave që ka dhënë Pakoja e Ahtisarit. Kjo, sepse jo vetëm që e dëmton Kosovën, jo vetëm që i dëmton interesat e shtetit të Kosovës, por kjo ngjall edhe frikë në vendet tjera, të cilat frikësohen që të shkojnë kaq

larg me dhënien e të drejtave, sepse sigurisht që krijon destabilizim të brendshëm te secili vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar, kryesues,
I nderuari Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Po vazhdojmë diskutimet, të cilat në fakt i filluam edhe kur kryeministri raportoi herën e kaluar dhe, siç kemi theksuar edhe atë ditë, krijimi i asociacioneve të komunave e ka një bazë ligjore në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Ajo që kryeministri e prezantoi këtu lidhur me fizionominë, kompetencat dhe lidhur me mënyrën e formimit dhe të punës së këtij asociacioni mbetet brenda kornizave të kësaj kornize ligjore dhe Kushtetutës së Kosovës.

Megjithatë, duket se lufta po bëhet rreth kompetencave dhe rreth kompromiseve eventuale për këto kompetenca. Dhe, ne po e dëgjojmë palën serbe, e cila thotë se pala kosovare nuk po bën lëshime, nuk po bën kompromise, e ne po bëjmë lëshime dhe po bëjmë kompromise. E pikërisht, duhet pritur pra që pala kosovare të jetë nën presion dhe mendoj se ne këtu duhet t'i japim mbështetje të fuqishme që pala kosovare të qëndrojë brenda kësaj kornize dhe brenda planit të Ahtisaarit, për arsye se pala kosovare ka qenë shumë gjeneroze dhe i ka bërë të gjitha lëshimet e mundshme deri në maksimum me Planin e Ahtisaarit, kurse Serbia nuk e ka bërë asnjë lëshim, nuk i ka pranuar qëndrimet e bashkësisë ndërkombëtare, nuk i ka pranuar kartat evropiane për të drejtat e qeverisjet lokale dhe të minoriteteve.

Prandaj, vërtet, për rrugën evropiane, nëse dikush duhet të bëjë lëshime për qeverisjen lokale dhe për të drejtat e minoriteteve dhe duhet t'u përshtatet këtyre kartave dhe këtyre standardeve, ajo është Serbia. E Serbia nuk po bën asnjë lëshim, pos po bën një ecje të ngadalshme, të mundimshme, që t'i pranojnë standarde të cilat Kosova veç i zbaton një kohë të gjatë.

Sa i përket Kosovës, edhe lëvizjet më të vogla në kompetenca, duke marrë parasysh se ky do të jetë një asociacion njënacional i komunave me shumicë serbe, duke marrë parasysh politikën serbe që të krijojë probleme në funksionimin e shteteve në rajon, ajo këto problem i bën sot në funksionimin e Bosnjës. Po të mos ishte ndikimi i Serbisë në Bosnjë dhe vetoja e Republika Sërpska, sigurisht Bosnja deri sot do ta kishte njohur Kosovën.

Domethënë, problemi është që politika aktuale serbe ende nuk është liruar nga tendencat e dominimit në rajon dhe tendencat e krijimit të problemeve në rajon. Prandaj, në qoftë se e dimë se kjo ende ekziston, në qoftë se e dimë një status quo të gjatë në këto komuna dhe në qoftë se i dimë tendencat e këtyre komunave që t'i ruajnë strukturat e tashme, në një formë, apo në një formë tjetër ilegale, të cilat krijojnë probleme në funksionimin e ligjit në tërë territorin e Kosovës, pra çdo lëshim krijon një hapësirë me një fokus të rrezikshëm dezintegrues dhe të dëmshëm për kohezionin e Republikës së Kosovës.

Andaj, ne sigurisht duhet ta mbështetim kryeministrin që të mbetet në atë dhe të qëndrojmë dhe t'i ndihmojmë me argumente për gjithçka që duhet bërë, që të mos e kalojmë atë vijë të kuqe, në të cilën ne jemi edhe me Planin e Ahtisarit. Pra, jemi në vijën e kuqe praktikisht.

Prandaj, duhet të krijohen, sipas mendimit tim, nëse duam që edhe nëse bashkësia ndërkombëtare dëshiron që investimet e saj të mëdha në përmirësimin e gjendjes në rajon dhe krijimin e paqes dhe të perspektivës në rajon, atëherë ne duhet të dalim pak përtej mënyrës se si të bisedojmë për këtë çështje.

Mendoj se çdo stabilitet afatgjatë në rajon, në rrugën e integritit evropian, nuk do të jetë i suksesshëm pa një simetri, pa një drejtpeshim në të drejtat e minoriteteve në tërë rajonin e Ballkanit. Prandaj, një pako, një standard i të drejtave që i kanë serbët në një shtet në Ballkan duhet t'i kenë edhe në shtetin tjetër, kuptohet ka aty-këtu ndonjë specifikë.

Por, esenca duhet të jetë aty dhe në këtë drejtim për të siguruar, për t'i ikur këtij fokusi dezintegruës që krijohet në Kosovë me asociacionin e komunave serbe, ne patjetër duhet të insistojmë që edhe komunat shqiptare në Preshevë ta krijojnë asociacionin e tyre, me ingerenca, me forma të ngjashme të punës, por asnjëri as tjetri sigurisht nuk duhet të kenë kompetenca ekzekutive dhe legjislative, por të dy duhet të ekzistojnë dhe ne duhet ta mbështetim edhe me fond për zhvillimin e asaj pjese, se ajo është pjesa më e pazhvilluar e Serbisë, më e diskredituar, edhe në arsim, edhe në punësim, edhe gjithkund.

Prandaj, bashkësia ndërkombëtare duhet ta pranojë këtë logjikë dhe ne duhet ta mbështetim këtë logjikë, sepse nëse e mbështetim këtë logjikë dhe me një përparim në integrimin evropian të Kosovës, të Serbisë dhe vendeve tjera, edhe tensionet nacionale dhe tendencat për dezintegrime do të jenë më të vogla, dhe eventualisht, po them, ky model do të kishte shanse për një sukses dhe krijimin e një stabiliteti dhe një paqeje.

Çështje tjetër? Ne dëgjuam këtu se bisedat dhe negociatat për normalizim po shkojnë kah përmbyllja. Ka mbetur çështja e telekomunikimeve, domethënë e kodit për telekomunikim dhe çështja e energjisë, që janë çështje shumë të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme. Unë mendoj se me marrëveshje, në qoftë se tash krijohet një marrëveshje, që ka për synim normalizimin e marrëdhënieve, patjetër duhet të mbetet obligimi që pasojat e luftës, pasojat e qeverisjes segreguese, të qeverisjes dhe akteve gjenocidale që i kanë lënduar të drejtat dhe pronën e njerëzve, duhet të trajtohen. Të dyja vendet duhet të shprehin gatishmëri, sepse asnjë pajtim dhe normalizim i marrëdhënieve nuk mund të bëhet, nëse fajtorët që kanë krijuar aq shumë fatkeqësi në këtë rajon mbeten të padënuar.

Prandaj, duhet të mbetet një qëndrim, një obligim, në qoftë se tash nuk mund të përmbyllet, do të ishte mirë që të përmbyllet, por duhet të mbetet obligimi që kjo çështje të zgjidhet. Edhe çështja e të pagjeturve, edhe të gjitha çështjet që ne i kemi theksuar këtu, sepse normalizimi dhe integrimi evropian i një apo i dy vendeve nuk mund të bëhet me një barrë të tillë të rëndë, e cila krijon gjithmonë tensione dhe probleme në marrëdhëniet reciproke, me këtë edhe në gjithë rajonin. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar zoti kryesues,

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qëndrimet të cilat janë duke u ofruar në përmbylljen e këtyre marrëveshjeve në vija të trasha, të cilat do të kërkojnë edhe më tutje diskutim me Serbinë me ndërmjetësimin ndërkombëtar, evropian dhe amerikan, pas këtyre përmbylljeve, sigurisht do të jenë detaje, të cilat do të tregohen.

Unë përkundër përkrahjes së vazhdueshme, që ia kam dhënë këtij negociimi, i cili është duke u bërë për zgjedhjen e problemeve shekullore dhe dekadore me Republikën e Serbisë, mendoj se tash ka ardhur koha që t'i adresojmë shqetësimet tona te Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për perspektivën e Republikës së Kosovës.

Ne e dimë që Republika e Serbisë do ta marrë datën, ndërsa Kosova duhet të ketë disa garanci, për të cilat nganjëherë mendoj që Bashkimi Evropian është shumë subjektiv karshi vlerësimeve të perspektivës së Kosovës dhe angazhimit të Kosovës si aspiruese për të qenë pjesë e familjes evropiane.

Izolimi që është duke iu bërë Kosovës dhe faktet, të cilat nxirren për MSA-në, unë mendoj që ka shumë subjektivizëm, sepse ka shtete të tilla në rajon, të cilat janë trajtuar në mënyrë të tillë. Hiç më shumë, Republika e Shqipërisë është trajtuar mbi 12 vjet për të qenë e liberalizuar në qarkullimin, nën pretekstin se do të ketë emigracion të zgjeruar të popullatës shqiptare, ndërsa statistikisht sot tregojnë që Serbia dhe Maqedonia sot janë ato problemet në Evropë. E, sot përshkruhen shumë më të përkëdhelur sesa Republika e Shqipërisë dhe nesër edhe se Republika e Kosovës.

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë mjaft informacion për emigracionin ilegal dhe informacionin legal, prandaj qytetarët e Kosovës kanë nevojë të jenë pjesë vërtet praktike e familjes evropiane dhe të jenë të integruar edhe në institucionet bilaterale dhe multilaterale, të cilat janë në interes jetik të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, ne duhet ta dimë qartë edhe pozicionin tonë për Këshillin e Sigurimit, nën përkrahjen e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse s'ka asnjë arsye, as shtetet që e kundërshtojnë sot atë, që të jetë sot pengesë pas këtyre normalizimeve të cilat Serbia, nëse vërtet e ka për interes të jetë pjesë e familjes evropiane, ajo patjetër duhet të mos jetë pengesë, me ndihmën e Rusisë dhe Kinës, si përdorues të vetos në Këshillin e Sigurimit.

Këto çështjet tjera, të cilat janë duke u spekuluar nga udhëheqësit e Republikës së Serbisë, ne duhet t'i marrim si çështje normale spekulative, ndërsa shqetësimet që thuhet se ne po shkojmë në një tradhti, mendoj se nuk janë të qëndrueshme. Kosova është në interes të Bashkimit Evropian, që të largohet nga Kosova dhe të mos merret me përditshmërinë e Kosovës. Po ashtu edhe Serbia, por nuk do ta pranojë praktikisht, sepse e di qartë se të drejtat e minoriteteve janë maksimalisht të pranuar, në një konformizëm

politik, i cili është arritur në marrëveshjen e Ahtisarit. Prandaj, këto çështje janë të paqëndrueshme, të cilat tërhiqen më shumë për poenë politike. Por, ne duhet të jemi kërkuar dhe sqarues edhe në vizitën e baroneshës Eshton që do të ndodhë, nga lidhshipi ynë, edhe nga Qeveria, që të jetë saktësisht për perspektivën e Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, sepse votuesit tanë na kërkojnë ditë për ditë.

Skandalet, të cilat janë duke ndodhur edhe me emigracionin ilegal, edhe pamundësinë për të lëvizur, qoftë për shkollim, qoftë për shkëmbim shkencor e intelektual, edhe tregtar, edhe për bashkëpunime të tjera, në fushat tjera, janë duke e limituar perspektivën, apo duke e zbehur perspektivën e qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë pjesë e familjes evropiane.

Kjo perspektivë nuk duhet të na ulet nga Bashkimi Evropian, por duhet të na tregojë qartë se ne i takojmë asaj familjeje dhe ne nuk mund të shohim nga Lindja, por duhet të shohim nga Perëndimi. Mendoj që shqetësimet të cilat jemi duke i ngritur ne vazhdimisht, por edhe raportimet të cilat jemi duke i bërë, meqë ne po kërkojmë edhe raporte, mendoj që raportet me shkrim janë të shkruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nëse flasim në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk kemi nevojë të kërkojmë raporte tjera. Nuk kemi parë ende asnjë dokument, i cili është shkruar ose është nënshkruar nga Qeveria gjatë këtyre negociatave, përveç atyre të cilat janë të bazuara në Kushtetutë dhe të cilat ne i kemi miratuar këtu si Kuvend me Rezolutë, që i kemi dhënë të drejtë, në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të aprovohen këto ligje.

Në rast të kundërt, nëse arrihet deri te një marrëveshje, e cila në kornizë me vija të gjëra, atëherë mund të jetë edhe pjesë e debatit për ta analizuar një përmbajtje të tillë, e cila besoj do të jetë më sqaruese dhe më shpresëdhënëse për ata të cilët nuk kanë informacione të mjaftueshme dhe që nuk e pranojnë edhe Kushtetutën e Republikës dhe marrëveshjen e Ahtisarit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Kryesues i seancës,

Kryeministër, anëtarë të Kabinetit,

Raportimi i radhës, natyrisht që ka të bëjë me njoftimet që duhet t'i kenë deputetët dhe publiku në Kosovë.

Por, ajo që duhet edhe kësaj here të nënvizoj, ka të bëjë me atë që Kosova po kalon prej parimit të diskriminimit pozitiv në ambiguitet konstruktiv. Janë terme që duhen pasur gjithmonë parasysh, sepse kur ne po diskutojmë, po diskutojmë për diçka që vazhdimisht është e afirmuar, që Kosova ka jetuar me të, që Kosova e ka pranuar, ose nuk e ka pranuar. Por, parimi i diskriminimit pozitiv ka qenë i vendosur, ka qenë njëra prej parimeve në procesin e Vjenës, ndërsa tash në procesin e Brukselit po flasim për ambiguitet konstruktiv.

Dhe, kur të flasim për të drejtat, nuk mund të dialogojmë për të drejta të fituara, që mund të nënvizohen me të drejtat e presidentit Ahtisari, si pako e propozuar, por tash po flasim përtej saj, për procesin e baroneshës Eshton dhe gradualisht Ahtisari po kalon në hije, sepse Kushtetuta i ka absorbuar ato të drejta.

Ndërsa, procesi i baroneshës Eshton merret me përshkrimin apo ripërshkrimin e të drejtave, funksioneve angazhimeve që kanë të bëjnë kryesisht me integrimin apo normalizimin e raporteve dhe marrëdhënieve, që agjenda tashmë i ka nënvizuar.

Praktikisht, ne duhet të mos harrojmë asnjëherë se procesi i baroneshës Eshton, apo i Brukselit, po merret me këtë, me këto angazhime, që nënkupton përshkrim të të drejtave për komunitetin serbe, që përfshijnë të drejtat në vetëqeverisjen lokale dhe të drejtat tjera, sipas prodhimit që pritet të dalë nga procesi i dialogimit.

Atëherë, unë edhe një herë po nënvizoj se kemi të bëjmë me një normalitet, që vihet në Kornizën e Parimit të Kopenhagës, që nuk merret me pasojat e luftës, që nuk merret me problemet dhe marrëdhëniet që i kanë sot shqiptarët dhe serbët, apo që i kanë Kosova dhe Serbia, por merret me deblokimin apo ndërtimin e mekanizmit për deblokimin e shteteve, që në procesin e integritit evropian kanë nevojë shumë të madhe që të përfshihen me një dinamikë të re, sepse në qershor të këtij viti bëhen 10 vjet të procesit të integritit evropian, që Kosova me pjesëmarrjen në Samitin e Selanikut ka qenë për herë të parë e përfshirë. Një dekadë e tërë!

Nëse 9 vjet i janë dashur lëvizjes paqësore dhe ushtarake në Kosovë për ta zgjidhë statusin e Kosovës, tash 10 vjet nuk ka rrugë të qartë, nuk ka perspektivë të qartë dhe tash këto bisedime e kanë këtë kornizë, ndërsa problemi i normalizimit dhe i përballimit të marrëdhënieve vërtet të tensionuara dhe të luftës ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve është proces që do të ndodhë në një rrethanë dhe në një ambient krejt tjetër politik, sepse nuk besoj që është pjesë e kësaj agjende dhe do t'i zgjidhë këto probleme. Natyrisht që përfundimi i këtij procesi, sipas kësaj dinamike, është befasi e mirë, jo për shkak se rezultatet do të jenë afirmative, por për shkak që vërtet nëse deri në qershor mbyllet krejt procesi si i tillë dhe Kosova hyn nga perspektiva evropiane në një proces integruar evropian, nga izolimi në një listë të bardhë të lëvizjes së lirë apo të liberalizimit të vizave, tregon qartë që shumë çështje në përfaqësim dhe në rirregullim do të mbeten që vetë duhej t'i zgjidhë dhe do të duhej t'i realizojë.

Përmbyllja e krejt këtij procesi, ne jemi të vetëdijshëm, zoti kryeministër, se nuk po flasim për të drejta të fituara, por për të drejta të rishkruara që procesi do t'i prodhojë. Natyrisht që do t'i prodhojë dhe publiku është mirë me kohë të njoftohet në formën që e ke bërë, qoftë të raportimit, qoftë të draftit final, sepse rirregullimi, rishkrimi dhe ridefinimi i plotë i këtyre të drejtave, i këtyre marrëdhënieve që nesër krijohen, është vendosur në parimin e 7 pikave tashmë të afirmuara në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës dhe ruajtja e këtij parimi e ruan mosdëmtimin e procesit, por larg asaj, sepse deputetët e pozitës me tendencë për të siguruar që kryeministri nuk do ta degjenerojë procesin, po mundohen të na bindin që nuk kalohet kurrë jashtë atij procesi, që tash është i vendosur, apo jashtë atyre të drejtave që janë të vendosura.

Jo! Është e nënkuptueshme se procesi është i ri, procesi i ka parimet e veta dhe këto procese e këto parime do të determinojnë një normalitet apo jonormalitet. Varet krejt nga ajo çka do të prodhojë. Por, në fund, kurrë nuk është nëse nuk arrihet në implementim. Implementimi do të jetë kritik. Nesër do ta implementojmë, do të jetë kritik. Sa do të jetë funksional, do të jetë kritik, dhe sa do të jetë përfitues, do të jetë kritik. Kjo është ajo që duhet parë në situatën pas marrëveshjes eventuale dhe pas këtij “normaliteti” që pritet të ndodhë.

Atëherë nëse nuk na ka frikuar diskriminimi pozitiv, pse duhet të na frikësojë diçka që lidhet me procesin dhe përmbylljen e këtij procesi, përveç nëse vërtet eliminohet e drejta e autonomisë politike territoriale, që është ndarje de fakto e brendshme dhe kjo ndarje de fakto e brendshme me krijimin e shtresës së tretë të pushtetit e defunksionalizon në tërësi institucionin, shtetin dhe atëherë vijnë opsionet tjera gjithmonë në shprehje dhe janë më praktike sesa të jetohet me një tip të tumorit të madh në trup, që është 17 % e territorit të Kosovës, në të cilin nuk do të lejohet të jetohet normalisht, as funksionimin normal, por as nuk do të të mbytet. Nuk do të shkaktojë situatë mortale, por do të të mbajë në një situatë kur nuk mund ta kryesh funksionin si duhet dhe tumori do të zhvillohet dhe është jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe jashtëzakonisht i madh.

Atëherë, meqë u përmendën shumë modele, edhe një herë po e përmendi: ikni çdo lloji modeli, le jetë model i Kosovës, le të jetë model dhe le të shkruhet si model yni, i cili ka integruar totalisht, sepse nga ajo që unë po e shoh dhe që po e lexoj, po shkohet drejt modelit, po e përmendi edhe një herë - të tri komunave belge, gjermanofolëse në Belgjikë, që nuk është model i mirë. Është i mirë për belgët, por nuk është i mirë për Kosovën që të aplikohet këtu. Le të mbetet model yni dhe model i cili vërtet vendos normalitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Pas një interpelance të Lëvizjes “Vetëvendosje” ndaj kryeministrit Thaçi më 5 maj të vitit 2011, është votuar mocioni, i cili në pikën 3 e obligon Qeverinë e Kosovës me sa vijon: Qeveria e Kosovës ta informojë rregullisht, çdo tre (3) muaj, Kuvendin e Kosovës për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Kosovës.

Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë. Nuk ka raporte për avancimin e shtetit të Kosovës në asnjë fushë në veri të Ibrit.

Në anën tjetër, për këtë dialogun Kosovë-Serbi, e në fakt këto janë negociata ndërmjet dy qeverive për Kosovën, kryeministri vjen e raporton, pa na sjellë asnjëherë asnjë gjë të shkruar, ndërkohë që pas këtyre gjashtë takimeve me Daçiqin në Bruksel, të arriturat po quhen marrëveshje. Ky raportim që po bën këtu kryeministri, nuk është as informim, e lëre më raportim.

Marrëveshjet e takimeve Thaçi-Daçiq në Bruksel ishin marrëveshje xhentëlmenësh, që do të thotë se kishte besueshmëri të madhe ndërmjet atyre që bënë marrëveshje dhe mosbesim karshi qytetarëve të Kosovës.

Unë, si kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 11 shkurt të këtij viti, pra para një muaji, e kam ftuar kryeministrin që të vijë në komisionin tonë dhe të raportojë për bisedimet Kosovë-Serbi, në përputhje me planin dhe programin e punës së komisionit. Kryeministri, jo që nuk ka ardhur, por as që është përgjigjur. Është më keq sesa të kemi përgjigje negative, sepse nuk kemi përgjigje fare. Për dallim prej ftesës sonë, kur e ftojnë për takim me Daçiqin, Thaçi është për herë në gjendje gatishmërie dhe menjëherë përgjigjet pozitivisht.

Dialogu në Bruksel nuk është ndërmjet Kosovës e Serbisë, siç na thotë kryeministri, por dialog ndërmjet Beogradit e Prishtinës, siç e thotë edhe komunikata e mbrëmshme për shtyp e baroneshës Eshton. Edhe dialogu teknik, edhe dialogu politik, e kanë dëshmuar që statusi i Kosovës nuk është pavarësia, por Plani i Ahtisarit. Jo rastësisht, ky plan quhet Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Në anën tjetër, meqë ky plan quhet propozim, atëherë shtrohet pyetja propozim ndaj kujt? Ndaj Kosovës dhe Serbisë! Dihet që Serbia e refuzoi këtë propozim, andaj në negociata të mëtutjeshme kemi propozime shtesë, propozime të reja.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Rezoluta e 18 tetorit 2012 tashmë është shkelur. Unë e kam këtu me vete këtë rezolutë, me 6 pika. Përveç se është shkelur pothuajse në secilën pikë të saj, unë do të përqendrohem te pika e 6-të. Marrëveshjet e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve do të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pra, thotë ‘marrëveshjet e procesit’, nuk thotë ‘marrëveshja e procesit’, nuk thotë marrëveshja në fund, por marrëveshjet gjatë procesit. Kjo do të thotë që kjo rezolutë është shkelur në pikën e saj kryesore.

Por, të gjithë e dimë se kjo rezolutë nuk është bërë për t’u respektuar, por për ta mundësuar takimin e Thaçit me Daçiqin. Ajo është menduar për një përdorim. Ashtu sikur që nuk ndodhi as reforma zgjedhore dhe as shkurtimi i mandatit të kësaj Qeverie në dy vjet e gjysmë pas marrëveshjes së 6 prillit 2011, njësoj nuk po ndodh llogaridhënia ndaj Kuvendit dhe as respektimi i Kushtetutës pas asaj rezolute që u shit si garanci e sovranitetit dhe integritetit territorial e institucional të Kosovës.

Dokumentet ku opozitarët i bashkohen kryeministrit janë dokumentet më të nëpërkëmbura në Kosovë. Nuk besoj të ketë deputet të sinqertë e racionalë në këtë sallë që beson se tashmë nuk është shkelur Rezoluta e 18 tetorit 2012. Dhe, të gjithë ata që janë të sinqertë e racionalë, duke e ditur se u shkel kjo rezolutë, mbeten të sinqertë e racionalë vetëm kur mbajnë qëndrim për ndërprerjen e këtij dialogu.

Ulësja në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe ndonjë njohje shtesë për Kosovën, që po paralajmërohet nganjëherë, nuk e ndalojnë bosnjëzimin e Kosovës. Për më keq, ato mund ta lehtësojnë atë, duke thënë se ‘ja edhe Kosova e shqiptarët po fitojnë diçka’.

Marrëveshja e Dejtonit ka funksionuar kështu. Mirëpo, Dejtoni kishte për qëllim përfundimin e luftës në Bosnjë, kurse marrëveshjet në Bruksel kanë për qëllim afrimin e Serbisë me Bashkimin Evropian.

Oliver Ivanoviqi ka qenë deputet në Kuvendin e Kosovës, por sot ai është sekretar i të ashtuquajturës Ministri e Serbisë për Kosovën. Edhe ky asociacioni i komunave me shumicë serbe një ditë mund të vendosë të çintegrohet prej Kosovës dhe të dalë kundër pavarësisë e kundër Republikës së Kosovës. Madje, ky asociacion do të funksionojë si shantazh i Serbisë për Kosovën, pasi ai u sajua në marrëveshje me Daçiqin. Për shembull, në rast të ndonjë aksioni të shtetit të Kosovës kundër kriminelëve serbë në veri, apo gjatë çfarëdo përpjekje për bashkimin e Mitrovicës. Ose, në angazhimin dhe aktivitetet e Kosovës për integrim e bashkim me Shqipërinë, ky asociacion që e formoi Daçiqi, do të aktivizohet kundër kësaj.

Gjithashtu, po harrohet fakti që serbët edhe në komunat e Ahtisarit në jug të Ibrit nuk janë integruar as plotësisht, e as me të vërtetë. Madje, edhe në fshatrat me shumicë serbe që nuk janë në aso komunash. Në fshatin Shillovë të Gjilanit ka integrim të serbëve, përgjithësisht e kryesisht, në masën në të cilën nevojitet për të marrë para (si paga ose fonde). Arsimi e shëndetësia atje janë të ndara dhe pagat që merren nga Buxheti i Kosovës, merreni me mend, janë pa kontrata të punës.

Me këtë rast, i bëjmë thirrje Brukselit që ta braktisë këtë mënyrë të të ashtuquajturit 'normalizim i marrëdhënieve'. Bashkimi Evropian po i bashkon kriminelët e luftës në Serbi me kriminelët e korrupsionit në Kosovë për të vendosur për fatin e Kosovës dhe të popullit të saj. Këta vetëm sa po e amnistojnë njëri-tjetrin, Brukseli dhe faktorë të ndryshëm ndërkombëtarë po i amnistojnë ata, dhe tash përfliten amnisti të reja ndaj kriminelëve serbë në veri. Zgjidhjet që janë kaq të padrejta, jo vetëm që nuk janë të qëndrueshme, por nuk janë as zgjidhje.

Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Kosova po bëhet dykatëshe. Veçse ky mbindërtim është pa leje, dhe kurrsesi nuk duhet pranuar e legalizuar. Pas marrëveshjeve për Fondin zhvillimor për veriu dhe për asociacionin e komunave me shumicë serbe, vetë Beogradi do ta ndihmojë Thaçin që të mbetet në pushtet. Këtë gjë e kemi parë edhe në shekullin e kaluar. para Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri, e pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra

Unë e mirëpres informatën apo raportin, se po e quajmë herë ashtu, e herë kështu, të sjellë për të satën herë në Kuvend, sa do që nuk e kuptoj këtë prirje për ta ndërlikuar proceduralisht, rregullorja jonë ka krijuar mundësinë që Qeveria të dalë me deklarime sa

herë e konsideron të nevojshme dhe mendo që ky është formati më i mirë për ta adresuar këtë çështje, për t'u ikur edhe politizimeve.

Tani, për t'u kthyer te tema, unë kam qenë për bisedime dhe vazhdoj të mbetem i bindur se duhet të bisedojmë. Kosova nuk ka arsye t'u ikën bisedimeve, t'u thotë 'jo', dhe do të dëshiroja që sot të isha në situatë që së paku sa disa kolegë të opozitës të deklarohesha entuziast me procesin e deritashëm. Megjithatë, preferoj më përpara që të përpiqem të flas parimisht dhe një qasje e tillë ma bën të vështirë një optimizëm në këtë moment. Unë druaj se ne, megjithatë, kemi bërë dy gabime, për të cilat e ka tërhequr vërejtjen me kohë presidenti Kenedi, që të mos bëhen raste të tilla. Ai porosiste 'asnjëherë frikë për të biseduar dhe asnjëherë frikë pa bisedime'. Ne kemi hyrë në bisedime me hezitim dhe i jemi shmangur perceptimit të saktë dhe pozicionimit të sakët për to, dhe më vonë, bindja ime është që kemi mbetur në to dhe jemi sjellë me nonshalancë, dhe druaj që do t'ua paguajmë haraçin të dy këtyre qasjeve.

Unë e mirëpres informatën, por nuk mund të mos e përsëris vërejtjen time që vazhdimisht po bisedojnë pa letra. Raporti duhet të ketë letra, së paku aq sa ka. Pse ne t'i marrim letrat nga burimet tjera, shpesh të dyshimta? Mund të jenë spekulative dhe të vihemi edhe vetë në lajthitje. Pse të mos informohemi siç duhet? Dhe, vërejtja e dytë: Pse të mos e ndjekim rrugën institucionale të komunikimit? Pse këto çështje të mos bisedohen edhe në Komisionin për Punë të Jashtme, nëse këtë proces e konsiderojmë të jashtëm. Nëse e konsiderojmë të brendshëm, le ta dërgojmë në komisionet tjera. Kuvendi funksionon në plenare dhe në komisione. Pse nuk funksionon në këtë rast dhe në shumë raste të ngjashme?

Çështja tjetër që po na përsëritet është ngatërrimi me nocionet prej fillimit. Një herë nuk ka kurrfarë komunikimi, pastaj mund të ketë dialog, por jo bisedime. Tani po flasim për negociata. Çka ka ndodhur këtu? Pse nuk u sqaruan këto? U tha se do të ketë bisedime teknike, por kurrsesi politike. A janë tash politike? U tha dhe është thënë shpeshherë se nuk mund të bisedohet për çështjet të brendshme dhe e logjikshme do të ishte që për çështje të brendshme të bisedohet brenda. Tani këto që po bisedohen, janë të brendshme, apo të jashtme?

Dhe, vazhdon pastaj, në një variant shkruhet kufi, në kuptimin kufi administrativ, anglisht 'boardaries', dhe kështu është në variantin origjinal, kurse në shqip është kufi, në serbisht është kuptimi "razgraničenje, administrativne granice" e tjera. Nuk është e njëjta gjë. Nuk mund të shkojmë me këtë ambiguitete të kësaj natyre. Ose, si përfaqësohet Kosova, si Republikë e Kosovës dhe përfaqësuesit e Kosovës janë përfaqësuesit institucional të Kosovës, apo përfaqësues të institucioneve të vetëqeverisjes të përkohshme si po trajtohen në disa relacione dhe në këtë mënyrë? A po e pranojmë edhe një herë kthimin te Rezoluta 1244 dhe mund të vazhdohet, zonja e zotërinj, në këtë mënyrë. Por, ajo që tani është aktuale, është përsëri një ambiguitet. Për dikë është fjala për bashkësi të komunave, për dikë është fjala për asociacion të komunave.

Për dikë si bashkësi, si organizim territorial, bile autonomi politiko-territoriale dhe më shumë në të ardhmen, për dikë tjetër është një OJQ. Nëse është OJQ, e pse u dashka

qeveritë të merren me formimin e një OJQ-je? OJQ-të formohen në forma tjera. Dhe, pse u dashka të jetë ndërshtetërore për ta formuar një OJQ? Pse nuk ia vëmë emrin ashtu siç e ka? Nuk është çështja aq e thjeshtë, zonja e zotërinj. Edhe nëse duam ta harrojmë përvojën e Bosnjës, Republika Sërpska ka filluar pikërisht në këtë mënyrë, me bashkësi të komunave, dhe ka ardhur këtu ku ka ardhur. Asnjë komunitet në Bosnjë nuk është i kënaqur me atë zgjidhje. Edhe Evropa ka thënë disa herë, edhe faktorët të tjerë ndërkombëtar që bosnjëzimi është një zgjidhje e keqe. A mos po shkojmë pikërisht në bosnjëzim me këtë model?

Nëse kemi dilema, lexojini përfaqësuesit e politikës serbe. Edhe ata po e thonë qartë çka duan. Duan një bosnjëzim të Kosovës. Dhe, le ta shqyrtojmë, mos po rrëshqasim rastësisht në zgjidhjen me të keqe.

Asociacioni i komunave le të jetë edhe kështu. Dhe, çka do të thotë kjo - raporti i ndërtimit të një asociacioni të komunave etnike? Çka do të thotë për asociacionin e tashëm të komunave? Në asociacionin e tashëm, a janë komunat me shumicë serbe? A do të thotë se tash duhet ta prishim asociacionin që është multi-etnik dhe ta bëjmë një enklavizim të komunave? Dhe, a jemi në rregull me Kushtetutë në këtë mënyrë? Dhe, çka do të thotë ky model si precedent pastaj për zgjidhjet tjera? A është në përputhje me dokumentet ndërkombëtare, të cilave po u referohemi? Po i referohemi Kushtetutës! Nuk e ka kështu, zonja e zotërinj, nuk e thotë që duhet të jetë etnike. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nuk e ka kështu. Karta Evropiane për të drejtat e pushtetit lokal nuk e ka në këtë mënyrë. Përkundrazi, nuk gjen askund një referencë të saktë që e favorizon, ose aq më pak që e imponon organizimin ekskluzivisht etnik.

Dhe, a na duhet neve integrimi, pajtimi, funksionimi i shoqërisë qytetare siç e kemi thënë, apo kthimi në kohën e segregacionit e të enklavizimit. Më së shumti dëmtohet komuniteti serb dhe është demagogjike nëse kjo prezantohet në favor të komunitetit serb. U bëhet lëshim, jo qytetarëve serbë, do të isha për, nëse është në interes të qytetarëve serbë, por i bëhet lëshim Serbisë, Beogradit dhe strategjive destruktive të tyre. Nuk mund të mos jem kundër kësaj strategjie.

Edhe leximi i teksteve të Ahtisarit është po ashtu i njëanshëm, meqë këtu nuk kam kohë, unë ftoj që në një debat t'i diskutojmë dhe ta krahasojmë shprehimisht secilën prej këtyre formulave. Pastaj, edhe nëse u referohemi, çfarë po na ndodh? Si janë miratuar këto dokumente? Asnjëra prej këtyre nuk janë miratuar në mënyrë demokratike nga ky Kuvend. Të gjitha janë imponuar. Ka pasur edhe kundërshtime dhe nuk janë kuptuar kundërshtimet. Tani referenca thotë e 'keni miratuar, mbajeni'. A do të thotë që kjo edhe pas disa vitesh do të na thuhet 'e keni miratuar, atëherë ju e keni përgjegjësinë'.

Zonja e zotërinj,

Ky Kuvend ka përgjegjësi historike, prandaj duhet të ngrihet mbi këto kalkulime dhe të shikojë cila është vërtet zgjidhja më e mirë dhe cili është interesi i vendit. Për më tepër, këtu po flitet tani për një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Dakord, por a jemi pozicionuar që në fillim në mënyrë adekuate për të rezultuar me një dimension të tillë të relacioneve të ardhshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë? A i kemi plasuar siç duhet interesat e

Kosovës në këtë proces. Jo zotërinj! Dhe, këtu u përmendën disa, mund të përmend edhe unë. A janë përmendur këtu, ta zëmë, dëmet e luftës, ato krime, ato padrejtësi të mëdha, ajo plaçkitje e madhe dhe, në fund të fundit, nëse duhet të flasim dy shtete, dhe flasim për çështjen e pakicave, pse të mos i kthehemi atij obligimit tonë për t'i parë në mënyrë reciproke?

Ka pakica në Kosovë, ka pakica jashtë Kosovës. Le ta gjejmë parimin universal evropian dhe le t'i përmbahemi të dyja palët. Pse kjo qasje me dy kute? Për njërin bën, e për tjetrin nuk bën, dhe pse ne duhet gjithmonë të jemi ata që lëshojmë pe? Ndoshta edhe për ta marrë një vlerësim se qasja jonë ishte racionale. Nëse ka dy palë dhe njëra hiqet racionale, dhe e konsideron si maksimaliste formulën kompromise të Ahtisarit, e tjetra gjithmonë ankohet, ankoheshin edhe në Bosnjë kur e bënë çorbë atë, është e natyrshme që ndërmjetësuesi do të bëjë përpjekje t'i lëshojë pe pak më shumë atij që ankohet dhe ta dëmtojë këtë që qenka shumë i kënaqur.

Përfaqësuesit tanë nuk janë atje për të marrë poenë politike se janë djem të mirë dhe racionale. Edhe unë do të dëshiroja diskutimin tim ta dizajnoja ashtu dhe më besoni se di ta bëjë. Por, e kemi një mision tjetër. I përfaqësojmë ata që na kanë zgjedhur, e përfaqësojmë vendin, madje edhe brezat që vijnë, e të cilët nuk i kemi gjithmonë parasys.

E kemi edhe një obligim ndaj rezolutave të Kuvendit dhe, ju lutem, meqë po përmendën, le të citohen saktë. Parafolësi theksoj me të drejtë atë, flitet për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë zotit Hyseni!

HYDAJET HYSENI: ...obligimin që del nga Rezoluta e miratuar pikërisht për procesin e normalizimit që thotë se duhet të kihet parasys integriteti territorial i Kosovës dhe rendi kushtetues unik i tij. Në zgjidhjet që po dizajnohen, cenohet rendi unik kushtetues, krijohen precedente që e bëjnë të pamundshme funksionimin e tij.

Dhe, për të mos e zgatur, unë do të dëshiroja që diskutimi im të ishte mbështetje kryeministrit dhe unë e kuptoj që është mbështetje ekipit negociues. Ka presion për ta bërë që delegacioni i Kosovës të rrëshqasë në kompromise të palejueshme. Nuk e ndihmojmë duke e shtyrë tatëpjetë në rrëshqitje. E ndihmojmë duke u bërë barrikadë, ndoshta fre, për të mos lejuar rrëshqitjen në bosnjëzim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e zonjës Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Meqenëse në seancën e kaluar, ku kryeministri raportoi para vizitës së tij në Bruksel dhe takimit më 4 mars, ne i bëmë një sërë pyetjesh dhe së paku unë nuk mora përgjigjen për asnjërën prej tyre, atëherë unë e ndiej për obligim që t'i përsëris ato, sepse mendoj që përgjigjet në këto pyetje janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe në interes të

transparencës të këtij procesi. Unë e kuptoj shumë mirë që jo gjithçka në këtë proces mund të publikohet, megjithatë jam e bindur që përgjigja në këto pyetje nuk do ta dëmtojë pozitën e Republikës së Kosovës në raport me Serbinë.

Në radhë të parë, zoti kryeministër, shpresoj që mund ta sqaroni kur pritet përafërsisht të përfundojë dialogu? Po pyes për dy arsye: arsyeja e parë është për shkak se Serbia dhe në veçanti diplomacia serbe po abuzon me këtë proces, sidomos në shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, që janë gjeografikisht larg me Kosovën, duke thënë se Kosova dhe Serbia po bëjnë dialog për statusin e Kosovës. Me siguri, edhe ju jeni të informuar për një abuzim të tillë të procesit, dhe sa më shumë që Serbia thekson fakte të tilla të pavërteta në raport me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, aq më shumë dëmtohet procesi i njohjes i njohjeve të Kosovës, sepse këto shtete natyrisht, duke mos e ditur realitetin, mendojnë që çdo ndërhyrje e tyre nëpërmjet njohjes gjatë negociatave, nuk do të konsiderohej si akt i mirë, prandaj edhe e shtyjnë njohjen e tyre.

Arsyeja e dytë që mendoj se duhet të sqarohet se kur pritet të përfundojë dialogu, është fakti se e tërë energjia e institucioneve të Kosovës është fokusuar tash e një kohë pikërisht procesin e dialogut, në vend se të fokusohet në projekte të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve, prandaj është mirë të dihet se kur do të përfundojë ky proces.

Një pyetje që e kam shtruar edhe herën e kaluar dhe shpresoj që kryeministri kësaj radhe do të përgjigjet, sepse është për folur shumë nëpër media, asnjëherë pa ndonjë qartësim, ka të bëjë me strukturat të cilat pritet që të shpërbëhen. A mund, zoti kryeministër, t'i numëroni cilat struktura pritet të shpërbëhen dhe cilat struktura ju si Qeveri e Kosovës keni pranuar t'i legalizoni. Pra, të numërohen një nga një.

Sa i përket asociacionit të komunave, këtu sot u përmend disa herë asociacioni i komunave serbe, në njërën anë, dhe ai i komunave shqiptare, në anën tjetër. Sa mendoni se do t'i ndihmojë integritet të etnive të ndryshme në Kosovë krijimi i trupave monoetnike. Ju, siç e dini, në Këshillin e Evropës ekzistojnë trupat e veçanta që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale, ku asociacioni i komunave të Kosovës është i anëtarësuar që një kohë të gjatë dhe një prej kushteve kryesore për të qenë i anëtarësuar në ato organe është multietniciteti. Pra, nuk mendoni që pjesëmarrja e Kosovës në këto organe ndërkombëtare po rrezikohet duke krijuar trupa monoetnike, përderisa është kusht multietniciteti për të marrë pjesë në to. Dhe, siç e theksuam edhe herën e kaluar, në qoftë se vërtet ajo zgjidhje, për të cilën ju po diskutoni, tashmë ekziston në Kushtetutën e Kosovës dhe nuk do të shkohet përtej saj, atëherë pse po negociohet për zgjidhje që tashmë ekzistojnë.

Çështja tjetër ka të bëjë me zgjedhjet në veri. Ju e keni përmendur disa herë që pritet që ato t'i organizojë OSBE-ja. Prandaj, po e përsëris pyetjen nga raportimi i kaluar: A do të bëhet delegimi i kompetencave në OSBE, si një organizatë ndërkombëtare, në përputhje me nenin 20 të Kushtetutës, ku parashihet që çdo delegim i kompetencave nga institucionet e Kosovës në organizata ndërkombëtare bëhet nëpërmjet ratifikimit të Kuvendin e Kosovës, njëjtë siç e kemi bërë edhe te mandati i EULEX-it, duke i dhënë kompetenca ekzekutive në fushën e Gjyqësorit.

Dhe, së fundi, zoti kryeministër, kam pyetur edhe herën e kaluar për të drejtat e shqiptarëve në veri. Ju po flisni mjaft për të drejtat dhe garancitë për serbët, por në asnjë moment nuk i keni përmendur shqiptarët në veri. A është diskutuar ndonjë aranzhim i veçantë për të drejtat e shqiptarëve? Siç e dini, në atë pjesë të Kosovës kanë jetuar dhjetëra-mijëra familje. Si do të rregullohet kthimi i tyre në banesat dhe shtëpitë e tyre të uzurpuara nga serbët? Si do të jetë përfaqësimi i tyre në institucionet publike në komunat e veriut? Dhe, siç e dini, po e përsëris edhe një herë që Lidhja Demokratike e Kosovës, në përputhje me pikën 6 të Rezolutës dhe në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, do të vazhdojë të insistojë për ratifikimin e këtyre marrëveshjeve në Kuvend. Shpresoj që kësaj radhe të sqaroni, siç u pyetët më herët edhe nga deputetët e tjerë, se a do të ndodhin këto ratifikime një nga një të marrëveshjeve, apo do ta kemi vetëm një ratifikim në përfundim të procesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Në fakt, njëra ndër produktet e këqija të bisedimeve me Serbinë, të tjera produkte po vazhdojnë të duken sfond dhe njëra ndër ato janë edhe, përveç shpërbërjes së institucioneve të sigurisë dhe institucioneve paralele, që herë quhen institucione paralele, herë institucione ilegale, herë institucione kriminale, herë institucione të Republikës së Serbisë në Kosovë, nuk ka rëndësi se si quhen, duket në sfond që do të ndodhë edhe një lloj legalizimi i këtyre institucioneve dhe po ashtu duket në sfond edhe një lloj amnistie që u përgatitet këtyre institucioneve, respektivisht njerëzve anëtarë të këtyre institucioneve atje.

Legalizimi i strukturave ilegale kriminale të Serbisë në Kosovë dhe përgatitja e terrenit apo opinionit për amnistinë e serbëve të përfshirë në këto struktura ilegale, kriminelët serbë, mendoj që nuk janë tashmë thjesht gjëra të ndaluara për palët bashkëbiseduese, por edhe të diskutuara. Sidoqoftë, kur flasim për amnistinë e institucioneve apo personaliteteve atje, respektivisht kriminelëve, ne do të duhej ta kuptojmë një rrjedhë logjike se amnistia nuk mund të ndodhë para se të ketë gjykim, pra personat të cilët mund të amnistoheshin, të përfshirë në krim, paraprakisht duhet të ishin të arrestuar, të gjykuar, të dënuar dhe amnistia zakonisht parasheh zbutjen apo faljen e atij dënimi. Të tjerat nuk kanë ndodhur, nuk janë arrestuar, nuk janë gjykuar, rrjedhimisht nuk janë dënuar dhe amnistia paraprakisht mendoj se është heqje dorë nga drejtësia. Pra, amnistia paraprakisht është heqje dorë, ashtu siç është hequr dorë de facto edhe nga sovraniteti në pjesët e caktuara të Kosovës, respektivisht në veri.

Por, edhe sikur të ndodhte amnistia për krime dhe kriminelët atje dhe të përfundonin këtu krimi dhe kriminelët, do të ishte e keqja më e vogël. Por, mendojmë që amnistia për krime dhe kriminelët atje është një lloj legalizimi i krimit dhe një infuzion i ri që krimi legal tashmë të vazhdojë në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Pra, edhe sikur të ndodhte amnistia, do të ishte e keqja më e vogël para asaj që mund të ndodhë pas amnistisë.

Njëkohësisht, ashtu siç thashë më herët, amnistia është heqje dorë paraprakisht nga drejtësia, njëkohësisht është edhe heqje dorë nga ushtrimi dhe shtrirja e ligjit dhe sundimit të ligjit në veri. Kosova vërtet ka shumë probleme dhe këto probleme mund t'i zgjidhë dhe duhet t'i zgjidhë, por në këtë rast Qeveria e Kosovës ka zgjedhur gabimisht që këto probleme në veri t'i zgjidhë me Serbinë, në vend që këto probleme t'i zgjidhte me shqiptarët e vet atje. Dhe, nëse qytetarët e Kosovës në veri identifikohen apo shihen një me Serbinë, atëherë ky është gabim i radhës. Pra, nuk do të duhej t'i shihnin njëjtë serbët e Kosovës me Serbinë dhe rrjedhimisht nuk do të duhej të bisedohej me Serbinë për serbët, respektivisht për qytetarët e Kosovës.

Në anën tjetër, në vend që të tentohet të vihet nën kontrollin e ligjit pjesa veriore, po bëhet e kundërta. Po tentohet të mbahet nën kontroll pjesa tjetër e qytetarëve të Kosovës dhe po tentohet të mbahen nën kontroll ata qytetarë të Kosovës, të cilët do të pësojnë nga koncesionet dhe marrëveshjet e radhës me Serbinë. Pra, nëse flasim në baza etnike, në vend që të vihen nën kontrollin e ligjit serbët, po mbahen shqiptarët nën kontroll që të mos reagojnë kur ata dëmtohen nga këto bisedime. Por, sidoqoftë, nëse do të ndodhte legalizimi, shpërbërja apo edhe amnistia, ne do të duhej paraprakisht ta dinim, përveç në shpërbërje, a përfshihen në procesin e legalizimit edhe strukturat e njohura tashmë dhe të pranuar nga Qeveria e Kosovës që veprojnë në veri, siç janë: MUP-i, BIA, Mbrojtja Civile apo edhe institucionet e tjera.

Pra, a do të kemi shpërbërje të tyre, apo do të kemi transformim të tyre në institucionet e Kosovës, përkatësisht në Policinë e Kosovës - AKI, FSK e të tjera? Ne do të duhej të kishim përgjigje se kë mendojnë ta legalizojnë, kë mendojnë ta shpërbëjnë dhe kë mendojnë ta amnistojnë palët ndërbeseduese. Nëse nuk do të ndodhin këto, atëherë është mirë që të na thuhet se çka do të ndodhë paraprakisht atje. Do të duhej ta dëgjoni fjalën "kurrë" dhe kjo fjalë të mbahej. Pra, do të duhej ta dëgjoni edhe një herë fjalën e vendosur "kurrë" dhe kjo fjalë së paku një herë të mbahet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Sa u përket bisedimeve, e dimë që LDK-ja i ka përkrahur këto bisedime, por me kusht që ato ta kenë kontrollin prej Kuvendit dhe ajo që ishte pozitive, ishte lëvizja prej status quo-s, e cila e bllokonte Kosovën në lëvizje përpara, por në Rezolutën që doli prej Kuvendit, kërkohej raportimi i kryeministrit sipas kësaj rezolute. Edhe në këtë raport sot e shohim që kryeministri nuk solli asgjë me shkrim, por vetëm deklaram gojor, mungesa e ndonjë dokumenti me shkrim për t'u konstatuar edhe prej shumë deputetëve tjerë.

Sot i patëm mundësitë që të dëgjojmë më tepër detaje për asociacionin, për mënyrën e pjesëmarrjes në Fondin zhvillimor, për bashkim me asociacionet tjera dhe gjërat tjera, të cilat kryeministri i tha. Herën e kaluar, gjatë raportimit të kaluar, e pata pyetur kryeministrin që, në qoftë se ky asociacion është i paraparë me dokumentin e Ahtisarit dhe me Kushtetutën tonë, pse duhet të bisedohet për këtë asociacion, nëse është i garantuar me të gjitha dokumentet, me të gjitha ligjet dhe me Kushtetutën e Kosovës. Pres që kryeministri kësaj here të përgjigjet në këtë.

Në anën tjetër, mendoj që u dëgjua edhe prej deputetëve serbë që komunat në të cilat jetojnë 2/3 e komunitetit serb, si shembull u përmendën edhe Graçanica, Shtërpca dhe Parteshi. Shtërpca dhe Parteshi janë të vërtetë një tregim i suksesit, komuna në të cilin kanë kryetarë komunash, ku udhëheqja është e shumicës serbe dhe ku taksat dhe pagesat e rrymës, siç dëgjuam, janë në rritje dhe në nivel të lartë. Këto kanë edhe ndërlidhje me udhëheqjen qendrore. Atëherë, do të duhej që të kihet parasysh që, në qoftë se ekziston një shembull i mirë në pjesën më të madhe të Kosovës, a duhet që të zbulohet një shembull tjetër në pjesën tjetër, e cila mund ta dëmtojë pikërisht komunitetin serb, i cili është i integruar dhe i cili është i gatshëm që të marrë pjesë në jetën tonë.

Prandaj, kisha pasur dëshirë ta pyes kryeministrin sesi është paramenduar implementimi i gjithë kësaj, a ekziston mundësia e implementimit dhe a rrezikohet funksionaliteti i shtetit, sepse na kujtohet që gjatë punës për përpilimin e dokumentit të Ahtisarit dhe përgatitjeve për pavarësinë e Kosovës, në fakt është bërë një kompromis si madh dhe atëherë kemi menduar që me këtë dokument në fakt ne po e kryejmë punën e konfliktit me Serbinë.

Por, e kemi vërejtur që ajo punë mbeti e pakryer dhe me kalimin e kohës, kjo punë e pakryer e betanoi Kosovën në një status quo, prandaj presim që në këto bisedime të shfrytëzohen të gjitha mundësitë që të dalim prej asaj status quo dhe të ecim duke pasur gjithmonë parasysh funksionalitetin e shtetit dhe çështjet të cilat kanë mbetur të pazgjidhura. Këtu dëshiroj të cek edhe çështjen e pensioneve, e cila u diskutua dy javë përpara dhe së cilës tashmë veç i ofrohet koha e kërkimit të përgjigjes për komisionin, të cilin e kërkoi Kuvendi. Në fakt, konflikti me Serbinë ende është ekzistent dhe mbetet i hapur, përkundër të gjithë asaj çka dëgjuam prej bisedimeve deri më tani dhe kur të përfundojnë këto bisedime, duhet ta mbyllim këtë konflikt dhe të kërkojmë obligimin e njohjes së Kosovës, ose së paku të mospengimit të Kosovës për pjesëmarrje në organizmat tjerë ndërkombëtarë. Përndryshe, mosmbyllja e këtij konflikti me Republikën e Serbisë dhe normalizimi i marrëdhënieve do të na çojë nesër në negociata të ardhshme, në një kohë tjetër dhe në koncesione tjera për Kosovën.

Prandaj, për shumë pyetje të cilat u bënë, edhe në këto pyetjet tjera që i parashtrava, pres që kryeministri të na jap përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ne si deputetë të Lëvizjes për Bashkim sot votuam kundër dhënies së mundësisë kryeministrit për të raportuar dhe atë jo vetëm për arsye procedurale, dhe atë jo vetëm për sot. Ne konsiderojmë që kryeministri më nuk ka fare nevojë të raportojë në Kuvend. Në radhë të parë, për faktin që nuk po informohemi për diçka të re. Kaq njoftohemi edhe prej medie dhe, e dyta, konsiderojmë që nuk ka kredibilitet për ta bërë në gjë të tillë, e këtë kredibilitet kryeministri ia ka mohuar vetes me pozicionet që ka vendosur t'i zgjedhë në këto negociata. Fatkeqësisht, kryeministri ka zgjedhur që të mos jetë negociator në këto negociata. Ai ka vendosur që ta ketë rolin e një vëzhguesi pasiv dhe të një garantuesi për

implementimin e marrëveshjeve që bëhen ndërmjet dy palëve, që në fakt janë negociata ndërmjet njëra-tjetrës, e këto janë Serbia dhe Bashkimi Evropian.

Për një gjë të tillë ka pasur shenja që në fillim dhe në momentin kur Kosova ka vendosur të shkojë në këto bisedime vetëm me një rezolutë dhe pa platformë, është parë se nuk ka ambicie dhe synime për të arritur diçka. Përderisa Rezoluta është një dokument, i cili vetëm thërret për t'u ruajtur disa cilësi që i ka Kosova si shtet, platforma do të duhej të ishte ajo e cila do ta kompensonte këtë mungesë të rezolutës, pra t'i parashihte objektivat e synimet që duhet t'i arrijë Kosova në këto bisedime. Dhe, fakti që nuk është pranuar një platformë e tillë, tregon se nuk ka pasur synime të tilla dhe kur nuk ka synime, atëherë përfundimi dhe rezultati i negociatave dihet se çfarë është. Ai gjithsesi do të jetë i dobishëm për Serbinë, sepse asaj do t'i hapet rruga drejt BE-së. Do të jetë një lajm i mirë për Bashkimin Evropian, sepse do ta marrë Serbinë në BE dhe do të jetë një lajm i keq për ne, sepse do të konservohen problemet me të cilat ne do të përballemi në të ardhmen.

Ne këto bisedime gjithmonë i kemi konsideruar si një mundësi të madhe për ta arritur një rezultat, për t'i shtruar disa probleme me të cilat ballafaqohemi vërtet si Kosovë dhe si Serbi, mirëpo kjo nuk ka ndodhur dhe kjo që ka ndodhur fatkeqësisht është diçka shumë e dhimbshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Unë e mora fjalën, jo pse kemi diçka të re për të thënë nga ajo që e thamë para një jave, që ia thamë kryeministrit, mirëpo për t'i konfirmuar edhe një herë angazhimet tona dhe deklaratimet tona dhe në të njëjtën kohë për ta shprehur shqetësimin lidhur me transparencën dhe mënyrën e komunikimit që po bëhet këtu.

U tha shumë se ka mungesë të transparencës dhe dhënies së informacionit të saktë. Unë po e ilustruj këtë me një shembull. Në qoftë se i dëgjojmë deklaratat e kryeministrit të Kosovës këtu, deklaratat e kryeministrit të Serbisë ose të presidentit të Serbisë nëpërmjet medieve dhe deklaratat e zonjës Eshton, ato janë komplet të ndryshme. Të krijohet përshtypja se këta tre nuk kanë marrë pjesë në të njëjtin takim. Apo janë marrë vesh që "ne merremi vesh për gjëra këtu dhe gjithsecili e jep variantin e vet kur të dalë jashtë". Edhe kjo mund të jetë një arsye se pse po ndodh kjo.

Ajo çka dua t'i them kryeministrit dhe t'i kërkoj edhe një herë është që të mos lejojë të bëhet organizim mbikomunal me kompetenca ekzekutive. Të parandalohet mundësia e dhënies së kompetencave në sistemin e gjyqësisë në nivelin mbikomunal. Të parandalohet mundësia e dhënies së kompetencave në nivelin mbikomunal për Prokurorinë. Të parandalohet mundësia e dhënies së kompetencave në nivelin mbikomunal për sistemin e sigurisë dhe për Policinë.

Fatkeqësisht, janë dhënë kompetenca sa u përket taksave dhe tatimeve me themelimin e Fondit për veriun. Fatkeqësisht, janë dhënë kompetenca sa i përket sistemit të shëndetësisë sekondare në Pakon Ahtisari. Fatkeqësisht, janë dhënë kompetenca në arsim, po ashtu me Pakon e Ahtisarit.

Nëse kësaj i shtohen kompetencat nga gjykata, Prokuroria, Policia, taksat, Shëndetësia dhe Arsimi, herën e kaluar ju thashë se do të jetë shumë e lehtë që të vendoset një emër, o Republika Sërpska, o organizim mbikomunal me bazë monoetnike në pjesë të caktuara të territorit të vendit, i cili do të ketë predispozita separatiste në të ardhmen e afërt. Më e lehta që do të mund të quhej ishte devoluim i shtetit të Kosovës ende pa u formuar shteti, por fatkeqësisht unë po ia konfirmoj sot kryeministrit të Kosovës se nëse vazhdohet me këtë proces të dhënies së kompetencave në nivelin mbikomunal do të kemi devoluim të shtetit të Kosovës dhe do të kemi organizim mbikomunal, i cili e rrezikon qëndrueshmërinë institucionale të Kosovës.

Unë, edhe një herë po e përsëris dhe po kërkoj që të mos lejojë, sepse në këtë rast kryeministri i Kosovës i përfaqëson institucionet e Kosovës në këto diskutime, të mos lejojë që të ketë organizim mbikomunal. Unë dëshiroj ta kem vullnetin pozitiv që t'u besoj deklaratave të kryeministrit se nuk do të ketë, mirëpo duke e parë gjendjen e tij të sotme emocionale dhe shpirtërore, është shumë e ndryshme nga ajo e para tri ditëve, kur e pati vullnetin që të deklarojë para Kuvendit, dhe sot po duket shumë më i mërzhitur dhe shumë më pesimist. Dhe, uroj që ta ketë optimizmin dhe guximin që t'i mbrojë interesat e Kosovës dhe në të njëjtën kohë kur të përmbillet procesi, Kosova të mos dalë e lënduar, ashtu siç po pritet të dalë.

Ne nuk do të jemi të kënaqur që Kosova të dalë e lënduar dhe të ndodhë devoluimi i shtetit të Kosovës. Ne do të angazhohemi që kjo të mos ndodhë dhe që të mos ndodhë kjo po e paralajmërojmë që të mos lëshohet pe te gjykatat, Prokuroria, Policia, taksat, Shëndetësia dhe Arsimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kur zhvillohej procesi i privatizimit të Rrjetit dhe Distribucionit, disa herë në disa instanca, edhe gojarisht, por edhe me shkrim ia kërkoja ministrit të Zhvillimit Ekonomik pesë dokumentet bazë të tij, dhe përgjigjja zyrtare e tij përherë ka qenë, edhe me shkrim, që këto janë draft, prandaj nuk mund t'i shpërndajnë te deputetët.

Pra, kujtoj që e njëjta logjikë tash është edhe në këtë proces të negociatave për shkak se në secilën kërkesë të deputetëve, që të kemi diçka me shkrim, të paktën këto që po i lexon kryeministri Thaçi në Kuvend, ato asnjëherë nuk po dorëzohen. Pra, po supozoj - janë draft. E ne e dimë çka është drafti. Drafti nuk është versioni përfundimtar. Pra, drafti ndryshohet, prandaj edhe quhet draft. Po të kishte qenë i pandryshueshëm, nuk do të kishte qenë draft, do të ishte versioni final, apo jo.

Pra, mendoj që kryeministri po refuzon t'i dorëzojë këto me shkrim për shkak se edhe ky e di që ato do të ndryshojnë. Por, ama ky nuk e di se si do të ndryshojnë ato. Për shkak se këtu pajtohem plotësisht me deputetin Kuleta, kryeministri i Kosovës atje nuk shkon si negociator, pra nuk është si përfaqësues i Kosovës. Është një lloj lehtësuesi i zbatimit të marrëveshjeve, për shkak se edhe në raportimin e tij këtu e kemi vërejtur për çdo herë që

asnjëherë nuk ka folur për atë se çka kërkoi ky në negociata. Përherë na ka folur se si është mbrojtur nga kërkesat e Serbisë. Pra, është mbrojtur duke thënë që kjo nuk zbatohet, këtë nuk ma pranojnë, e këtë disi e shes. Pra, ky është atje për të treguar çka mund të zbatohet në Kosovë, e jo çka do Kosova prej këtij procesi të dialogut. Se, natyrisht kur ta pranosh një proces të dialogut, të negociatave, nga një pozitë e pabarabartë me negocuesin, pra kur ti nuk konsiderohesh si shtet, e ai konsiderohet si shtet, kur ti pa kurrfarë kushti shkon në negociata sa herë të thërrasin, natyrisht se e ke pranuar pozitën e jonegociatorit, pra pozitën e facilitatorit.

Dhe, a nuk ishte indikative e kësaj që po e them, në fjalën hyrëse të kryeministrit këtu, kur një pjesë e konsiderueshme të fjalës e shpenzoi duke na treguar se si do të vijë Ketrin Eshton në Prishtinë që të na tregojë se çfarë ka ndodhur me dialogun. Për shkak se ky nuk mund ta tregojë, se ky nuk e di. Ajo do të na tregojë neve se çfarë janë marrë vesh me Serbinë, për shkak se BE-a është marrë vesh me Serbinë për Kosovën dhe nuk i kanë treguar këtij, siç po duket, krejt çka janë marrë vesh me Serbinë. Dhe, tash ky pret që ajo të vijë këtu dhe të na shpjegojë të gjithëve se çfarë ndodhi në këtë proces dialogu.

Pra, unë nuk po e di pse po shkon në Bruksel. Se për ashtu, ka mundur Eshton të vijë më shpesh dhe të raportojë ajo, e jo ti.

Një çështje tjetër që dua ta ngre, që u ngrit edhe nga disa deputetë: u tha që marrëveshja duhet të ketë kritere të larta juridike dhe të jetë ndërkombëtare, të ketë karakter ndërkombëtar, sikur çdo marrëveshje për Kosovën në të ardhmen. Po dobitë që i kanë sjellë këto marrëveshje ndërkombëtare për Kosovën, unë nuk po i di, nuk po i shoh, për shkak se procesi nuk po përfundon asnjëherë dhe ky proces nuk do të përfundojë. Pra, kjo siguri e disa deputetëve dhe e kryeministrit se nuk do të ketë republikë serbe, se nuk do të ketë këtë dhe atë, nuk po di ku po e marrin, për shkak se procesi është duke u evoluar. Pra, deri tash disi është ngjizur forma e kësaj republike, e deri diku edhe përmbajtja e saj. Po ne e dimë që procesi nuk ka përfunduar ende dhe ne e dimë që edhe kur të përfundojë ky proces, do të vijë ai tjetri, i cili do ta mbushë me më shumë përmbajtje këtë formë tashmë që po e ngjizin në Bruksel.

Po flasim nga përvoja, jo që unë mund t'i parashikoj këto gjëra. Po përvoja e deritashme e negociatave me Serbinë ka prodhuar gjëra të tilla. Një herë ka prodhuar formë, pastaj ka prodhuar përmbajtje për formën, e pastaj kur është mbushur me përmbajtje forma, meqenëse është mbushur me më shumë përmbajtje se sa forma, ka qenë e nevojshme të ndryshohet edhe forma, që ta zërë përmbajtjen shtesë, e cila pastaj ka kërkuar përmbajtje më shumë për shkak se i ka pasur disa përmbajtje mangut. Dhe, kështu shkon ky proces i dialogut, i vazhdueshëm me Serbinë, i cili çdo herë edhe më shumë po e dëmton dhe po e copëton Kosovën për së brendshmi.

Pra, ku është siguria se nuk do të ketë republikë serbe në Kosovë? A do të lëshojë Serbia pe?! A kemi ndonjë indikacion se Serbia ka vendosur të lëshojë pe në këtë drejtim? A ka ndonjë trysni ndaj Serbisë që të lëshojë pe në këtë drejtim, për shkak se ne e dimë që edhe BE-ja, edhe shtetet anëtare të BE-së po i thonë Serbisë që nuk presin njohje të Kosovës nga ajo në fund të procesit. Madje-madje e dimë që edhe kryeministri i Kosovës e ka

thënë këtë edhe publikisht, një herë pas një takimi me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe dhe herën tjetër në një komunikatë për shtyp që e kishte lëshuar para takimit të janarit, në Bruksel, kur thotë shprehimisht që ne nuk presim njohje nga Serbia në këtë proces.

E pra, për sa kohë që nuk na njih Serbia, edhe sa kohë që ne kemi Qeveri që thotë nuk mund ta kushtëzojmë Serbinë, për çdo herë do të kemi proces të dialogut, ose më mirë të them proces të koncesioneve të reja të Kosovës ndaj Serbisë.

Por, po kthehem te këto disa prej kompetencave që i përmendi tashmë kryeministri Thaçi për asociacionin e komunave, për shkak se ne duhet ta kemi parasysh se ky asociacion, u tha edhe këtu, meqenëse është asociacion i komunave serbe të Kosovës, është paralelizëm institucional, pra krijon paralelizëm ndërmjet institucioneve të Kosovës, pavarësisht a do të jetë ajo siç e quajti më herët kryeministri OJQ, apo jo. Për vetë faktin se është OJQ, apo asociacion i komunave serbe, e jo i gjithë Kosovës, ky është paralelizëm, e pastaj kompetencat shtesë vetëm sa do të shkojnë e ta rëndojnë këtë paralelizëm institucional që paraqet ky asociacion.

Pra, u tha që asociacioni do ta ketë ose mund, siç e tha kryeministri, ta dërgojë anëtarin e vet në Bordin e Fondit për veriun. Ne e dimë më herët që është thënë, domethënë para kësaj që është thënë, e jo që kemi parë ndonjë gjë të shkruar, që ky bord do të jetë i përbërë nga 3 anëtarë. Pra, njëri prej anëtarëve do të jetë përfaqësues i komunitetit, e në këtë rast pra del që do të jetë përfaqësues i komunitetit, e në këtë rast del që do të jetë përfaqësues i asociacionit, anëtari tjetër do të jetë përfaqësues i Qeverisë së Kosovës dhe i treti, kryesori, do të jetë përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian, apo i deleguari i tij në këtë bord, i cili në rast të mospajtimit do ta ketë fjalën përfundimtare, pra votën përfundimtare. Pra, e kemi një bord ku një përfaqësues i Qeverisë së Kosovës i qëndron përballë paralel atij të asociacionit të komunave.

Po ma tregoni ju mua një mekanizëm në Kosovë, kur një përfaqësues i OJQ-ës është i barabartë me një përfaqësues të Qeverisë së Kosovës. Nuk ka të tillë, për shkak se kjo nuk është OJQ dhe OJQ-të nuk e kanë këtë status kaq të lartë. Pra, do të kemi paralelizëm të Qeverisë së Kosovës në bordin, apo në bordin i cili e menaxhon Fondin për veriun, i cili praktikisht do të jetë buxheti për këtë asociacionin e komunave.

Çështja tjetër? U tha që do ta ketë të drejtën e ngritjes së fondeve. Pra, fondeve të BE-së, donatorëve tjerë, e kështu me radhë, për projekte infrastrukturore e të tjera që asociacioni i sheh si të nevojshme. Asociacioni do ta ketë këtë të drejtë. Pra, po lëvizim nga komunat te asociacioni, i cili do të koordinojë po ashtu projekte infrastrukturore, por jo për komunat e veçanta, po për asociacionin e komunave dhe territoreve që mbulon.

Unë nuk e di se çfarë forme duhet të ketë autonomia që të quhet e tillë, për shkak se kjo është autonomi. Është një fazë drejt autonomisë, apo jo? Është një hap goxha cilësor drejt autonomisë.

Me planin e Ahtisarit, Kosova e ka pranuar decentralizimin etnik dhe tash me negociatat në Bruksel kemi lëvizjen në anën tjetër, kah centralizimi etnik. Pra, ato komuna të decentralizuara me shumicë serbe tash po lidhen bashkë në një asociacion komunash, pra po centralizohen, por jo në pushtetin qendror të Kosovës, por në një pushtet anësor paralel, i cili do t'i bëjë paralele edhe institucionet tjera të Kosovës.

Pra, ky është rezultati i tanipërtanishëm i këtij dialogu, e natyrisht që rezultate të reja do të presim edhe në ditët, në javët në vazhdim, por natyrisht për sa kohë që Hashim Thaçi është kryeministër, edhe në muajt e vitet në vazhdim, për shkak se e kam thënë edhe në seancën e kaluar dhe qëndroj prapa kësaj - ky është kryeministër i negociatave. Tjetër gjë nuk është ky.

Pra, në momentin kur të përfundojnë negociatat, ky s'mund të jetë kryeministër. Prandaj, është e natyrshme që ky të insistojë të ketë sa më shumë dhe sa më gjatë negociata, për shkak se ky do të jetë sa më shumë dhe sa më gjatë në pushtet.

Për fund, vetëm një gjë kisha dashur ta them, ose ta formuloj si pyetje për kryeministrin Thaçi: A mund të na tregoni publikisht këtu në Kuvend se cilën pikë të platformës serbe e keni ndërmend ta refuzoni, pra të mos e pranoni? Për shkak se po pranoni secilën. A mund të na e tregoni tani një, ta gjeni një dhe të thoni këtë nuk do ta pranoj, që ta dimë edhe ne deputetët, të paktën në atë pikë, të çlirohemi pak dhe të themi se këtë Hashim Thaçi nuk do ta pranojë në asnjë negociatë. Pra, një pikë, cilado qoftë ajo, se është çështje juaja se cilin nuk do ta pranoni. Por, vetëm një na e tregoni, cila është ajo pikë, se platformën tashmë e keni pranuar në tërësinë e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Në qoftë se më lejoni ta përshëndes kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat, Do të ju falënderoja edhe unë ju.

Thënë të drejtën, kur unë kam qenë më i ri dhe axhami, do të thotë kryetar atje në Prizren, ka një kohë, e kam pasur zakon ta përdor një shprehje që thoshte, e citoj veten si Mao Ce Duni që bënte nganjëherë: "Mazhoranca duket kërcënuese edhe kur nuk është kërcënuese". Kështu thosha atëherë. Edhe këtë në raport me minoritetet, e thosha. Kështu që, në këtë aspekt, vullneti i mirë i Kosovës për ta ndierë veten komod minoritetet është një plus jashtëzakonisht i madh në trajtimin e tjerëve për Kosovë. Nuk po e shpik këtë gjë tani, po e citova veten, atëherë moti kur kam qenë i ri.

Në këtë aspekt, nuk do të duhej të kemi kurrfarë kompleksi. Madje, unë kisha sugjeruar, ndoshta kam perceptime të gabueshme, që Parlamenti ynë të mos e mbajë veten si i gjithëpushtetshëm në këtë proces. Nuk bën ashtu! Në qoftë se ne ia bëjmë gjyqin këtij procesi, kam frikë, jo që s'mund t'ia bëjmë, por edhe do të dukemi jofunksionalë dhe anakronikë në raport me këtë proces.

Me të vërtetë, ne jemi njëri nga faktorët, në daç quajeni edhe faktori më i bukur dhe më i mençur, mirëpo vetëm njëri nga faktorët. Kështu që në këtë aspekt, procesi do të dilte

shumë më i suksesshëm, në qoftë se të gjithë do ta jepnim kontributin shumë të sinqertë, bashkë me kryeministrin, por edhe me zonjën Jahjaga. Pse jo? Pra, të bashkohemi.

Nuk e shoh unë si kontribut për procesin në qoftë se bëjmë opozitën për inat të kryeministrit, ose të dikujt tjetër. Të paktën kështu i shoh unë këto procese. Sepse jehona e këtyre marrëveshjeve do të vazhdojë edhe kur të mos jetë më gjallë kryeministri, as unë, as kurrkush hiq, e lëre më ai. Në këtë aspekt, pra as ky Parlament, a? Në këtë aspekt, unë kështu do ta perceptoja.

Tash, thënë të drejtën, t'i kthehem edhe një herë zemërgjerësisë dhe vullnetit të mirë të mazhorancës shqiptare në Kosovë, se është edhe në Kushtetutë kjo punë, nuk po shpif gjë, që pakicat ta ndiejnë veten komod. Kjo është krejt OK. Ato shqetësime që dolën këtu nga oratorët, të cilët i respektoj, deri ku shkon ky komoditet? A ka kufij? Po, unë kisha për t'i caktuar pak a shumë ata kufij. Në qoftë se komoditeti i një grupi, në këtë rast edhe etnik, përkon me fatkeqësinë dhe që ia nxin jetën shumicës, atëherë kjo nuk shkon, a po? Këtu, për fat të keq, nuk është se ne po duam të themi 's'bën'. Po, sepse nuk fle puna. A shkon një mandat, dy a tre, përsëri do të bëhet telashe shumë e madhe, sepse bazat janë shumë të dyshimta. Bazat kur dikush e imagjiron dhe projekton komoditetin në fatkeqësinë, nuk po them të mazhorancës, por edhe atij tjetrit. Në këtë aspekt unë besoj se kjo do të duhej të ishte qasja. Dhe, çka nënkuptojmë, madje edhe unë, që pak marr vesh, me cenimin e fatkeqësisë, me kënaqësinë që e gjejmë në fatkeqësinë e shumicës në këtë rast, në qoftë se e bëjmë jofunksional sistemin. Në qoftë se nuk funksionon sistemi, atëherë jeta jonë këtu bëhet 'karaboj'. Këtu pra do të duhej të ishte ai kufiri i prerë.

Një kufi tjetër, po i njëjti pothuaj, por me një gjuhë tjetër ndoshta nga parimet etike më shumë se sa politike dhe kushtetuese, e tjera, e tjera, më lejoni që ta them këtu para jush, duke qenë se ju respektoj të gjithëve dhe po kam dëshirë t'i ndaj sekretet e mia ideore bashkë me ju. Tani ju po e shihni, madje edhe unë po e marr vesh se cila është strategjia e bashkësisë ndërkombëtare. Ajo është që të dyja palët të mbeten të pakënaqura. Ju nuk di a keni vërejtur - vajton Beligradi, vajton Prishtina! Dhe, me të vërtetë e tillë është strategjia e bashkësisë ndërkombëtare.

Domethënë, në qoftë se mbeten të dyja palët të pakënaqura, atëherë ata i fërkojnë duart dhe thonë 'urra, bëmë diçka'.

Por, unë do të pyesja, ku e ka kufirin kjo pakënaqësi? Nuk do të duhej që të poshtërohej viktima. Ky është ai sekreti që desha ta them.

Nuk varet kjo, a po pajtohet sot kryeministri Thaçi, a po pajtohet Parlamenti i gjithëpushtetshëm i Kosovës, a po pajtohen të gjitha partitë edhe shqiptarët sot, sepse kjo prodhon efekte jashtëzakonisht të rrezikshme në të ardhmen.

Pra, të njëjtën vijë të kuqe, unë po e formuloj tash këtë në aspektin etik, dhe në qoftë se më lejon zotëri kryesues ta shpërdoroj pak mikrofonin dhe t'i kërkoj falje Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës se më doli një formulim i raportit të kryeministrit Thaçi dhe zotit

Haradinaj në një gazetë, që nuk është formulimi im. Edhe pse nuk është imi, po kërkoj falje. Unë me të vërtetë flas qyfyre, por me një gjuhë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur nga deputetët. Fjalën e ka kërkuar nënkryetari dhe zëvendëskryeministri i Qeverisë, zoti Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Me siguri se pas fjalës së profesor Kryeziut është pak telashe ta mbaj atë nivelin e diskutimit. Kjo përparësi është e të qenët gjuhëtar. Por, ajo që dua të them është për një temë që u përmend këtu nga zoti Selimi dhe më erdhi mirë që u kthye, se nuk desha më herët të flas, që ka të bëjë me amnistinë, që po përmendet edhe në kontekst, edhe me dialogun, por edhe me mediet e ndryshme.

Më lejoni ta jap një informatë të shkurtër mbi sfondin e kësaj ideje dhe sfondi i kësaj ideje fillon në prill të vitit 2011, kur në atë kohë ia pata dërguar një letër Presidentes së Republikës, kryetarit të Kuvendit dhe profesor Bajramit, si kryetar i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës dhe pata kërkuar që në Kushtetutë të hyjë edhe çështja e amnistisë.

Po ashtu, më lejoni ta përmend një sfond që në kohën kur e hartuam Kushtetutën e Republikës së Kosovës patëm kërkuar që të kemi amnisti, por nuk na patën lejuar. Dhe tani përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë na e dha një të drejtë të tillë. Por, më lejoni t'i përmend edhe disa fakte konkrete që lidhen me këtë.

E para, besoj që shumë pozitive, ka qenë propozimi im si ministër i Drejtësisë që amnistia të jepet me ligj dhe atë me miratim prej 2/3 të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dhe, dijeni se shumica e vendeve në botë e kanë me 51%, por unë po them me 2/3 për hir të rrethanave specifike që i ka Kosova.

Më lejoni po ashtu të them që Kuvendi duhet të gëzohet se i shtohet një kompetencë më shumë. Kompetenca 24 do të jetë që Kuvendi i Republikës së Kosovës i jep amnisti të përcaktuara me ligj.

Një çështje tjetër, që po ashtu dua të them, amnistia duhet të jepet pastaj nëpërmjet procedurave gjyqësore. Ne i përcaktojmë veprat në këtë Kuvend dhe procedura gjyqësore pastaj do ta marrë vendimin e tillë.

Pse unë e kam marrë këtë iniciativë? Mendoj se Kosova duhet t'i ketë kompetencat që i kanë të gjitha shtetet tjera. Unë kam parë raste të ndryshme që amnistia kryesisht lidhet me vendet e pasluftës ose pas konfliktit, por edhe amnistia që bëhet në rutinë.

Ju e dini që ne në Kosovë e kemi faljen. Duhet ta pranoj një fakt publikisht. Në qendrat korrektuese të Republikës së Kosovës sot janë 1 846 veta. Kërkesën për falje e kanë bërë 441 veta, ndërkaq kanë përfituar vetëm 4 veta. Për mua, si ministër i Drejtësisë, nuk është

e pranueshme që vetëm 4 veta të fitojnë falje brenda një viti, nga 1 846. Pse e them këtë? Ne kemi gardianë, ne kemi punëtorë socialë dhe ne kemi qëllim si Ministri e Drejtësisë, si gjykata, si drejtësi në Kosovë që ata njerëz të risocializohen. Do të ishte ofendim për punën e gjithë atyre që janë në burgje, që punojnë këtu dhe të thuhet që vetëm 4 veta meritojnë amnisti brenda një viti. Dhe, unë po ua përmendi 3 kategori, që besoj se pajtoheni me mua.

Ka në burgjet e Kosovës mbi moshën 75-vjeçare, dhe është i vështirë risocializimi i tyre. Ka vende që mbi 75 vjet ose 80 vjet nuk i dënojnë fare. Ka në burgjet e Kosovës të mitur, ata që kanë nevojë të kthehen në jetën e tyre për një delikuencë që e kanë bërë të vogël diku dhe ka në burgjet e Kosovës rreth 64 raste të femrave, e po ashtu mendoj që një pjesë e tyre janë viktimë e traditës sonë ose viktimë e dhunës në familje.

Unë mendoj se këto raste kanë qenë dhe mund të jenë objekt i amnistisë. Çka t'i biem në amnisti këtu? Unë po ju them, për çka ju do të pajtoheni me 2/3, por nuk do t'i sjellim në amnisti disa kategori dhe unë ju ftoj që të mos i bëni asnjëherë. Ato që lidhen me Tribunalin e Hagës, besoj se të gjithë pajtohemi, dhe besoj ka konsensus edhe ndërkombëtar, nuk do t'i sjellim ato që kanë të bëjnë me rendin juridik kushtetues. Kush e shkel rendin juridik kushtetues, nuk duhet ta fitojë amnistinë. Nuk do të vijmë në amnisti ata që merren me terrorizëm, për vrasje të rënda, për krim të organizuar dhe korrupsion, ata që janë pjesëmarrës të dhunës seksuale dhe të dhunës në familje, ata që kanë marrë pjesë në krime gjatë proceseve elektorale, gjatë proceseve zgjedhore. Nuk duhet të amnistohen ata dhe nuk duhet të amnistohen ata të cilët bëjnë dhunë ose krim ndaj medieve.

Të tjerët do t'i diskutojmë bashkë, por nuk është menduar asnjëherë, e them me sinqeritetin më të lartë, e as nga faktorët vendorë, as ndërkombëtarë, që të diskutohet për amnistinë e veriut ose të jugut. Absolutisht, po e them me bindje të plotë, asnjëherë e askush s'e ka diskutuar këtë dhe nuk ka të bëjë amnistia me veri ose me jug. Ka të bëjë me vepra të caktuara dhe ato vepra të caktuara ju, të nderuar deputetë, me 2/3 do t'i miratoni në Kuvendin e Kosovës.

Po e përsëris edhe një herë. Qëllimi i dënimit në një vend është risocializimi i njerëzve. Po e marr një shembull shumë të thjeshtë, dhe më lejoni të jem shumë praktik. Nëse shteti do të mendonte që njerëzit t'i mbajë vetëm të izoluar dhe të mos kthehen jashtë, më mirë është t'i nxjerrë jashtë vendit sesa t'i mbajë nëpër burgje edhe t'i paguajë 28 euro. Por, po ashtu nuk duhet ta krijoj iluzionin për ata që janë në burgje, që do të përfitojnë të gjithë nga amnistia. Jo, por do të përfitojnë besoj ato kategori që është konsideruar se mbajtja e tyre deri më tani është e mjaftueshme që të kthehen në jetë dhe të kontribuojnë si qytetarë të barabartë të Republikës së Kosovës. Por, nuk ka asnjë premisë që të jetë politike për kategori të caktuar, ose në veçanti, po e them, për njerëz që e kanë cenuar ose e cenojnë rendin juridik kushtetues të vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është lajmëruar Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Zoti Kuçi, nuk e di sa më keni kuptuar, por nuk e kisha fjalën për mohimin e së drejtës për amnisti të qytetarëve, sepse e drejta për amnisti ekziston gjithkund. Por, unë më tepër e ngrita si çështje pyetje - a është paraparë që pas këtyre bisedimeve të bëhet amnisti, sepse duket në sfond që është përmendur si njëra ndër çështjet edhe çështja e amnistisë së personave, të cilët tashmë janë të rreshtuar në grupet kriminale serbe në institucionet paralele atje dhe në krimin që e kanë bërë deri më tani.

Pra, a do të ketë apo nuk do të ketë amnisti për këto kategori, e kisha fjalën, e jo për amnisti tjera, të cilat do të duhej të ndodhnin, është e drejtë dhe aplikohen në cilindo shtet. Por, atë që doja ta dëgjoja këtu nga ju, nga kryeministri dhe nga ata që bisedojnë me Serbinë, në kuptimin e mirë dhe pozitiv, do të doja ta dëgjoja fjalën që kurrë nuk do të amnistohet krimi që po vazhdon të ndodhë në veri. Këtu e kisha fjalën. Pra, nuk do të amnistohet krimi që po ndodh në veri, nuk do të amnistohen kriminelët që janë në veri, ta dëgjoja edhe këtë 'kurrën' e vendosur edhe një herë të kryeministrit dhe këtë fjalë kryeministri ta mbante edhe në të ardhmen.

Pra, nuk paragjykoj, nuk dua të paragjykoj për mirë as për keq në këtë rast, por do të doja ta dëgjoja fjalën 'kurrë' dhe kjo fjalë të mbahet, pra do të ketë apo nuk do të ketë amnisti dhe legalizim të institucioneve të Republikës së Serbisë në veri.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-republikë, zoti Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Zoti Selimi, ju ma dhatë një shans të mirë që ta jap një sqarim lidhur me amnistinë që po përmendet. Është bërë debat edhe në media, është bërë debat edhe në Kryesinë e Kuvendit, se është hapur dilema se tani kjo amnisti po përgatitet vetëm me qëllim që të bëhet diçka me veriun. Nuk është e vërtetë! Krejt çështje tjera!

Ju po e përmendni fjalën 'kurrë' dhe unë po ju them: është sukses i madh dhe është vullnet i mirë që kurrë nuk do të kenë amnisti ata që nuk i voton Kuvendi me 2/3 dhe mendoj se kjo është esenca kryesore për secilin rast dhe për secilën vepër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryesues, zoti Haliti!

Deputetë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

Unë dëshiroj fillimisht të ju falënderoj të gjithëve për debatet tuaja sa i përket këtij procesi të ndjeshëm, nëpër të cilin jemi duke kaluar.

I falënderoj të gjithë diskutuesit mbështetës të këtij procesi, do të thotë mazhorancën, Lidhjen Demokratike, AAK-në, natyrisht me pyetjet që u parashtruan këtu, sugjerimet, por edhe shqetësimet në të njëjtën kohë, që janë shumë legjitime, meqë i ndajmë shqetësimet e përbashkëta, por ajo që dëshiroj të theksoj përsëri është se tash kanë kaluar 6 runde të takimeve. Ne kemi qenë në këto takime me platformë të qartë, me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kosova kurrë ndonjëherë në historinë e vet nuk ka

qenë më e përgatitur dhe në nivel më të lartë dhe të barabartë me Serbinë për takime të tilla. Nuk ka qenë kurrë ndonjëherë më e përgatitur, sepse ka pasur dhe e ka Kushtetutën e vet për herë të parë të shtetit, i ka ligjet e veta, i ka standardet evropiane dhe përfaqësimi është në nivel të barabartë shtetëror ndërkryeministrior, me simbole shtetërore.

Në anën tjetër, jam shumë i vetëdijshëm se ka opinione të ndryshme në Prishtinë dhe në Beograd, që janë krejt të natyrshme. Unë e përmenda edhe më herët se ka pasur opinione të tilla edhe më herët. Ndryshe është folur në Prishtinë dhe ndryshe ka qenë realiteti, në fakt, në Prishtinë dhe gjithçka tjetër është folur në Beograd.

Unë nuk dëshiroj të futem në histori, por ju i keni të freskëta kujtimet vetëm të 15 vjetëve të fundit se çka është deklaruar në Beograd dhe cili ka qenë realiteti në Kosovë.

Në qershor të vitit 1999, kur u largohej ushtria dhe policia serbe, Slobodan Milosheviqi e deklaronte fitoren e Serbisë në Kosovë. Edhe në takimet e Vjenës, Koshtunica e deklaronte fitoren e Serbisë në Vjenë. Kështu ka qenë!

Prandaj, edhe sot, Tomislav Nikoliq, president i Serbisë, e deklaroi një fitore të Serbisë në këto procese që po i kalojmë. Kështu që janë personazhe të ndryshme të një mentaliteti tradicional të Beogradit, që humbjet t'i komentojnë para opinionit të vet sikur po shënojnë fitore historike. Por, realiteti është krejt ndryshe.

Në anën tjetër, u drejtuan pyetje edhe për mua. Unë i falënderoj të gjithë ata që parashtruan pyetje, i falënderoj edhe ata që dhanë sugjerime, edhe rekomandime, edhe këshilla, dhe secilin prej tyre maksimalisht do ta respektoj. Por, do të ishte në të njëjtën kohë shumë me rëndësi që disa deputetë që vijnë prej grupeve të ndryshme parlamentare, disa çështje edhe që janë specifike, natyrisht është e drejtë të më drejtohen edhe mua, dhe unë do të jap përgjigje vazhdimisht, por t'ua drejtojnë edhe liderëve të tyre politikë që i aprovojnë gjërat në takime të mbyllura dhe pastaj kur të vijnë këtu deputetët e tyre prezantojnë diçka tjetër. Kjo është e vërtetë!

Fjala është për të gjithë ata që takohemi vazhdimisht si liderë politikë dhe pajtohem për të gjitha, ndërsa këtu dalin zëra të ndryshëm të spektrit politik. Sido që të jetë, është demokratike, është legjitime dhe demokraci. Por, nuk dëshiroj të flas me emra dhe me parti. Unë ju falënderoj të gjithëve për mbështetje, sepse është një frymë shumë e mirë e konsensusit.

Gjithashtu, u tha se kryeministri i Kosovës është lehtësues në këtë proces. Në fakt, do të ishte një fuqi e madhe për Kosovën sikur ta kishte këtë rol lehtësues, sepse atë rol lehtësues dhe rol udhëheqës e ka baronesha Eshton, me mbështetje të plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që ndërmjetësojnë takimet ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Këtu, ju e dini se ka pasur opinione të ndryshme që prej fillimit. Unë nuk dëshiroj t'i personalizoj gjërat me askënd, por realisht ndonjëherë është tepruar me ekzagjerime të

ndryshme, me paragjykime të panevojshme, me keqinformim të opinionit dhe në të njëjtën kohë duke tentuar që të krijohet vazhdimisht mjegull për këtë proces. Mirëpo, unë dua të ju them se kurrë ndonjëherë, asnjë rrethanë e tillë që është zhvilluar ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë nuk ka pasur transparencë më të madhe dhe më të plotë.

Në momentin që do të kemi dokumente të shkruara si propozime, Kuvendi i Kosovës do t'i ketë në duart e veta. Liderët e Kosovës do t'i kenë në duart e veta dhe do t'i japin opinionet e tyre për dakordim ose jo, gjithmonë duke pasur parasysh respektimin e plotë të Kushtetutës dhe ligjet e Kosovës. Dhe, unë ju siguroj se kurrë ju nuk do të keni dokument në duart tuaja që do të vjen nga Brukseli nëpërmjet meje, e që nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Kështu që do të jua lehtësoj atë punë.

Por, gjithashtu, unë diskutimet emocionale të askujt s'mund t'i menaxhoj dhe natyrisht edhe paragjykimet askujt s'mund t'ia tejkaloj, se duhet t'i tejkalojë vetë. Këtu u dëgjuan edhe dezinformata, në të njëjtën kohë, dhe natyrisht se këtyre dezinformatave, e kam obligim edhe kushtetues, edhe ligjor, edhe qytetar, edhe kombëtar që t'u përgjigjem.

Atyre që nuk kanë besuar as në Rambuje, unë nuk di çfarë përgjigje t'u japë sot, meqë thoshin atje po arrihet një kompromis me Serbinë. Në veçanti, ata që janë ligështuar edhe në Rambuje dhe ata që s'i kanë besuar Rambujesë, se ka pasur të tillë që janë ligështuar edhe në Rambuje dhe pas dy ditësh kanë thënë 'hajde, e pranojmë autonominë'. Kurse sot të mos flasin për pavarësi, apo se është në rrezik Kosova prej Serbisë. Apo të tjerë që s'i kanë besuar atij procesi hiç.

Këtu i kemi në sallë dy a tre që kanë qenë në Rambuje dhe i falënderoj për mbështetjen dhe për qëndrimin e tyre korrekt dhe konstruktiv dhe shumë të përgjegjshëm.

Por, dua të theksoj se tendenca për të shkaktuar frikë te qytetarët, ankth te qytetarët, pasiguri te qytetarët, është jokorrekte, është e papërgjegjshme, është dëshpëruese. Pse është dëshpëruese? Sepse, ndoshta dikush ka menduar se vendi do të dëmtohet në këtë proces dhe 'hajde tash, ta shajmë Hashim Thaçin'. Unë ju siguroj se edhe vendi nuk do të dëmtohet, e ju mund të vazhdoni ta akuzoni Hashim Thaçin, si të doni. Por, në një moment, do t'ua tregoj edhe vendin, edhe derën kah të dalin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që gjatë gjithë këtij procesi kemi qenë dhe jemi shumë korrekt, jo për hatër të kryeministrit dhe askujt tjetër, por për shkak të obligimit që e kemi si subjekt politik karshi qytetarëve, por konsideroj që nuk është korrekte nga ju të thoni gjëra të tilla, sikur thatë që dikush diçka flet brenda e diçka jashtë.

Unë ju siguroj dhe i siguroj qytetarët që kjo në LDK nuk ndodh, e as nga lideri ynë. Dhe, këtë e dini edhe ju, besoj, zoti kryeministër. Prandaj, e mora fjalën të them që absolutisht nuk qëndron se diçka kemi thënë diku tjetër, e themi diçka këtu tjetër, nëse keni aluduar,

sepse ju i përmendët liderët. E unë po flas me kompetencë, në emër të LDK-së, se kjo nuk ka ndodhur.

Ajo që është në të mirën e vendit, e kemi thënë dhe po e ripërsëris, gjithmonë do të ketë mbështetjen e LDK-së dhe e kundërta, ajo që nuk është në të mirën e vendit, absolutisht, si në takime të mbyllura, si këtu, do ta ketë përgjigjen e tillë çfarë e meritojnë - kundërshtimin tonë. Kjo është ajo që desha ta them.

KRYESUESI: Zoti Thaçi, kundër-replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë me qëllim nuk përmenda as emra të partive, as emra të njerëzve, që të mos kenë mundësi fare për të polimizuar, sepse nuk kemi nevojë. Unë ju falënderoj, i nderuari shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për mbështetjen që ia keni dhënë procesit vazhdimisht, edhe kryetarin Mustafa, edhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, edhe kryetarin Haradinaj, por natyrisht për disa gjëra, unë flas edhe për mazhorancën, mund të diskutohen edhe në grupe parlamentare, sepse ju kemi informuar vazhdimisht dhe tash po ju drejtohem të gjithëve, kështu që ne kemi qenë bashkë në Rambuje, në Vjenë, jemi sot bashkë, do të jemi gjithmonë bashkë për shtetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk i është përmendur emri kurrkujt, realisht, dhe ngadalë, do ta zbatojmë Rregulloren. Si grup parlamentar, njëri, ose Albini ose ti merreni fjalën si replikë. Visar Ymeri, replikë.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Kryesues, i është referuar çështjes dhe kur i referohet çështjes, siç thuhet edhe në Rregullore, ose i përmendet emri, ose i referohet çështjes, ekziston e drejta për replikë, kështu që s'ke të drejtë të na e mohosh atë.

Ku iu referua çështjes sime, kryeministri? Tha që nuk është lehtësues i negociatave dhe po të kishte qenë lehtësues i këtyre negociatave kjo do të ishte një fuqi e madhe që do ta kishte Kosova.

Së pari, unë nuk thashë lehtësues i negociatave, unë thashë lehtësues i zbatimeve të marrëveshjeve që po arrihen atje. Pra, jo që ky po i ndërmjetëson negociatat, larg asaj, ky nuk po paraqitet as si pozicion aty.

Dhe e dyta është që në vetë fjalën e vet, kryeministri pastaj e pranoi, në njëfarë mënyre dhe e konfirmoi atë që e thashë, kur tha se asnjë marrëveshje nuk do t'u vijë nga Brukseli nëpërmjet meje këtu, që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Pra, ky është mjeti që i sjell marrëveshjet këtu. Këtë e thashë unë, nuk e thashë asgjë tjetër.

Sa i përket asaj se kush po dezinformon, ne disa herë ju kemi bërë pyetje, kryeministër, dhe disa herë kemi kërkuar, madje kemi insistuar nga ti, që të jesh më transparent në këtë

proces. Pra, t'i sjellësh dokumentet dhe të tregosh për çka je marrë vesh deri tash dhe si je marrë vesh deri tash. Çka i ke thënë Daçiqit dhe çka të ka thënë ai ty?

Pra, kjo është informata. Ne, në funksion të informatës e kemi kërkuar këtë, por nuk ka informata. Pra, ti po e fsheh. E fshehja e informatës, e së vërtetës, është natyrisht keqinformim i publikut për atë se çfarë po ndodh. Pra, është në vijë me atë që e tha më herët deputeti Krasniqi për fotografinë - tha mund të shihet në fotografi çfarë ka në tavolinë dhe nën tavolinë. Nën tavolinë nuk mund të shihet fotografia, pra ajo çka nuk po e tregon Thaçi është nën tavolinë.

Dhe, çështja e fundit, kryeministër - ky kërcënim i fundit, se do të na e tregosh vendin edhe derën. Unë nuk e di e ke mësuar ti Sami Lushtakun, apo ai ty, por të njëjtën gjë ia thotë ai në telefon Adem Grabovcit për Jakup Krasniqin. "Ja kisha kallëzuar vendin" thotë, "me pas kanë unë". Edhe ti po na e kallëzon vendin! Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Thaçi, replikë apo kundër-replikë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Jo, nuk është replikë. Është vetëm sqarim, se nuk dëshiroj as të replikoj, se ta them të drejtën sa herë flet kurrë nuk të dëgjoj. Të jesh i sigurt! Veç humb kohë kot! As ju dhe as grupin tuaj fundamentalist politik!

Por, ku është frika dhe pretendimi për të futur frikë. Ju keni thënë që Kosova kurrë s'do të fitojë liri Rambuje. Kanë ndodhur bombardimet, lufta e UÇK-së, u fitua liria dhe ndodhi çlirimi.

Jo, vetëm pak, ju lutem! Ju keni thënë, prandaj po jua tregoj vendin me argumente. Me argumente ua tregoj vendin. Ju keni thënë se Kosova kurrë s'do të pavarësohet, madje keni organizuar demonstrata dhe janë vrarë edhe njerëz në emër të asaj që po e mbron kauzën kombëtare se Kosova s'po pavarësohet. Kosova u pavarësua, ndërsa nuk ka pasur nevojë të vriten njerëzit. Dhe për këtë keni përgjegjësi, edhe morale. Po, po keni përgjegjësi. Për tjerat, është çështje tjetër.

Keni nxjerrë njerëz në rrugë në emër të asaj që Kosova nuk do të pavarësohet nga procesi i Vjenës. Madje, edhe keni shkaktuar gjakderdhje.

Tash është e diskutueshme, jo reagimi i Policisë, jo reagimi i UNMIK-ut, reagimi... Më vjen keq prej familjeve të atyre njerëzve dhe përulëm me respektin më të lartë për familjet e tyre dhe për jetën e atyre njerëzve.

Tash, pavarësia ndodhi.

(Reagime dhe komente nga salla)

Mësohu të dëgjosh tash! Thashë, dëgjo! Mësohu të dëgjosh! Në anën tjetër...

KRYESUESI: Ju lutem, qetësi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Në anën tjetër, ne kemi qenë shumë mirë bashkë, krejt skena politike kosovare dhe kemi qenë në opozitë, e kemi ndihmuar Qeverinë, atëherë LDK-AAK-minoritar, në interes të shtetit. Jeni përbetuar se s'do të bëhet kurrë pavarësia. Është fakt se realiteti ju ka demantuar dhe kurrë nuk ia keni qëlluar.

Keni thënë se Kosova po ndahet. Ku është ajo ndarje? Prandaj, këtu jua tregoj vendin juve. Dhe, jua tregon qytetari i Kosovës, skena politike dhe miqtë tanë ndërkombëtarë. Keni thënë që për Kosovën do të ketë status special. Ku është ai status special? Këtu jua tregoj vendin unë, ua tregojnë qytetarët, skena politike, miqtë ndërkombëtarë.

Keni thënë për Kosovën se do të ketë autonomi. Ku është ajo autonomi? Ju duhet t'i kërkonti falje qytetarëve për gënjeshtat, për shpifjet, për tendencat për të krijuar ankth, panik, frikë. S'mund të krijoni!

Keni thënë do të ketë Ahtisari plus. Ku është Ahtisari plus? Keni thënë që për Kosovën do të ketë enklava. E keni akuzuar Lutfi Hazirin, deputetin e nderuar, zi e terr keni folur për të. Edhe sot i kemi komunat funksionale. Po, po!

(Reagime dhe komente nga salla)

Ne kemi qenë opozitë, kemi punuar bashkë. Sot i kemi komunat funksionale. Keni thënë që do të jenë enklavë Shtërpca, Graçanica, Ranillugu, Klllokoti. Dua të ju them, dhe jua tregoj vendin këtu, përsëri po them - kurrë nuk ia keni qëlluar bash për kurrgjë, zhurmë të madhe keni bërë, dhe kurrë nuk do të mundni t'ia qëlloni për kurrgjë, se thjesht s'keni as ide, as projekt, as vizion, përpos mllëfit, agresivitetit, arrogancës dhe nervozës. Prandaj, unë ju ftoj që t'i shikoni gjërat më ndryshe. Është mirë që keni hyrë në Parlament, është mirë që e keni akceptuar dokumentin e Ahtisarit, por kuptojeni se Kosova është duke ecur më shpejt në hapat e saj drejt konsolidimit të shtetit, drejt integritimit në NATO, në Bashkim Evropian dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ndërsa paaftësinë tuaj Kosova nuk mund ta presë dhe Kosova do të ecën përpara me hapa të sigurt. Ju mund të reagoni në mënyrë agresive, arrogante. E di që sot jeni shumë të dëshpëruar se nga ajo që e shoh, nga ky agresivitet juaji e shoh se keni pritur që Kosova do të dëmtohet, e ta akuzoni politikën. Kosova nuk do të dëmtohet! Ju mund të akuzoni, mund të shpifni, mund të bërtisni. Është në edukatën tuaj familjare, apo në edukatën tuaj personale. Shteti i Kosovës do të ecën përpara me mbështetje të plotë të qytetarëve të vendit. Qytetarët e vendit i kanë zgjedhur institucionet, u kanë besuar institucioneve të veta. Atje nuk ka takime personale, ka takime ndërmjet përfaqësuesve të shtetit të Kosovës dhe Serbisë, prandaj edhe një herë, të nderuar deputetë, ju falënderoj shumë për mbështetjen tuaj në këtë proces. Kemi qenë bashkë, do të lëvizim bashkë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Së pari, intervenimin e NATO-s nuk e ka sjellë suksesi i Rambujesë dhe i dokumentit të Rambujesë, por dështimi i Rambujesë. Pra, intervenimi i NATO-s vjen pasi dështon Rambujea, jo pasi ka sukses.

E dyta, unë kam qenë kundër dokumentit të Rambujesë, sepse aty flitet për autonomi për Kosovën në kuadër të Serbisë e në kuadër të Jugosllavisë dhe për shkak se flitet për çarmatosjen e UÇK-së. Unë kam qenë kundër çarmatosjes së UÇK-së.

Ju nuk jeni njeri i luftës. Ju jeni njeri, i cili e keni çarmatosur UÇK-në. Pra, pozitat që i keni marrë në politikë është se, nën një, i keni braktisur shqiptarët në Mal të Zi, në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoninë Perëndimore, e jeni kufizuar veç në pavarësinë e Kosovës, e keni shkelur betimin e UÇK-së dhe, e dyta, për shkak se e keni çarmatosur UÇK-në. Kur e keni çarmatosur UÇK-në, ata u kanë thënë 'e tash ju bën të bëheni edhe kryeministër i Qeverisë së Përkohshme'.

Dhe, ju vetë keni qenë kundërshtari më i madh i Rambujesë, deri në momentin e fundit. Më së shumti ju e keni kundërshtuar Rambujenë! E çka ju kanë bërë në fund, nuk e di.

Xhejms Rubini thotë që keni pranuar të luani në një film në Hollivud. Domethënë, nuk e di çfarë ju kanë bërë në fund, por kundërshtari më i madh keni qenë pikërisht ju.

E sa i përket 10 shkurtit, vrasjen e ka bërë policia e UNMIK-ut, ndërkaq ju, jo vetëm që e keni mbështetur dhe e keni përgatitur politikisht atëherë, por këtë gjë po e bëni edhe sot, pas 6 vjetëve, dhe kjo është për të ju ardhur turp!

KRYESUESI: Zoti Thaçi e ka fjalën. Nuk ka të tjerë diskutues. Ta keni parasysh këtë!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Se a ka pasur sukses Rambujeja, apo jo, flet realiteti. Se a ka dështuar Rambujeja apo jo, e dinë të gjithë qytetarët e Kosovës, e di e gjithë bota, e di Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-ja.

Suksesi historik i shqiptarëve ka filluar në Rambuje, kur Kosova ka arritur marrëveshje me bashkësinë ndërkombëtare dhe pas kësaj marrëveshjeje me bashkësinë ndërkombëtare, ka ndodhur bombardimi. Por, edhe pa luftën e UÇK-së nuk do të kishte ndodhur as Rambujeja, nuk do të kishin ndodhur as bombardimet, as liria dhe as çlirimi i Kosovës.

Prandaj, ju jeni deklaruar se kurrë nuk do të ndodhë liria e Kosovës, nuk i keni besuar as faktorit UÇK, as skenës politike kosovare, nuk i keni besuar as Bashkimit Evropian, as Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat sot i quani okupatore, për çka duhet kërkuar falje edhe qytetarëve të Kosovës, edhe këtu. Nuk i keni besuar as NATO-s dhe ju, e dinë qytetarët, keni deklaruar se Kosova nuk do të pavarësohet nga procesi i Vjenës, e shumë e shumë gjëra të tjera. Keni thënë përsëri që Kosova do të ndahet, do të ketë status special, autonomi, Ahtisari plus, zi e më zi, e bosnjëzim. Unë ju them përsëri, mësohuni dhe merreni pak energji negative në këtë Kosovë të pavarur dhe sovranë. E di se ju ka mbetur goxha merak të dëshmojeni, por e keni pasur mundësinë edhe të dëshmojeni dhe jeni treguar të ligj atëherë, prandaj sot përmirësohuni.

Prandaj, të nderuar deputetë, edhe një herë unë ju falënderoj shumë për mbështetjen tuaj, për përkushtimin tuaj. Ju faleminderit shumë për punën e përbashkët që po e bëjmë, por

nuk do t'i gëzoheni dështimit të Kosovës se ky dështim nuk do të ndodhë. Prandaj, e di se do t'i kaloni edhe goxha kohë të dëshpëruar, por është vendimi dhe është zgjidhja juaj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

Faleminderit të nderuar kolegë dhe kolege!

Kjo pikë e rendit përfundoi. E vazhdojmë me seancën në orën 15:00. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Kasniqi.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i planit të veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Komisioni për Integrimet Evropiane e ka shqyrtuar planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me ndryshimet e propozuara.

Ftoj ta marrë fjalën ministrja e Integritimeve Evropiane, Vlora Çitaku.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush sot për shqyrtim dhe miratim planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kjo është hera e parë që Qeveria dhe Kuvendi në bashkëpunim dhe koordinim të plotë hartojnë dhe miratojnë planin e veprimit në fushën e integrimit evropian.

Kjo reflekton përkrahjen dhe konsensusin politik për procesin e integrimit evropian të Kosovës si dhe rëndësinë e planit të veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në këtë drejtim më lejoni të shpreh falënderimin tim për kryetarin e Komisionit për Integritime Evropiane të Kuvendit të Kosovës dhe Komisionin në tërësi, i cili në vazhdimësi është duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm dhe konstruktiv në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Të nderuar,

Para se të prezantoj para jush Planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, më lejoni t'i them disa fjalë lidhur me kontekstin e përgjithshëm përgjatë përgatitjes së planit të veprimit.

Sot, Kosova është i vetmi shtet në rajon i cili nuk ka marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian. Themelimi i marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit ka marrë formën e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Ky dokument rregullon obligimet e ndërsjella ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve aspirante me qëllim të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Në këtë kontekst, në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian ka publikuar studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës.

Studimi konfirmon se, po citoj: Kosova është kryesisht e gatshme për të filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Megjithatë, në mënyrë që të fillojnë negociatat për MSA, Kosova duhet të vazhdojë zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian.

Në këtë drejtim, Komisioni do të propozojë direktivën negociuese për MSA, pasi Kosova t'i ketë përmbushur kriteret afatshkurtra në fushën e studimit të ligjit, administratës publike, mbrojtjes së pakicave dhe tregtisë.

Më 12 dhjetor të vitit 2012, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme ka marrë parasysh studimin e fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-s dhe Kosovës dhe iniciativën e Komisionit për të propozuar direktivën negociuese për MSA, pasi që Kosova t'i ketë përmbushur kriteret afatshkurtra të cilat janë të identifikuar në studimin e fizibilitetit.

Këshilli do të vendosë nëse do të hapen negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Kosovën, në pranverë të këtij viti.

Në këtë kontekst, menjëherë pas publikimit të studimit të fizibilitetit, nën koordinimin e Ministrisë së Integritimit Evropian dhe Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane, institucionet e Kosovës kanë filluar hartimin e planit të veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Pas një pune intensive dymujore, më 26 dhjetor Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Planin e veprimit për MSA-n.

Plani i veprimit përbëhet nga 200 veprime, implementimi i të cilave do të kontribuonte në arritjen e dy objektivave kyçe.

Nën 1, përmbushjen e kriterëve afatshkurtra për fillimin e negociatave për MSA, dhe

Nën 2, zbatimin e detyrimeve afatmesme që do të merren përsipër nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Plani i veprimit identifikon në mënyrë të qartë objektivat që duhet të përmbushen, masat që duhet të zbatohen, institucionet përgjegjëse, afatin e zbatimit dhe koston financiare.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ï them disa fjalë rreth zbatimit të Planit të veprimit dhe nisjes së negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Siç e potencova më herët Kosovës i janë vendosur katër prioritete afat shkurtra, përmbushja e të cilave do të mundësonte nisjen e negociatave për MSA.

Në këtë kontekst, që nga tetori i vitit të kaluar, të gjitha institucionet e Kosovës, posaçërisht Kuvendi i Republikës së Kosovës, kanë punuar intensivisht në përmbushjen e kriterëve.

Më 1 mars të këtij viti, Qeveria e Republikës së Kosovës ka dorëzuar raportin përfundimtar mbi përmbushjen e kriterëve.

Raporti në mënyrë detaje shpjegon se të gjitha kriteret afatshkurtra të vëna nga ana e Komisionit Evropian, tashmë janë përmbushur.

Të nderuar deputetë,

Institucionet e Kosovës kanë përfunduar obligimet e tyre për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Tani pritet që Këshilli i BE-s të nisë, të marrë vendim për nisjen e negociatave në qershor të vitit 2013. Kosova ka një rrugë të gjatë dhe të vështirë drejt anëtarësimit në BE, por ky vit është viti më i rëndësishëm në këtë kontekst. Gjatë këtij viti ne formalisht do të nisim një rrugë të gjatë e cila do të kërkojë shumë reforma, shumë punë dhe shumë angazhim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

E ka fjalën kryetari i Komisionit për Integrimet Evropiane, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Kryetar, Faleminderit!

Ministre,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Komisionit Parlamentar për Integrimet Evropiane dhe në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, si dhe shkresën e kryetarit të Kuvendit të datës 5 shkurt, t'ï ju rekomandoj që ta votoni planin e përbashkët për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili jep edhe shtatë rekomandime për të përmirësuar apo për të rregulluar raportin ndërmjet Qeverisë, gjegjësisht Ministrisë për Integrimet dhe Komisionit apo Kuvendit të Republikës.

Këto shtatë rekomandime rregullojnë dhe me vetë faktin që ministrja s'ï paraqiti si çështje që defektojnë në një mënyrë apo tjetër Planin e veprimit, atëherë ne për herë të parë rregullojmë apo ndryshojmë marrëdhënien duke ushtruar rolin e mbikëqyrësit në zbatim, sepse Kosova pas dhjetë vjetëve nga perspektiva evropiane pritet të kalojë në procesin e integrimi evropiane. Ky është dallim i madh.

Hapi më i madh po shënohet tashmë në pritje që Këshilli i Ministrave në pranverë të hershme ta vendosë apo ta rekomandojë Komisionin që të fillojë negociimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-s.

10 vjet është një dekadë e tërë, është angazhim i institucioneve tona, por gjithmonë është përcjell me paqartësi dhe me mekanizma bllokues dhe mekanizma që Kosovën nuk e kanë lejuar shumë të lëvizë drejt integritit. Tashmë po hapet procesi i ndërtimit të këtyre marrëdhënieve me Kosovën dhe BE-n, shpresojmë shumë që përkundër vështirësive dhe ndërmarrjes së veprimeve reformuese të mëdha që pritet të ndodhin, Kosova me kohë do t'i përmbushë kushtet afatshkurtra që janë paraqitur, në mënyrë që vërtet rekomandimi të mund të vendoset në pikëpyetje dhe t'i realizojë detyrat apo obligimet e veta karshi këtij procesi.

Nën dy, unë ju lus, të nderuar deputetë, në veçanti kryetarët e komisioneve parlamentare që ta ushtrojnë detyrën e vet në rritjen e përgjegjshmërisë, të përgjegjësive dhe në veçanti të monitorimit të planit të veprimit dhe monitorimit të ekzekutivit.

Pika më e dobët, në çdo raport progresi dhe çdo raport që del nga Komisioni Evropian për Kosovën, është mungesa e monitorimit të plotë të zbatimit të ligjeve të ekzekutivit, të politikave sektoriale, të vetë sektorit dhe vetë ministrave. Ne duhet të angazhuar sepse nuk ka më mungesë fondesh dhe nuk ka mungesë kapacitetesh për ta ushtruar këtë detyrë dhe monitorimi, rritja e monitorimit shkakton edhe ushtrim të rolit kushtetues edhe rregullon mandej edhe disiplinon ekzekutimin në mënyrën më të mirë në realizimin e detyrave.

Ky plan i veprimit është real, pasqyron gjendjen reale, veprimet konkrete që duhet t'i marrë Qeveria dhe organet tjera kushtetuese duke përfshirë edhe Kuvendin.

Por raporti ynë ndryshon sepse ministrja do të ftohet rregullisht për të paraqitur progres, apo Raportin e Progresit në Kuvend dhe Kuvendi do të ketë të drejtën e komenteve, debateve dhe të kërkesave që lidhen me ushtrimin e kësaj detyre. Por nëse nuk monitorohet mbi bazë ditore puna e ekzekutivit dhe organeve tjera, do të jemi të mangët dhe të pafuqishëm t' i realizojmë detyrat dhe angazhimet tona.

Pra ju faleminderit dhe ju ftoj edhe një herë që në emër të Komisionit, i cili punon në formulën konsensuale në këtë proces ta mbështesim Planin e veprimit dhe të kërkojmë që Qeveria, vërtet të ndërmarrë veprime të domosdoshme dhe në prill rekomandimi të jetë me mandat dhe të hyjmë në një proces jashtëzakonisht të rëndësishëm integrimi për Kosovën.

KRYETARI: Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolege deputete,
Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuara ministre dhe ministër Yagcillar,
Faleminderit për ardhjen tuaj këtu dhe realisht për të raportuar për Planin e veprimit për negociim të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Ashtu siç e tha edhe ministrja, është plani i parë që bëhet plan i përbashkët ndërmjet Qeverisë, por edhe ndërmjet Kuvendit për shkak se ne si Kuvend e kemi pasur paraprakisht edhe planin e veprimit të Kuvendit për Integritim Evropianë kështu që ky është një plan i përbashkët për të cilin do të punojmë bashkërisht të dy institucionet, legjislativi por edhe ekzekutivi.

Ndoshta pak më tepër do të ndalem tek puna e Kuvendit, konkretisht te Komisioni për Integritim Evropianë, ku ne si anëtarë të Komisionit, domethënë, kemi shtruar disa herë nevojën e ekspertëve të cilët do të ofrojnë edhe ekspertizën e tyre karshi këtij procesi jashtëzakonisht të ndjeshëm të integritimeve. Po ashtu, Komisioni për Integritim Evropianë po bën punën e tij, për shkak se ne vazhdimisht kemi në raportin ministrit e linjes të cilët, do të thotë, raportojnë për të arriturat, por edhe për sfidat me të cilat do të thotë po përballen këto ministri të linjes.

Dhe, në fund, të nderuar kolegë deputetë, unë ju ftoj që bashkërisht ta miratojmë këtë plan të veprimit për negociim të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E falënderoj ministren për paraqitjen e këtij raporti. Mendojmë si LDK që është hap pozitiv që për herë të parë ky plan vjen edhe për miratim në Kuvend dhe natyrisht që do të jenë më se të mirëseardhura edhe komentet e kolegëve të tjerë deputetë.

Mendoj se është e nevojshme që qysh në fillim të sqarohet që shumë prej tekstit të këtij plani thjesht është marrë nga vetë raporti i fizibilitetit dhe ne në Komision nuk kemi pasur mundësi ta ndryshojmë përkundër asaj që mund të mos pajtohem me disa prej tyre, mirëpo është pjesa tabelare në fund që përcakton në mënyrë konkrete obligimet e institucioneve të Kosovës që duhet të analizohet.

Është esenciale që të përmendim që në këtë proces, përveç dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që fatkeqësisht po e merr gjithë energjinë e institucioneve të Kosovës në vend, siç e thashë edhe më herët, të fokusohemi në reforma konkrete në vendin tonë, të përmenden edhe kushtet e tjera që BE-a u ka dhënë të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që këto shtete të kenë marrëdhënie kontraktuale me BE-në.

Dhe në këtë rast, sundimi i ligjit dhe mbajtja e zgjedhjeve të lira e demokratike janë ndër kushtet kryesore, përderisa Qeveria e Kosovës nuk është pro mbajtjes së zgjedhjeve të lira e demokratike, përderisa kemi abuzim të votës, për deri sa nuk ka vullnet politik për të luftuar dukuritë negative e si rrjedhojë kemi edhe ndërhyrje politike në gjykata, pa marrë parasysh cili do të jetë rezultati i dialogut, ne nuk do të mund të ecim përpara në këtë proces.

Prandaj ne si LDK edhe një herë i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që obligimet që dalin nga ky plan i veprimit t'i marrë më seriozisht dhe jo gjithnjë të fshihet prapa deklarimeve e retorikave politike duke ua hedhur fajin të pesë shtetet mosnjohëse.

Ministrja shumë mirë e theksoi që sa i përket ratifikimit të MSA është gjetur një zgjidhje dhe në vend se të shkojë në parlamentet e shteteve individuale do të ketë miratim në Parlamentin Evropian dhe unë mendoj që kjo është një gjë shumë e mirë, sepse nuk do ta bllokojnë shtetet jonjohëse perspektivën evropiane të Kosovës dhe këtë e kanë deklaruar edhe vetë.

Prandaj Lidhja Demokratike e Kosovës, e përkrah këtë plan të veprimit dhe i fton deputetët që ta votojnë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka Visar Ymeri, kryetar i Grupit.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, jemi duke diskutuar natyrisht një çështje goxha të rëndësishme për shkak se të gjithë e dimë që procesi i aderimit në Bashkimin Evropian është një proces tejet kompleks dhe në të vërtetë është e rëndësishme se prej cilit pozicion po nisesh dhe cila është qasja që e ke në të, për shkak se mund të përfundosh në fund të fundit me Bashkimin Evropian, por ka rëndësi edhe si po hyn në Bashkimin Evropian. Pra është shumë e rëndësishme për shkak se e kemi parë që në disa raste janë përdorur dy rrugë të hyrjes në Bashkimin Evropian. Disa prej shteteve kanë hyrë në Bashkimin Evropian sikur shtete që janë zhvilluar dhe e kanë krijuar shtetin e tyre në bazë të parimeve të demokracisë, të ndarjes së pushteteve, funksionimit të sundimit të ligjit, të zhvillimit ekonomik, të mirëqenies së qytetarëve por ka edhe një rrugë tjetër e cila përdoret nganjëherë prej shteteve e që është rruga ta quaj ashtu e të kërrusurit para Bashkimin Evropian që i lutet Bashkimin Evropian për ta pranuar aty. Kjo është rrugë shumë më e gjatë dhe natyrisht që nuk mund të jetë domosdoshmërisht e dobishme për shtetin që aderon.

Pra, ne Lëvizja “Vetëvendosje” e sheh aderimin në Bashkimin Evropian si një proces i përafritimit të qëndrimeve, por edhe interesave ndërmjet Bashkimin Evropian dhe Kosovës dhe për të arritur deri në këtë drejtim, duhet të definojmë së pari cilat janë interesat e Kosovës dhe pastaj që në kuadër të këtyre interesave të Kosovës, në marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian ta arrijmë përafritimin dhe të them ashtu bashkërendimin e aktiviteteve në mënyrë që Kosova të përfitojë nga ky proces i aderimit.

Mirëpo, një gjë duhet ta kemi parasysh të gjithë se procesi i aderimit dhe i bashkëngjijtes në fund të Bashkimin Evropian nuk mund të jetë zëvendësues për zhvillimet e brendshme, siç shpesh ka dëshirë Qeveria të na e paraqes.

Pra, në vend që të flasim për zhvillimin e vendit tonë, për zhvillimin e demokracisë, sundimin e ligjit, krijimin e një administrate të fortë publike, zhvillimin ekonomik, pra rritje e eksporteve, zëvendësimin e importeve rritjen e prodhimit, rritjen e mirëqenies së

qytetarëve, përmirësime në shëndetësi dhe arsim, ne flasim për aderim në Bashkim Evropian.

Dhe ta keni parasysh që Bashkimi Evropian nuk mund të na i zgjidhë këto probleme, duhet t'i zgjidhim vetë.

Për sa i përket planit të cilin po e diskutojmë këtu, Lëvizja "Vetëvendosje" po e them tash e ka të pamundur që ta përkrahë këtë plan për shkak se ky plan është kryekëput në njërin anë i bazuar në ato ligje ose pasqyra që e paraqet për Kosovën ky plan dhe me të cilin domethënë po betonohet një lloj pozicioni i Kosovës në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian, është një Kosovë e cila e ka të pamundur të bëhet shtet sovran. Pra, me ato ligjet të cilat kanë kaluar në këtë Kuvend si rrjedhojë e planit të Ahtisarit dhe me tjerat pastaj, Kosova e ka shumë vështirë të bëhet sovran dhe në këtë mënyrë ne nuk konsiderojmë që është e udhës, është e drejtë dhe është e mençur që ta betonojmë tash këtë pozicion në procesin e aderimit të Bashkimit Evropian.

Prandaj kjo është njëra prej arsyeve pse ne nuk do ta votojmë këtë plan sot e jo se e di që tash do të ketë deklarime të ndryshme nga deputetët që thonë se ju jeni kundër Bashkimit Evropian, pra jo që jemi kundër integritetit të BE-s në Bashkimin Evropian, por mendojmë që kjo rrugë që po e zgjedh Qeveria e Kosovës për aderim në Bashkimin Evropian, do t'i shkaktojë më shumë dëme Kosovës se sa që do t'i sjellë dobi.

Çështja e dytë, që vërehet në këtë plan, po flas në përgjithësi për planin, është se është jashtëzakonisht i përgjithësuar. Pra e përmendi edhe deputetja Osmani që një pjesë e konsiderueshme e tekstit është marrë nga studimi i fizibilitetit dhe në këtë përgjigja që i jepën institucioneve të Kosovës karshi këtyre çështjeve që ngritën në studimin e fizibilitetit është një përshkrim i fjalëpërfjalshëm i asaj që thuhet në studimin e fizibilitetit. Pra, nëse aty thuhet që Kosova duhet, ta zëmë, ta forcojë sundimin e ligjit, prapë përgjigja thotë se Kosova do ta forcojë sundimin e ligjit dhe pastaj mund të tregojë se si. Pra, mendojmë se ky përgjithësim nuk sjell kurrfarë dobie në këtë rrugëtim por vetëm sa po i qesim hi syve vetes dhe vetëm sa po tallemi me veten në këtë rrugëtim.

Dhe një aspekt tjetër, plani në disa fusha po flas, nuk po them në të gjitha, po në disa fusha nuk është madje as real, nuk e prezenton situatën reale për çështjen të cilën e mbulon, pra ka një lloj kamuflimi të asaj çfarë ndodh në të vërtetë. Shembull aty thuhet që rritja ekonomike është ngadalësuar gjatë këtyre viteve për shkak të krizës në Eurozonë e kështu me radhë dhe pastaj thuhet që prej vitit të ardhshëm pritet që rritja ekonomike të jetë 5% dhe pritet që eksportet të rriten për 8.2% në vit dhe askund nuk e shpjegon se si do të arrihet kjo. Pra, nuk është çështje inercioni kjo rritje dhe kjo rritje e eksportit nuk do të jetë çështje inercioni nëse nuk ka mekanizma të Qeverisë të cilat do të ndër marrin masa në mënyrë që ta përmirësojnë gjendjen ekonomike atëherë natyrisht se kjo nuk do të ndodhë dhe rrjedhimisht ne jemi duke e paraqitur një pasqyrë, një fotografi të them ashtu të Kosovës e cila nuk është reale as në kushtet për të cilat po flasim dhe nuk do të jetë reale as në të ardhmen po qe se vazhdojmë me të njëjtat politika.

Pastaj, ka aty shumë zotime, të them ashtu të Qeverisë së Kosovës ose të paktën të Ministrisë e cila paraqet planin, për disa çështje të cilat madje as nuk janë kritere as kushte në Bashkimin Evropian. Për shembull është një zotim i verbër aty që do të vazhdojë me procesin e privatizimit do ta bëjmë këtë e këtë, pa e kërkuar kurrkush. Pra, integrimi evropian kërkon zhvillim të vendit dhe ky zhvillim i vendit natyrisht se në bazë të rrethanave merr rrugëtime të ndryshme. Pra ne kemi shtete në Bashkimin Evropian të cilat kanë arritur deri te një nivel i caktuar i zhvillimit ekonomik duke përdorur mekanizma të privatizimit ta zëmë, por kemi edhe vende tjera që kanë vepruar në kundërshtim me këtë logjikë dhe që e kanë zhvilluar vendin duke u bazuar në kompani publike dhe si të tilla prapë e kanë arritur një nivel të zhvillimit ekonomik për shkak se ia kanë përshtatur rrethanave edhe një lloj ideje, vizioni ekonomik i cili ka qenë i mirë për vende të caktuara. Në këtë drejtim konsiderojmë që Kosova nuk do të duhej verbërisht të ndiqte parime ideologjike të dikujt për shkak se kështu mund ta shkatërrojme vendin. Pra do të duhej që Kosova ta paraqiste planin e vet se si do të zhvillohej ekonomikisht dhe në aspektin e mirëqenies shoqërore dhe atë jo për Bashkimin Evropian, por për interesat e veta.

Pra këtu po vihet tek ajo pika në fillim që e ngrita, është interesi i Kosovës ai që duhet të definohet një herë qartë dhe pastaj vetëm kështu mund të shkojmë në Bashkimin Evropian. Po hyrja në Bashkimin Evropian duhet të jetë aderim i Kosovës sovrane në Bashkimin Evropian e jo aderim i një Kosove që tashmë është evropianizuar disi siç po thotë kryeministri në mënyrë që pastaj të bëhet ajo pjesë e Bashkimit Evropian, se ashtu nuk do të hyjë Kosova, por do të hyjë një nomenklaturë e Kosovës e cila madje edhe mund të ketë përfitime nga ky aderim, por assesi populli i Kosovës nuk do të ketë përfitime.

Dhe çështja e fundit që dua ta ngre, e përmenda edhe më herët, domethënë baza në planin e Ahtisarit, kryesisht në ato të drejta që i kanë përfituar pakicatat në Kosovë nëpërmjet planit të Ahtisarit dhe pastaj nëpërmjet ligjeve tjera. Natyrisht se Kosova duhet t'ua garantojë të gjitha të drejtat pakicave dhe për këtë nuk duhet të bëhemi më katolikë se papa, por duhet t'u japim ato të drejta të cilat i gëzojnë edhe nëpër vende tjera nëpër Evropë. Dhe ta kemi parasysh një gjë, ka vende në Bashkimin Evropian sot të cilat i frikësohen nivelit të drejtave që Kosova ua ka dhënë pakicave në vendin e vet. Dhe nëse ne e paraqesim Kosovën si një lloj pasqyre të tillë, e cila në asnjë mënyrë nuk do të mendojë kurrë që ta ndryshojë planin e Ahtisarit edhe kur e sheh atë të dëmshëm dhe jo funksional, atëherë vërtet ne këtu nuk po e paraqesim një Kosovë dinjitoze e cila kërkon të aderojë në Bashkimin Evropian por po e paraqesim një Kosovë të krrysur e cila po i lutet Bashkimit Evropian që ta marrë brenda, e ta keni parasysh që në Bashkimin Evropian nuk aderojmë duke u lutur, po aderojmë duke u zhvilluar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Do të filloj me atë që u tha disa herë gjatë kësaj pjese dhe ajo është një formulë konsensuale e punës ose një konsensus i përgjithshëm për agjendën evropiane dhe besoj

që kjo do të duhej të vazhdojë edhe më tutje, sepse është njëra prej temave mbipartiake ose njëra prej temave që është me rëndësi për interesat nacionale të Kosovës.

Por në të njëjtën kohë, duke shprehur vullnetin tonë që ta miratojmë ose votojmë pro këtij plani të veprimit që është sjell ose është bërë bashkë ndërmjet Qeverisë dhe komisionit përkatës, besoj se secili që ia shtrojmë pyetjen vetes qoftë në mënyrë të zëshme ose qoftë vetëm në vetvete është se a besojmë se këto pika, këto veprime të parapara, rreth 200 veprime të parapara, vërtet do të zbatohen dhe nëse vërtet do të zbatohen, kur do të zbatohen?

Është tepër e qartë se nevoja ka qenë edhe e mëhershme, jo vetëm në këtë moment për të cilin po flasim dhe jo vetëm për këtë fazë, por për secilën fazë dhe secilin plan veprimi. Nuk ka kuptim në këtë plan -veprim nëse nuk është i qartë aktiviteti ose veprimi i paraparë nëse nuk është institucioni ose sektori përgjegjës i paraparë dhe nëse nuk jepet afati kohor për të cilin duhet të zbatohet.

Kjo tash është dhe kjo besoj se është një formë se si mund të matet sukcesi. Duhet ta themi tepër qartë se ne s' duhet ta matim qëllimin, nuk matet qëllimi në këtë punë. Ne duhet ta matim cili është sukcesi. Nuk mund të maten fjalët, nuk mund të maten deklaratat, përndryshe, nëse maten fjalët atëherë të gjithëve na kujtohen ato fjalët, afatet rekorde, që brenda pak ditësh, brenda pak javësh do të plotësohen këto. E kam fjalën kryesisht për kriteret afatshkurtra që na patën ndalur diku rreth tetorit. Dhe u tha tepër qartë se do të ketë afat rekord, para përfundimit të vitit do të plotësohen të gjitha këto. Tash na doli se deri në fund, domethënë në fillim të marsit dhe do të jetë në rregull nëse vërtet janë plotësuar pikë për pikë. Por, e vërteta është se doli afati rekord i mospunës, jo afat rekord i punës dhe i plotësimit të kriterëve. Dhe, prapë po e them, ne nuk duhet t'i matim deklaratimet, nuk mund t'i matim fjalët. Duhet ta matim suksesin. Dhe cili është forma, ose cila është forma për ta matur suksesin? Ne duhet t'i ndërtojmë të gjitha këto të cilat ekzistojnë, mekanizmat për të matur suksesin.

Dhe në të njëjtën kohë, më kujtohet ministrja Çitaku është këtu e ka thënë disa herë dhe personalisht kam besuar se kjo është një drejtim i mirë kur ka thënë se secili ministër, sektori i të cilit ka ndikuar negativisht në plotësimin e shpejtë të kriterëve, po e parafrazoj se nuk po citoj saktë, do të shkarkohet, nuk do të ketë vend në Qeveri.

Realisht po na del se e tërë Qeveria do të duhej të shkarkohet, sepse nuk ka plotësim të kriterëve, sidomos në fushat të cilat nuk janë vetëm të një sektori. Ju lutem, krimi i organizuar, korrupsioni nuk është i një sektori, nuk është e një ministri, është agjendë qeveritare e cila duhet të luftohet.

Ose në total, agjenda e integriteteve evropiane, nuk është kthyer ende në agjendë qeveritare. Dhe këtu mund të bëjmë lojë fjalësh, por e vërteta është se nëse ne kemi një agjendë, është agjendë qeveritare. Kjo praktikisht ose banalisht po mundohem ta them, është që secili zyrtar, bash secili zyrtar i institucioneve, i Qeverisë, i institucioneve tjera, punën e parë në mëngjes e ka atë që lidhet me plotësimin e kriterit të caktuar ose veprimit të caktuar, me afatin e caktuar kohor për integritet evropiane.

A ka ndodhur kjo në Kosovë? Nuk ka ndodhur, prandaj kjo është forma se si mund ta matim qëllimin ose si mund ta matim suksesin, jo vetëm t'i matim deklaratat. Këto janë elementet e përgjithshme, dua me thënë.

Prapëseprapë, gjatë kësaj periudhe ne kemi pasur një raport tjetër të Komisionit Evropian i cili është edhe më i rëndë se sa raportet tjera që kanë ardhur deri tash. Për shembull pjesa e Kosovës, krimi i organizuar dhe korrupsioni në Kosovë po ndikon në sigurinë e brendshme të Bashkimit Evropian. Besoj se kjo ka qenë hera e parë që një fjali e tillë është paraqitur në raportet e Komisionit Evropian për Kosovën. Nuk kam hasur më herët. Dhe është tepër e qartë se është negative.

Po tash të shohim cili ishte ndëshkimi. Kush është përgjegjës, kujt iu dha përgjegjësia për këtë punë që e kemi shtuar edhe një kriter tjetër praktik në fushën tonë?

Pra, edhe një herë po e them, të gjitha këto elemente janë faktet që na shtojnë të mos besojmë se këto veprime do të përmbushen me afat, e le mos të flasim me afat rekord. Nëse ka rekord, ka rekord për mospunë dhe jo për plotësim të tyre. Faleminderit.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministren dhe ministrat që janë të pranishëm këtu,

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Duke marrë parasysh raportimin e ministres në lidhje me planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe kryetarit të Komisionit Parlamentar për Integritet i cili ka ardhur me shtatë rekomandime, besojmë se të gjithë deputetët janë që të dalin mbi vijën partiake që Kosova të jetë pjesë e integriteteve të BE-s dhe njëkohësisht që të plotësohet ky plan i veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Të gjitha rekomandimet që kanë ardhur nga Komisioni Parlamentar, ministresha është këtu, mund të themi se kanë dalë nga Raporti i studimit të fizibilitetit, ku thuhet se për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Kosova duhet t'i plotësojë këto kritere, në bashkëveprim me Bashkimin Evropian. Mirëpo shpresojmë që edhe Kuvendi edhe ekzekutivi, në këtë rast, Qeveria së bashku do të punojnë që ky plan të zbatohet dhe të plotësohen këto rekomandime që në të ardhmen rruga e Kosovës të jetë më e lehtë për Bashkimin Evropian.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah dhe shpreson shumë që të gjithë janë të interesuar që Kosova të jetë më ndryshe dhe të jetë pjesë e BE-s, të mos të jetë një vrimë e zezë brenda Evropës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Vetëm t'ju njoftoj. Prania fizike është 47, prania elektronike 83. Vazhdojmë. Në emër të SLS, fjalën e ka deputeti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanici Samostalne liberalne stranke su razmotrili Akcioni plan za pregovaranje sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju, i mi ćemo podržati ovaj plan. Pozivamo sve poslanike da i oni glasaju za ovaj akcioni plan. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, fjalën e ka Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar raportin me rekomandime për Planin e veprimit dhe negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe ne si Grup parlamentar e përkrahim dhe mbështesim këtë raport, me rekomandimet të cilat kanë dalë nga Komisioni për Integritet Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me deputetët. Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja ministre,

Zoti ministër,

Kolegë deputetë,

S’do mend se ky proces është ndër proceset më të rëndësishme për institucionet, politikën dhe shoqërinë kosovare. Personalisht mendoj që sikur më parë është konsoliduar ky proces në tërësi në vendin tonë, ndoshta që prej vitit 2003, në kohën kur në Konferencën e Selanikut është vendosur të përfshihen krejt vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kur Kosova vetëm pas pak kohësh ka qenë e përfshirë në këtë proces, hera e parë, ndoshta prej atëherë që kemi konsolidimin më të mirë për sa i përket radhitjes së të gjitha institucioneve, të gjitha partive politike, të minoriteteve dhe të gjithëve në proces, edhe pushteteve vendore edhe të tjera dhe si të thuash edhe projektet tona ose planet tona janë më të konsoliduar.

Kur i kemi pasur herëve tjera edhe vetëm si Kuvend dokumentet ose planet e veprimit për partneritetin evropian, unë personalisht kam kërkuar që të ketë një pjesë narrative ose të ketë diçka që do të përshkruajë procesin që të tregojë disa prioritete dhe të tregojë disa sfida dhe të mos e kemi këtu vetëm anën tabelare.

Këtu ne e kemi një dokument, ndonëse mund të diskutohet dhe për diçka që mund të shtohet, po të konsoliduar, përshkruar për të gjitha fushat dhe që paraqet po ashtu edhe sfidat që janë para nesh për të gjitha nivelet, për të gjitha resorët për të cilat plani u dedikohet.

A ka mundësi të shkohet përtej kësaj? Gjithsesi po. Personalisht mendoj që përveç asaj që u tha këtu, edhe ana kohore që unë mendoj është në Planin e Veprimit, e ka edhe kohën kur institucionet që duhet t’i zbatojnë këto, pra periudha kur duhet të kryhen këto veprime. Ka edhe diçka që nuk ka qenë më parë, është edhe kostoja financiare, që është një risi. Mendoj që përtej kësaj mund të shkojë edhe nëse pas këtij plani, në tërësi Qeveria ose institucionet ekzekutive do të bëjnë plane të veçanta për t’i fokusuar prioritetet në tërësi që ta dinim ne në Kosovë a është sundimi i ligjit prioriteti kryesor, a

duhet të vendosim të fokusojmë resurse shtesë vetëm për sundimin e ligjit për të arritur, a kemi ndonjë pengesë të pakapërcyeshme që duhet ta evitojmë, që të bëhen analiza të veçanta për t'i organizuar sa më mirë resurset tona për t'i realizuar këto plane, që janë të rëndësishme.

Po ashtu, ndoshta edhe ajo që mund të bëjë të ketë edhe sanksione. Ka detyra që nuk mund të kryhen për arsye të ndryshme dhe ne e dimë se kemi pasur edhe sfida, ka pasur pengesa politike në proces. Por, është e pafalshme nëse një veprim i rëndësishëm nuk mund të kryhet për shkak të papërgjegjësisë të një institucioni, çfarëdo niveli qoftë, komune a ministrie, për shkak të papërgjegjësisë së një zyrtari, për shkak të papërgjegjësisë së një drejtori të pësojë autoriteti i vendit tonë në proces kaq të rëndësishëm dhe vendosja e sanksioneve ose marrja e masave se fokusimi më energjik që të kemi po ashtu edhe masa, si lavdëruese, edhe ndëshkuese për ata që nuk e çojnë përpara këtë proces, do të kishte qenë ndoshta një risi që mund t'i shërbejë në përgjithësi këtij procesi.

Pra, i bashkëngjitëm plotësisht angazhimit në aprovimin e këtij plani dhe po ashtu pajtohëm edhe me kolegun, kryetarin e Komisionit, që thotë se duhet që të gjitha komisionet të angazhohen për implementim, sepse, siç e dini, ky proces nuk i takon për sa i përket Kuvendit, veç një komisioni. Të gjithë ne kemi detyra në planin e veprimit për partneritetin evropian, po ashtu edhe në Qeveri nuk është detyrë vetëm e Ministrisë të Integritetit, por të gjithë resorët, të gjitha institucionet i kanë detyrat e veta për t'i kryer, e në fund të ditës duhet të raportojnë veç e veç. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë me të vërtetë kur i dëgjoj të gjitha këto fjalë të mira për këtë raport të planit të veprimit për Marrëveshjen Stabilizim-Asociimit, më vjen mirë, por nganjëherë më duket sikur ne kemi shumë dëshira dhe sikur po shohim ëndrra mu në pikë të ditës. Është shumë me rëndësi ta kemi një dokument të mirë, por ne duhet ta shikojmë nga aspekti i implementimit në praktikë.

Unë dua të flas sot vetëm për dy pika. E kam fjalën këtu te lufta kundër korrupsionit edhe te kriteret ekonomike, e kjo mandej vlen për gjithë dokumentin, prej fillimit deri në fund. Te lufta kundër korrupsionit, që është pika 1.1.6, merreni me mend çfarë thotë! U tha edhe më herët nga dy deputetë që shumica e tekstit është kopjuar nga raporti i fizibilitetit. Thuhet se fizibiliteti i ka identifikuar këto kritere afatshkurtra, te lufta kundër korrupsionit, që të përmbushen për të filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe ky na qenka miratimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Kosova e ka strategjinë dhe planin kundër korrupsionit, Kosova e ka Këshillin që e ka formuar Presidentja kundër korrupsionit, Kosova e ka një task-forcë që e ka formuar

kryeministri kundër korrupsionit, Kosova e ka EULEX-in këtu, Kosova i ka gjykatat vendore, prokurorinë, hetuesinë. Mirëpo, çka nuk ka? Nuk ka vullnet politik për luftë kundër korrupsionit. Në Kosovë ka korrupsion më shumë se çdo kund tjetër në botë, e unë nuk po shoh këtu asnjë kriter dhe masë konkrete se çka do të ndodhë në të ardhmen. Edhe unë ju them me plot gojën se me këtë nivel të korrupsionit, me këta njerëz të korruptuar nuk shkohet në Evropë.

Te kriteret ekonomike, thuhet që politikat zhvillimore dhe ekonomike të viteve të fundit kanë pasur për bazë ruajtjen e stabilitetit makroekonomik financiar dhe të konsolidimit fiskal. Është shumë e vërtetë. Kjo është ajo në çka Qeveria e Kosovës e ka fokusuar krejt energjinë e vet lidhur me zhvillimin ekonomik. Si e ka ruajtur Qeveria e Kosovës stabilitetin financiar? Ne e dimë të gjithë që nuk ka bankrotuar, mirëpo si e ka ruajtur? E ka ruajtur duke i lënë rrugët në gjysmë, duke i lënë shkollat në gjysmë, duke lënë plot shtresa të popullsisë pa përkujdesje.

Do të thotë në këtë mënyrë e ka ruajtur dhe sipas këtij plani të veprimit, kjo na qenka metodologjia që Qeveria do të vazhdojë tutje ta ruajë këtë stabilitet. Nuk ruhet stabiliteti kështu. Aderimi i Kosovës në BE, të nderuar kolegë, nuk do të thotë zhvendosja fizike e Kosovës në BE, sepse kjo fizikisht është e pamundshme. Do të thotë, përmirësimi i jetës së qytetarëve të Kosovës, i përmirësimit të kualitetit të jetës dhe përmbushja e standardeve, duke iu ofruar standardeve të vendeve që janë anëtare të Bashkimit Evropian. Kështu ne mund të aderojmë në BE dhe unë them: A mund të aderojmë kur të gjithë indikatorët makroekonomikë e tregojnë të kundërtën?

Unë këtu kam shifra nga shumë raporte kredibile, nga Agjencia e Statistikave, raportet e Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Rritja ekonomike në vitin 2008 ka qenë 6,9%, ndërsa në vitin 2012 ka rënë në 2,7%. Deficiti tregtar në vitin 2007 ka qenë 1,4 miliard, ndërsa në vitin 2012 është 2,2 miliard. Cilët na qenkan ata indikatorë dhe ato veprime të Qeverisë së Kosovës që po e përmirësojnë gjendjen ekonomike të Kosovës dhe po i plotësojnë këto kushte dhe këto kriterë që ne t'u ofrohem standardeve të vendeve të Bashkimit Evropian?

Kosova e ka 45% papunësinë, kurse në mesin e të rinjve papunësia është 70%.

Me këta indikatorë, me këtë situatë çfarë ne e kemi, rruga për në BE, jo vetëm që është e gjatë, por duket e pamundshme, e natyrisht se të gjithë ne jemi për atë rrugë dhe jemi në përkrahje të asaj rruge, mirëpo Qeveria ka përgjegjësinë kryesore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën. Nuk është. Atëherë Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Pas shqyrtimit të këtij dokumenti, të këtij plani të veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Aocimit, do të doja që një plan i veprimit për të qenë i suksesshëm apo të jetë real, do të duhej të jetë real së pari përshkrimi i gjendjes ekzistuese, respektivisht të bazohet në të dhënat e sakta të realitetit ku ne jemi. Dhe, unë po flas për ato lëmi të cilat

në komisione i shqyrtoi, siç është çështja e bujqësisë, e mjedisit dhe mendoj që realiteti i gjendjes ekzistuese nuk është paraqitur drejt në këtë plan të veprimit.

Mendoj se nuk është gjendja aq e mirë në bujqësi, apo nuk kemi përparime të asaj natyre çfarë paraqiten këtu. Dua të mos harrojmë që politikat e BE-së, kuptohet që u kushtojnë rëndësi të veçantë subvencioneve, por subvencionet në BE gjithnjë bëhen në përputhje me investimet në fushat tjera, respektivisht në zhvillim rural. Çka ka ndodhur te ne në vitin që shkoi? I tërë buxheti për bujqësi kryesisht është bartur në fushën e subvencioneve, pra paratë kesh në duart e qytetarëve. Subvencioni natyrisht që është i vlefshëm, por nuk e sjell vetëm subvencioni zhvillimin në bujqësi. Është e domosdoshme infrastruktura, është i domosdoshëm ndërtimi i një baze, e cila do ta krijonte një bujqësi intensive në të ardhmen.

Çfarë ka ndodhur në vitin që shkoi? Komplet paratë që kanë qenë të ndara për investimet kapitale, janë bartur në subvencione. Pra, jepen para kesh në duart e bujqve, e investimet kapitale që janë paraparë kanë qenë sistemi i ujitjes, pikat grumbulluese, që janë investime kyçe për zhvillim afatgjatë për në të ardhmen. Natyrisht, këto investime vit pas viti janë tejkaluar dhe tash këto nuk përmenden fare. Paraqitet vetëm një çështje e anës legislative, e cila unë mendoj që është e pamjaftueshme. Sa i përket mjedisit, është e vërtetë që buxheti i ulët i Ministrisë së Mjedisit i pamundëson politikat e mirëfillta mjedisore dhe është e vërtetë që ligjet që i kemi miratuar në fushën e mjedisit janë ligje që përkojnë me politikën e BE-së.

Por, në anën, tjetër ato që thuhet në lidhje me ndalimin e veprimtarive degraduese në lumenj apo në gurëthyes, realisht nuk është plotësisht e vërtetë. Edhe te çështja e lumenjve nuk ka qenë plotësisht e suksesshme kjo ndalesë, por edhe sa i përket çështjes së gurthyesve vetëm sa është shtuar numri i gurthyesve dhe një dukuri e tillë vetëm sa po shkon duke u rritur gjithandej. Prandaj, edhe në këtë aspekt mendoj se nuk jemi në një situatë drejt të paraqitur.

Po ashtu, do të duhej që të bëhej një punë tani prej, po i drejtohem, në fund të fundit, edhe BE-së edhe politikës së Komisionit Evropian në Kosovë.

Ekziston një projekt masterplan për Brezovicën, të cilën e ka bërë si projekt ideor Komisioni Evropian. Dhe, ai projekt është paraparë të bëhet në parkun nacional, respektivisht në zonën strikte të parkut nacional, ku në atë zonë janë të ndaluar prerjet e pyjeve, e posaçërisht është i ndaluar krijimi apo ndërtimi i fshatrave turistike. Fshatra turistike, siç e kemi parë në Prevallë, nuk sjellin zhvillim.

Prandaj, e kemi një lloj sinjali të dyfishtë nga Komisioni Evropian. Ata do të duhej që tash të sqarohen, meqenëse në këtë pikë Ministria e Mjedisit u ka dhënë një përgjigje në atë kohë që ky projekt do të mund të vlente jashtë zonës strikte të parkut nacional. Megjithatë, ky projekt, nën vulën e Komisionit Evropian, ka filluar të merret seriozisht nga ministria, edhe pse është në kundërshtim të plotë me Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Prandaj, do të duhej të qartësoheshin këto gjëra që ne të mund ta kemi pastaj një plan të veprimit të qartë, e rrjedhimisht nuk mund të kemi as plan të veprimit të qartë, kur baza në të cilën ne e trajtojmë realitetin e sotëm nuk është e qartë.

Po ashtu, mendoj që edhe në fushën e shëndetësisë nuk është paraqitur realiteti si duhet. Unë nuk do të hyj në hollësira të mëturshme, përveç se do t'i përmbahem deklaratës edhe të shefit të Grupit Parlamentar, që nuk do ta votojmë këtë plan të veprimit.

KRYETARI: Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Ne sot po e diskutojmë një dokument, i cili na është prezantuar këtu dhe sipas tij ne po ngremë standarde të qeverisjes së Kosovës dhe po e ndërtojmë një shtet modern, i cili do të jetë i gatshëm për t'u afruar apo përafra, siç po përdoret fjala, me Bashkimin Evropian, bile mundësisht të anëtarësohet.

Kjo është ajo ëndrra e propozuar në këtë dokument. Çështja është, cili është realiteti në terren?

Realiteti në terren, sa i përket sundimit të ligjit të ndërtimit të institucioneve demokratike, është i dhimbshëm.

Në kuadër të ndërtimit të institucioneve demokratike, a mund t'i themi sot Bashkimit Evropian se e kemi ndërtuar shtyllën e parë funksionale të ndërtimit të institucioneve demokratike, që janë zgjedhjet e lira dhe demokratike, e që është edhe shtylla e parë e planit të veprimit, të cilin e ka propozuar ministrja.

Mendoj se me zgjedhje të manipuluar dhe me vota të vjedhura nuk mund të themi që kemi ndërtuar institucione demokratike.

Sa i përket sundimit të ligjit, a mund t'i themi ne sot Bashkimit Evropian apo qytetarëve se në Kosovë sundon rendi dhe ligji dhe gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit? Unë mendoj që nuk mund t'u themi, sepse kemi kapje të shtetit, keqmenaxhim dhe keqpërdorim të shtetit për interesa të grupeve të caktuara.

A mund t'i themi sot Bashkimit Evropian se në kuadër të sundimit të ligjit dhe sigurisë, sikur dokumentacioni personal është dokumentacion i sigurt. Ne nuk mund t'i themi këtë sot Bashkimit Evropian, sepse pasaportat e qytetarëve të Kosovës janë manipuluar dhe janë vjedhur dhe sot më shumë se kurë dokumentacioni i Republikës së Kosovës është i pabesueshëm.

A mund t'u themi ne qytetarëve të Kosovës se po ndërtojmë shtet së drejtës dhe siguri për ta dhe po e garantojmë rrugën që ata të lëvizin të lirë në Bashkimin Evropian? Ne nuk mund t'u themi, sepse qytetarët e Kosovës sot me mijëra prej tyre presin para zyrave të ambasadave, kurse kriteret për marrjen e vizave nuk janë lehtësuar, por janë ashpërsuar. Sot edhe zyrtarët e shtetit të Kosovës, kur udhëtojnë jashtë, përveç pasaportës, ftesës,

konfirmimit të hotelit, konfirmimit të aeroplanit, sigurimit shëndetësor, duhet dërguar certifikatën e lindjes, certifikatën familjare, certifikatën e bashkësisë familjare. Krejt këto dokumente për të garantuar që kanë rrjedhë logjike këto dokumente dhe janë të besueshme, sepse pasaporta e qytetarëve të Kosovës sot është e pabesueshme.

Unë i përmenda vetëm dy sektorë, sektorin e demokratizimit dhe ndërtimit të institucioneve demokratike, dhe sektorin e sigurisë, që janë të ndjeshëm dhe janë të manipuluar. Dhe, sot qytetarët e Kosovës para Bashkimit Evropian janë më të denigruar, sot qytetarët e Kosovës dhe shteti i Kosovës nuk është i besueshëm, pikërisht si rezultat i kësaj qeverisjeje të keqe. Dhe, nuk mund të themi se me një dokument që është prezantuar këtu përpara do të ketë përmirësime.

Unë personalisht besoj se nuk do të kemi asnjë lloj përmirësimi, sepse mungon vullneti, sepse mungon angazhimi konkret, sepse nuk është objektiv primar interesi dhe kualiteti i qytetarëve të Kosovës, por objektiv primar është interesi i grupeve, që shpesh janë edhe kriminale. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për dy ministrat e pranishëm,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që ne shumë herë kemi përkrahur këso lloj dokumentesh për hir të asaj që dëshirojmë që Kosova të ecën me hapa të sigurt në integrimin evropian dhe atë euroatlantik, siç jemi mësuar të dëgjojmë.

Unë personalisht e shoh këtë plan të veprimit, ndoshta është hera e parë që është pak më i kompletuar dhe me një qasje serioze, por atë që ne nuk po mund ta tejkalojmë dhe në këtë aspekt Qeveria, si hartues i këtij dokumenti, dhe Komisioni për Integritet Evropian është që duhet të paraqitet identifikimi i saktë i dobësive apo të metave, që ekzistojnë. Se, nëse ne nuk i identifikojmë këto, atëherë nuk e di edhe si do të përmirësohen, me çfarëdo plani konkret, apo çfarëdo veprimi.

Është e vërtetë që ne kemi miratuar legjislacion në harmoni me *aqui communautaire* dhe kemi edhe legjislacion të fuqishëm, që garanton apo duhet ta garantonte respektimin edhe të sundimit të rendit të ligjit, edhe të të drejtave të njeriut, në përgjithësi, por sa po zbatohet legjislacioni i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës? Unë them me përgjegjësi të plotë se shumë pak, apo të themi tërësisht më shumë se ajo që ne e shohim si përditshmëri.

Në dokumentin e paraqitur thuhet se zgjedhjet kanë kaluar me probleme të mëdha. Është mirë të thuhet, jo me probleme të mëdha, por zgjedhjet kanë kaluar me vjedhje sistematike të votave, apo atë që është quajtur në mënyrë “universale” të votave. Dhe, kjo i ka derivuar tash këto problemet në tërësi, për të cilat ne sot po bisedojmë.

Prandaj, nuk kemi çfarë të fshehim. Nuk duhet t'i fshihet edhe opinionit, por nuk duhet të fshihet as bashkësisë ndërkombëtare, sepse ekzistojnë raportet, që ata vetë i kanë dhënë. Dhe, nuk ka më dilema, është bërë edhe bajate kjo tema e vlerësimit, sepse kanë qenë votat e vjedhura, të manipuluar, subjekte politike të dëmtuara e tjera.

E dyta, te roli i privatizimit në Kosovë - Kuvendi i Kosovës e ka thënë shumë shpesh fjalën e vet për privatizimin në Kosovë. Fatkeqësisht, edhe në këtë dokument nuk janë qartësuar të metat dhe synimi i përmirësimit të asaj. Vetëm shikojeni fjalën e kuvendarëve në Kuvendin e Kosovës, identifikimin e problemeve, kimit, korrupsionit, procesit të privatizimit dhe atë çka thuhet në këtë dokument. E, kush qëndron prapa atyre?

Kemi edhe akuza publike, krerë institucionalë, qeveritarë, komunalë e të tjerë, që ekzistojnë të përfshirë në këtë problem, ndërsa me ata rreshta që këtu thuhet 'është mirë', është e elaboruar në mënyrë shumë të drejtë, por nuk mund të përmirësohet ashtu.

Për drejtësinë dhe sundimin e rendit ligjor, folën edhe kolegët tanë, folën me vend. Ne nuk mund të përçojmë mesazh të mirë nëse institucionet kryesore të vendit nuk e respektojnë ligjin dhe bëhen pjesë e manipulimeve, shantazheve, kimit dhe korrupsionit.

Ne duhet ta sqarojmë vjedhjen në Dhomën e Dëshmive, që ka ndodhur në Policinë e Kosovës. Nuk mund çfarëdo dokumenti, as Evropa, as Policia, as hetuesia, as Qeveria ta mbyllë apo ta fshehtë këtë çfarë ka ndodhur. Nuk mund kurrkush që vjedhjen e Dhomës së Dëshmive në Pejë ta mbyllë, as ta fshehtë. Çfarëdo dokumenti i mirë që është, edhe nëse janë deputetë të Parlamentit të Kosovës, që qëndrojnë prapa tyre, drejtësia, herët a vonë, do ta thotë fjalën e vet. Por, është më mirë që këto të jenë pjesë e qartësimit të dokumenteve, sesa ne të fshihemi pas tyre. Dhe, kjo është një prej atyre pikave të dobësisë, që po thuhet në vazhdimësi.

Nëse krimi dhe korrupsioni ka depërtuar në Policinë e Kosovës, Kuvendi duhet ta thotë fjalën e vet, apo edhe në Prokurori dhe në gjyqësi. Herët a vonë, Kosova është duke i vuajtur pasojat dhe do t'i vuajë ato. S'po flas për ndërhyrjet politike në sistemin e drejtësisë, se ato po shihen tash. Po shihen nëpërmjet medimeve, do të shihen edhe nëpërmjet Kuvendit, do të shihen edhe nëpërmjet formave tjera qeveritare, ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë, duke filluar nga ato më të ulëtat deri te gjykatat më të larta vendore.

Dhe, e fundit që unë do të them, e që u përmendën, zhvillimi ekonomik, energjia, bujqësia. Të gjitha këto sot në Kosovë çdo i treti banor në fund të ditës duhet të rishikojë shumë mirë se a mund ta mbulojë ushqimin për fëmijët e vet. Ndërsa, çdo i 6-ti, sipas statistikave reale, nuk i ka as ato minimale për ta siguruar bukën dhe ushqimin, apo veshmbathjen për nevojat familjare.

Vetëqeverisja lokale - pse të mos jetë pjesë e këtyre dokumenteve? Ne e kemi një ligj të vetëqeverisjes lokale. E kemi thënë shumë shpesh që kryetarët e komunave janë shndërruar edhe në një lloj pashallëku lokal. Por, të thuhet që edhe kryetarë të komunave kemi të dënuar për krim dhe korrupsion. Kemi kryetarë të komunave që ikin nga

drejtësia, kemi kryetarë të komunave që mundohen të ndikojnë në drejtësi, kemi kryetarë të komunave që akuzohen për të gjitha ato që i përmenda parapraakisht.

Si dëshirojmë ne t'i eliminojmë këto, ose t'i luftojmë, nëse nuk thuhet e vërteta? Atë çka e thotë drejtësia e pavarur, nuk po e themi ne këtu, politika. Mund të akuzohemi se ne po bëjmë politikë, por s'po bëjmë politikë, se e ka thënë drejtësia. Kryetari i Komunës së Kaçanikut është i dënuar për krim, për shantazh, i ikën drejtësisë dhe na del edhe në televizione e në mediumin publik që paguhet prej taksave të qytetarëve dhe thotë - 'institucionet e Kosovës po i dënojnë njerëzit, institucionet e drejtësisë po gabojnë, se unë jam burrë i mirë', sepse pas tij qëndron dikush.

Dhe, Kuvendi nuk duhet të bëhet pjesë e këtyre. Prandaj, të gjitha këto duhet të jenë të shënuara shumë qartë, sepse nuk ka plan të veprimit pa identifikimin e problemeve, sado që ne u japim pasqyrë të mirë, sado që ministrja e Integrimeve merr lëvdata edhe nga Kuvendi i Kosovës për hartimin e dokumenteve dhe për të gjitha, edhe për punën që e bën. Në fund të fundit, e gjithë kjo do të bjerë në ujë, nuk do të shihet fare, nëse nuk eliminohen këto defekte, por këto defekte eliminohen me masa konkrete. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit, Lutfi Haziri e ka fjalën përmbyllëse.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Para se ministrja ta përmbyllë pjesën e planit, më lejoni për hir të korrektësisë t'i sqarojmë disa çështje, sepse shumica e diskutuesve ishin jashtë kornizës së planit për negociim.

Me këtë arsye, se në dhjetor të vitit të kaluar, Këshilli i Ministrave ka rekomanduar pozitivisht pas studimit të fizibilitetit që Kosova duhet të përfshihet në negociata për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit.

Kërkesa që të lihet në mbledhjen e radhës, që është në prill të këtij viti, për të mandatuar fillimin e negociatave, ka të bëjë me kushtet afatshkurta, që duhet plotësuar, e që ministrja raportoi se janë plotësuar. Nuk po flasim për një situatë tjetër, po flasim për një situatë e cila ka marrë vizën. E ka marrë dritën e gjelbër dhe pritet tash mandati për fillimin e negociatave dhe u përmend, po ashtu, se Traktati i Lisbonës ka krijuar rrethanë të re për Kosovën, sepse ratifikimi i marrëveshjes në emër të BE-së do të bëhet nga Parlamenti Evropian, institucioni i vetëm në BE që e njih pavarësinë e Kosovës, që përfshin edhe votat e eurodeputetëve të shteteve që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, sepse mekanizmi deblokues është bërë që Kosova në këtë rast të mos shkojë në parlamente nacionale, por në Parlamentin Evropian dhe institucion i cili e njih statusin e Kosovës.

Praktikisht, plani i veprimit ka marrë apo ka përkthyer kërkesat e studimit të fizibilitetit dhe unë e përmenda me qëllim. Po them edhe një herë, roli i Kuvendit është çmuar, roli i Kuvendit është respektuar. Ju e dini që ai ka kërkuar që Kuvendi të ketë autonomi buxhetore. Dhe, ende po kërkohet formula. Çka nënkupton kjo? Është përmendur njëri prej 7 rekomandimeve që Kuvendi ta ketë të drejtën e autonomisë buxhetore.

Dhe, nën 2, rritja e rolit monitorues të deputetëve. Deputetët duhet ta monitorojnë Qeverinë, duhet t'i monitorojnë organet ekzekutive dhe organet tjera, sepse edhe më tutje po vazhdojnë të përcillen.

Lufta kundër krimit, korrupsionit, vendosja e sundimit të ligjit, implementimi i legjislacionit dhe çështjeve tjera, kanë të bëjnë me rolin kushtetues që e ka Ekzekutivi.

Ne kemi anëtarë pasivë, tre kryetarë të komisioneve në mekanizmin e dialogut për sundim të ligjit, por roli ynë është ta ndihmohet në emër të Kuvendit procesin e vendosjes së sundimit të ligjit, ndërsa mekanizmi ekzekutiv është në duart e Ekzekutivit dhe këtu nuk kemi çfarë të diskutojmë.

Në qershor bëhen 10 vjet prej kur presidenti Rugova, që nuk është më në jetë, dhe kryeministri Bajram Rexhepi janë ftuar për herë të parë në Samitin e Selanikut, i njohur si Samiti i Ballkanit Perëndimor për përfshirjen e Ballkanit në procesin e integriteteve. Prej asaj dite, në qershor janë bërë 10 vjet. Kroacia bëhet anëtare dhe hyn në BE. Për 10 vjet, Kroacia është bërë anëtare dhe po hyn në BE, me krejt telashet që i ka pas. Shqipëria, një vit para Kroacisë, e ka filluar procesin.

Kosova ka mbetur për shkak të statusit deri më 17 shkurt 2008 dhe për shkak të statusit prapë të zgjidhur, pas 17 shkurtit. Për herë të parë, ne po kalojmë prej perspektivës evropiane në integrim evropian. Dhe, ky plan i veprimit duhet të përmbushet pa kompromis.

Ministrja është edhe koordinatore qeveritare e agjendës evropiane dhe nuk duhet pasur kompromis në zbatimin e këtij plani të veprimit, sepse vonesat tash e tutje, vonesat dhe zgjatja e rrugës do të varet kryesisht nga mosrealizimi i detyrave në Kosovë.

Pjesa tjetër, natyrisht që secili prej nesh ka pasur problem me terminologjinë, me përmbajtjen e dokumentit, e me gjithçka tjetër, por ka qenë pjesë e dokumentit, i cili nuk ka mundur të ndryshohet dhe si i tillë, ne mendojmë që me punë dhe angazhim do të duhet arritur që të ndryshohet.

Sot e dëgjova edhe një lajm të mirë, që Kosova do të ftohet me statusin e veçantë në Këshillin e Evropës, statusin e veçantë të mysafirit në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, që është një derë e vogël për hyrje në institucionin më të vjetër evropian, që së paku deputetët apo ne si përfaqësues atje të kemi mundësi ta kemi pjesëmarrjen tonë, përkundër asaj që të drejtat janë më të kufizuara, por një pjesëmarrje aktive ndihmon që procesi të marrë dinamikë.

Unë ju lus edhe një herë! Ministrja do të ftohet për të raportuar për progresin dhe për dështimet eventuale, por pa e kryer pjesën tonë të angazhimeve do të jemi të pafuqishëm për të kërkuar që organet tjera kushtetuese t'i realizojnë detyrat e veta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Prania fizike është 61, me kartela 80 deputetë. Po dua të them që ne folëm për disa fenomene, se një lloj korrupsioni është edhe mosprania e deputetëve në Kuvend.

E votojmë planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me ndryshimet e propozuara nga komisioni.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 44 vota për, 8 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi e miratoi planin e veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me ndryshimet e propozuara.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2013

Programi i Punës për vitin 2013 paraqet një dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Programi është hartuar në bazë të strategjisë legjislative dhe të Qeverisë për vitin 2013; të planeve të punës së komisioneve parlamentare për vitin 2013; si dhe planit të veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që janë miratuar.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2013, e ka shqyrtuar propozim-Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2013 dhe Kuvendit ia ka propozuar miratimin e tij me rekomandimet e bashkëngjitura.

Komisionet, e do fjalën dikush? Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

E kam shqyrtuar me vëmendje propozim-Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2013, i hartuar në bazë të strategjisë legjislative të Qeverisë. Rekomandimet të cilat janë dhënë i përkrah në tërësi, sidomos rekomandimin numër 3, ku bile mendoj se butë keni thënë se nuk sigurohet se mund të miratohen në këtë vit kalendarik projektligjet, të cilat vijnë pas datës 31 tetor 2013, për çka unë mund të them si kryetare, jo që nuk siguroj, por garantoj se 3 ligje të cilat janë të parapara të jenë në komisionin tim, e që janë ligje me rëndësi të veçantë, si për shembull Projektligji për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, Projektligji për mbrojtjen e fëmijëve, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër diskriminimit nuk do të ketë shans që të kalojnë e të miratohen këtë vit.

Prandaj, edhe po them se këto rekomandime i keni bazuar shumë mirë dhe të njëjtat i përkrahim.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarët e komisioneve tjera nuk e duan fjalën. Shkojmë sipas renditjes. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Sala Berisha-Shala është lajmëruar.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk po flas në emër të grupit, se kurrkush nuk ka qenë i interesuar të flasë, por po flas si deputete.

Të nderuar të pranishëm,

Realizimi i këtij programi kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Qeverinë, e cila duhet t'i përmbahet programit legjislativ të Kuvendit për vitin 2013. Kuptohet që bartës të këtij programi, në radhë të parë, janë komisionet parlamentare.

Unë e kam analizuar dokumentin që po e shqyrtojmë tani, e kam analizuar edhe strategjinë legjislativë, që e ka sjellë Qeveria më herët dhe duke e pasur edhe një dokument tjetër - planin e punës së Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, jam munduar t'i shoh e t'i analizoj të tri këto dokumente. Dhe, shihet se dokumentin që e kemi sot, që po e shqyrtojmë, kërkon që plani i punës së Komisionit për Zhvillim Ekonomik të përplotësohet.

Ajo që dëshiroj ta them, se bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe praktikës së punës së komisioneve parlamentare të Kuvendit, Komisioni për Zhvillim e ka hartuar planin dhe në bazë të këtij dokumenti i ka të parapara 19 projektligje t'i shqyrtojë brenda këtij viti, shumica e të cilave na vijnë si plotësim-ndryshime. Si zakonisht, një përsëritje vit pas viti dhe një numër i madh i ligjeve na vijnë si vazhdimësi që kanë mbetur nga viti paraprak.

Ajo që bie në sy, të nderuar deputetë, është se u tha edhe në pikën e mëparshme, se një pikë e dobët që Kuvendi duhet ta dinamizojë punën e vet, është edhe monitorimi se sa po zbatohen ligjet, sa po i zbaton Qeveria dhe aktorët tjerë dhe ne si komision parlamentar e kemi të paraparë, apo kemi monitoruar ligje edhe më herët dhe në bazë të monitorimit të Ligjit për miniera dhe minerale kanë dalë si rekomandime për Qeverinë që t'i nxjerrë dytri ligje nga ai ligj, në mënyrë që infrastruktura ligjore t'u përshtatet rrethanave të Kosovës.

Mua më ka rënë në sy se Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk e ka marrë parasysh një rekomandim të tillë dhe na i ka sjellë vetëm dy ligje në këtë vit. Por shpresojmë se më tutje duhet ta përplotësojë këtë plan të punës dhe ne si komision parlamentar ia kemi parashtruar vetes si aktivitet edhe hartimin e Ligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, i cili është miratuar edhe nga Kryesia e Kuvendit dhe është i paraparë edhe në këtë Program të Punës së Kuvendit.

Dëshiroj që Administrata e Kuvendit ta plotësojë, sepse është një gabim, thuhet "Ligji për shërbime gjeologjike", që dallon nga ajo për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ligjet më së shumti që kanë ardhur si plotësim-ndryshime kanë ardhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe duhet që ne si komision vërtet t'i analizojmë mirë këto gjëra dhe të mos na sillen vetëm sa për të bërë numër të ligjeve, por nëse vërtet është e nevojshme të plotësohen dhe të ndryshohen ato ligje, se sipas tyre janë të parapara disa plotësim-ndryshime, që parashohin t'i anulojnë ligjet në fuqi, e kështu me radhë.

Përndryshe, e mbështetim këtë Program të Punës së Kuvendit për vitin 2013. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kjo pikë e rendit të ditës është e rëndësishme për të gjithë ne, sepse sot po e miratojmë planin e punës, që planifikojmë ta bëjmë brenda një viti.

Unë, pas analizës që ia kam bërë programit, kam shkoqitur disa fakte, që për mua paraqesin shqetësim.

E para, plani i punës së Kuvendit në dukje është shumë ambicioz. Duke u nisur thjeshtë nga shifrat, në këtë vit Kuvendi i Republikës së Kosovës planifikon që t'i miratojë 132 ligje, të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të 22 të tjerave dhe t'i shqyrtojë raportet vjetore të 29 institucioneve, që kinse janë të pavarura e i raportojnë Kuvendit. Madje, janë disa strategji, Buxheti i Kosovës, e ku mbeten debatet, interpelancat e të tjera.

Të nderuar kolegë,

Nëse i marrim vetëm ligjet që i kemi në program, i bie që Kuvendi i Kosovës çdo të dytën ditë ta nxjerrë nga furra një ligj.

Ajo që mua më brengos është se Kuvendi, duke u nxituar, nuk po e bën punën e tij si duhet. Dhe, kjo paraqet shqetësimin tjetër që e kam. Nga 132 ligje, sa ka në program Kuvendi për miratim, 64 ligje janë në plotësim-ndryshim. Secili prej nesh e di që ligjet mund të plotësohen dhe të ndryshohen, varësisht se si e kërkon situata. Por, kur një legjislaturë e kalon 70% të punës së saj duke e plotësuar dhe ndryshuar atë që e ka bërë më pak se një vit më parë, kjo nuk duket aspak e arsyeshme.

Unë si anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa e di se sa herë që komisioni ynë, duke e luajtur rolin e gardianit të Buxhetit të Kosovës, i zhvesh ligjet nga buxheti, nga kostot e tyre implementuese, ato patjetër se do të vijnë në plotësim-ndryshim, sepse si të tilla në praktikë janë të paimplementueshme. Dhe, besoni se rastet e tilla nuk janë të pakta.

E shqetësimi im i fundit, që jam e sigurt se nuk është vetëm shqetësim i fundit, është puna e Kuvendit lidhur me institucionet e pavarura dhe shqyrtimin e raporteve të tyre.

Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ne si deputetë ende nuk e kemi të qartë se çfarë do të bëjmë me institucionet, raportet e të cilave mund të jenë të mangëta si rezultat ose i mospunës së tyre, ose i punës së keqe që e kanë bërë, e raportet të cilat mund të mos kalojnë as në komisionet funksionale, e as në seancë.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë që në njërin nga seancat, Kuvendi nuk e ka votuar raportin e njërit prej institucioneve të pavarura, derisa masat ndëshkuese kanë qenë inekzistuese. I

njëti menaxhment ka vazhduar të punojë edhe sot e kësaj dite, me të njëjtin bord mbikëqyrës, të cilët kanë vazhduar t'i marrin të njëjtat benefite.

Të nderuar kolegë,

Institucionet e pavarura i raportojnë Kuvendit dhe ne jemi përgjegjës, nëse të njëjtat nuk e bëjnë punën e tyre si duhet. Dhe, nëse ne i trajtojmë njëjtë, si ato që punojnë mirë, si ato që nuk punojnë, e tërë përgjegjësia bie mbi ne.

Unë kërkoj që Kryesia e Kuvendit të propozojë masa ndëshkuese. Për shembull: nëse raporti i x institucionit nuk votohet në Kuvend, pse jo të shkarkohet kryeshefi ekzekutiv, ose bordi. Propozime të tilla mund të dalin nga Kryesia, të vijjnë në Kuvend, të diskutohen dhe të miratohen dhe ne të vendosim standarde për punën e institucioneve të pavarura. Ose, standarde të tilla mund të rregullohen me amendamentimin e Rregullores së re të Kuvendit.

Arsyetimi se ne nuk kemi bazë ligjore për ta bërë një gjë të tillë është më tepër se mungesë e vullnetit politik, sepse ne jemi organi ligjvënës në këtë vend dhe mund ta bëjmë një ligj të tillë brenda dy javësh. Të mos harrojmë se numri i institucioneve të pavarura po rritet çdo ditë. Deri më tani, numri është 33, dhe këto institucione po gëlltisnin një pjesë të madhe të Buxhetit të Kosovës, përderisa benefitet që po ia sjellin shoqërisë nuk po shihen askund.

Unë kaq kisha sa i përket programit. Kryetar, kërkoj falje nëse kam dalë ndopak nga konteksti. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albulenë Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht në Programin e Punës së Kuvendit janë paraparë 40 projektligje, të mbetura këto nga programi i punës i vitit 2012. Pra, kjo tregon faktin që me gjithë ambiciet e Qeverisë, të themi kështu, të për të miratuar sa më shumë ligje, ajo po dështon në sjelljen e ligjeve me kohë në Kuvend.

Më tej, prej 99 projektligjeve në këtë program të punës, 65 prej tyre janë në plotësim-ndryshim, pra ligje këto të cilat janë sjellë nga qeveritë e mëparshme, por edhe kjo e fundit, pra tani po sillen për plotësim-ndryshim. Dhe, kjo tregon një shprehje mungese të vizionit dhe planifikimit.

Gjithashtu, kjo ndodh si pasojë e hartimit të projektligjeve pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe pa ndonjë qasje serioze e gjithëpërfshirëse me institucione, që preken direkt apo indirekt nga ligji.

Madje, këtu e marr shembull Projekt-kodin Penal dhe Projekt-kodin e Procedurës Penale, ku si pasojë e anashkalimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ato po vazhdojnë të kenë shumë vështirësi në zbatimin e tyre.

Këtë qasje të mbrapshtë Qeveria duhet ta ndryshojë, në mënyrë që në të ardhmen të mos merremi vetëm me plotësim-ndryshimin e ligjeve, madje pa kaluar viti fare, por edhe të mos bëhen ligjet nga grupet e ngushta të njerëzve në ministritë përkatëse, ose, për më keq, po na sillen nga njerëz të tjerë dhe më pas po përkthehen në gjuhën shqipe.

Më tej, shprehim shqetësimin tonë për mungesën e zbatimit të ligjeve. Pra, edhe kur po miratohen këto ligje, nuk po gjejnë zbatim në praktikë, pasi Qeveria po i mirëmban ato, apo po i mban në sirtarët e vet. Pra, ka shumë ligje, të cilat janë votuar nga ky Kuvend dhe nuk po gjejnë zbatim në praktikë.

Madje, as nuk parashihen masa ndëshkuese në rastet kur nuk zbatohen ligjet për institucionet që janë të thirrura t'i zbatojnë ato. Këtu aspak mirë nuk qëndrojnë as komisionet parlamentare në mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve, pra nuk po e kryejnë një përgjegjësi që e kanë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Ky Program i Punës së Kuvendit është ndarë në dy periudha, pra gjashtëmujori i parë i vitit karakterizohet me futjen në program të 53 projektligjeve, e këtu hyjnë edhe ato 40 ligjet e bartura prej vitit 2012. Dhe, gjashtëmujori i dytë karakterizohet me futjen në program të 83 projektligjeve. Mirëpo, ajo çka është e palogjikshme është që në muajt shtator dhe dhjetor janë të stërngarkuar. Pra, 34 projektligje i kemi në shtator, ndërsa në dhjetor 38 projektligje dhe me një kalkulim të thjeshtë i bie që ne do të shqyrtojmë 1 ligj dhe ¼-ën e një ligji tjetër për çdo ditë.

Kjo shkakton shumë vështirësi në procedim dhe, si rrjedhojë e kësaj, projektligje që janë shumë të rëndësishme do të barten në vitin 2014.

Sidoqoftë, ne si subjekt politik do ta votojmë këtë Program të Punës dhe do të angazhohemi në vazhdimësi për një qasje shumë më serioze në trajtimin e ligjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuari zoti kryetar,

Zonja ministre,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës e ka shqyrtuar programin e legjislacionit që do të kalojë nëpër Kuvend dhe vërejtje jona është se gjatë këtij mandati me të vërtetë kemi pasur më tepër plotësim-ndryshime të ligjeve sesa ligje që e kanë pasuruar legjislacionin në Kosovë.

Gjithashtu, komisionet parlamentare kanë bërë disa monitorime të ligjeve dhe këto ligje, edhe pse janë monitoruar dhe janë bërë vërejtje substanciale, prapë kanë ardhur për plotësim-ndryshime të tyre. Kështu që dua të them se edhe zbatueshmëria e tyre është shumë e vogël.

Prandaj, këto janë vërejtjet që i jep grupi i Aleancës dhe besojmë që në të ardhmen të mos përsëriten. Prandaj, ne e përkrahim këtë program dhe besojmë që zbatimi i ligjeve në këtë vit dhe në vitin tjetër do të jetë më i madh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë sa për sqarim po ju them se parlamentet janë edhe për t'i ndryshuar ligjet. Bile-bile, shumica e parlamenteve më shumë merren me ndryshimin e ligjeve. Por, ne nuk e kemi atë fat, sigurisht. Fjalën e ka deputeti Petar Miletic.

PETAR MILETIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poslanička Grupa Samostalne liberalne stranke razmatrala je Program rada Skupštine Kosova, i ono što bih želeo da kažem na plenarnoj sednici jeste da je ovaj program rada vrlo ambiciozan, da ima preko 130 zakona, preko 30 izveštaja nezavisnih komisija. Dakle, to je oko 170 debata samo do kraja godine, ne računajući druga čitanja.

Mi već ove godine imamo običaj da radimo svaki četvrtak i svaki petak evo danas čak i utorak i bojim se i čak sa ovim tempom rada da mi nećemo uspeti do kraja godine da ispunimo ovaj program.

Onog gde ja vidim prostor da se smanji broj dana koji radimo a da efikasno bude ista ili bolja jeste u broju debata koje održavamo. Dakle mi svake nedelje imamo najmanje jednu debatu koju održavamo u Skupštini a ponekad i dve. Zato ja mislim da bi trebalo ili da postoji telo ili da je to Predsedništvo ili Komisija za zakonodavstvo koja će razmatrati da li treba neka debata da dođe na dnevni red Skupštine, jer dešava nam se da vodimo debatu na bilo koju temu nakon to debate i usvajanje određene deklaracije ta deklaracija postane ne sprovodljiva u praksi odnosno bude nerealna.

Ako budemo svaku političku temu koja se dešava na Kosovu tražili da se vodi debata u Skupštini onda mi nećemo uspeti ni pola ovog programa da ispunimo do kraja godine.

Zato moje predlog da ili Predsedništvo ili Komisija za zakonodavstvo ili neko novo telo koji bi smo formirali razmatra zahteve za debate kako ne bi smo dolazili u situaciju da svake nedelje imamo najmanje jedno a po nekad i dve debate.

Poslanička Grupa Samostalne liberalne strane podržace ovaj programa rada Skupštine i pored ovih nedostataka kako sam naveo.

KRYETARI: Faleminderit, Petar! Po Parlamenti është për të debatuar, ne mund të flasim vetëm në cilën kohë ta lëmë debatin, ndoshta do të ishte varianti më i mirë debatin ta lëmë pas dite prej orës 18:00 edhe kjo mund të shqyrtohet. Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në diskutimin tim do të ndalem një çështje më specifike në propozim programin për punën e Kuvendit, ekzistojnë tri pozicione deri diku të cilat nuk kanë të paraparë afat për shqyrtim të dytë. Për dy edhe mund të ketë ndonjë arsye të veçantë, mirëpo ajo që më shqetëson mua është pika e 6, do të thotë Projekt-rregullorja e Kuvendit ku edhe në këtë

rast përkundër zvarritjeve të vazhdueshme nuk është arritur të vendoset një afat se kur do të vijë në shqyrtim të dytë në Kuvend.

Dihet se për shqyrtim të parë ka qenë më 23 janar të vitit 2012 dhe kanë kaluar rreth 14 muaj nga ajo kohë dhe kjo në fakt përbën shkelje të Rregullores së Kuvendit, përkatësisht nenit 57.

Lidhur me këtë çështje unë e kam komunikuar edhe me Kryesinë e Kuvendit në vijë procedurale të rregullt dhe Kryesia e Kuvendit e ka trajtuar këtë çështje dhe ka kërkuar nga Komisioni për Legjislacion, që të më njoftoj lidhur me këtë procedurë. Deri më tash janë mbajtur diku të paktën tri mbledhje të Komisionit dhe nuk kam marrë asnjë njoftim, mirëpo nuk është shqetësimi a kam marrë njoftim apo jo, shqetësimi është që kjo rubrikë po mbetet e zbrazët dhe kjo nuk jep shpresë fare që kjo shkelje e Rregullores së Kuvendit do të marrë fund një ditë.

Unë kërkoj do të thotë duke u mbështetur në këto nene, në nenin 57 dhe 58 të Rregullores që në këtë seancë të vendoset një afat, qoftë ky marsi më së largu prilli dhe të procedohet me Rregullore të Kuvendit. Nuk di çfarë kredoje morale do të kishim në nëse si Kuvend i shqyrtojmë edhe e monitorojmë zbatueshmërinë e ligjeve nga institucionet tjera në qoftë se ne vetë nuk e zbatojmë një dokument të cilin e kemi miratuar këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2013 është një program pune mjaftë i ngjeshur dhe në kuadër të këtij raporti ky program kam vërejtur se mungojnë dy projektligje të cilat në debatin për sport i kemi votuar si pjesë të rekomandimeve ku obligohet Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komisioni përkatës parlamentar që në afat sa më të shkurtër kohor të përgatisë për miratim Projektligjin për sponsorizim, Projektligjin për objekte sportive dhe menaxhimin e tyre, si dhe Projektligjin kundër huliganizmit dhe luftimit të dukurive negative në sport.

Nga rekomandimet e Kuvendit të datës 21 shkurt 2013, në këtë plan program pune për vitin 2013, është planifikuar vetëm Projektligji për sponsorizim, por janë anashkaluar edhe nuk janë në plan-program dy projektligje tjera, Projektligji kundër huliganizmit dhe luftim të dukurive negative në sport si dhe Projektligji për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre, të cilat janë gjithashtu të votuara me rekomandimet në debatin për sport.

Kur këto ditë kemi një shpeshtim të dhunës, gjegjësisht një shtim të dukurive huligane në sport, gjithsesi se është nevoja për këto projektligje është bërë imediate për funksionim normal të sportit dhe zhvillim të tij.

Andaj, kërkoj nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht nga Komisioni përkatës parlamentar që t'i përvishet punës për përgatitjen e këtyre projektligjeve që ato të jenë pjesë e programit të punës së Kuvendit për vitin 2013.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke dhënë mbështetje këtij programi të punës kërkoj që ai të pasurohet për vitin 2013 edhe me këto projektligje të cekura më herët, do të thotë Projektligjin për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre si Projektligjin kundër huliganizmit. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Po ju njoftoj që grupet prej 6 deputetëve mund të hartojnë projektligje, sidomos projektligje që nuk kanë koston financiare, do të thotë nuk kanë implikime buxhetore.

Kemi 60 deputetë dhe një po na nevojitet për të votuar. Do të thotë prani fizike 61 deputetë, pranie elektronike 75 deputetë. Diskutimet janë kryer, bisedoni me Komisionin që është përgjegjës për hartimin edhe me Arbenin, ai është kryetar i Komisionit. Ju lutem shkojmë në votim. Votojmë Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2013, votojmë tash. Të pranishëm janë 62 deputetë.

Konstatoj se me 57 vota për, 2 kundër dhe një abstenim, Kuvendi miratoi Programin e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2013 bashkë me rekomandimet e Kryesisë së Kuvendit të datës 27 shkurt 2013.

E kam një kërkesë dhe është mirë ta bëjmë si kulturë. Të pranishëm i kemi 62 deputetë, ndërsa votuan 60, është mirë që deputetët e pranishëm ta shtypin butonin dhe të votojnë. Mënyra si votojnë është e tyre, por është mirë ta bëjmë këtë kulturë që gjithë deputetët e pranishëm të marrin pjesë në votim. Jo, ju lutem deputet ti ke qenë në Gjykatën Kushtetuese dhe në një votim që s'ke pasur të drejtë, prania ka qenë sikur sot që ishin 62, por votuan 60. Faleminderit!

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore

Kush dëshiron mund t'ia sjellim edhe transkriptin. Sekretaria e sjell transkriptin e Gjykatës Kushtetuese. Ne po e sjellim transkriptin e Gjykatës Kushtetuese dhe po këqyrim kush ka gënjyer, pra.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Avokaturën Shtetërore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Arben Gashi, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për Avokaturën Shtetërore dhe i ka bërë 19 amendamente, një amendament është i Komisionit për Buxhet dhe Financa të

cilin Komisioni për Legjislacion e ka adaptuar dhe e ka pranua si amendament dhe i rekomandon seancës që t'i aprovojë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetët që janë të pranishëm, le të rrinë në sallë se kemi votimin, praninë fizike. 63 deputetë prania fizike.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 16, propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe i mbështetur nga Komisioni FunkSIONAL.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se më 57 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për Avokaturën e Shtetit.

Përsëri nuk kanë votuar gjithë deputetët, është mirë atyre që s'po votojnë t'ua me heqim mëditjet.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për Fondin pensional të Kosovës dhe ka propozuar një amendament ku me këtë amendament është propozuar të shtohet një nen i ri në të cilën përkufizohet domethënia e operacioneve që janë aktivitete që financohen nga taksa operacionale dhe që lidhen me mbarëvajtjen e funksioneve operacionale të fondit dhe investimeve që janë aktivitete që financohen nga taksa investive dhe që lidhen me aktivitetet e investimeve të mjeteve pensionale.

Ky projektligj është hartuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, është miratuar më 13 shkurt në lexim të parë, pasi janë kryer të gjitha procedurat. Pra, ne kemi bërë një plotësim- ndryshim, një amendament të ri dhe kërkoj nga deputetët ta përkrahin, sepse është përkrahur njëzëri edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, e dëgjuat raportin me rekomandime. Të pranishëm kemi 65 deputetë, është shtuar numri.

Kemi vetëm një amendament, po shkojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Jo. Miratohet.

Votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash. Konstatohet se me 59 vota për, 5 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-101 për fondet pensionale të Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit

Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj kryetaren e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputeten Suzan Novobërdaliu, ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, ka monitoruar zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit duke u bazuar në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2011, Planit të veprimit të miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe natyrisht duke u bazuar në kompetencat të cilat i ka në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Raporti me rekomandime nga Komisioni është miratuar më 18 dhjetor 2012.

Gjatë monitorimit të zbatimit të këtij ligji grupi punues është përkrahur nga OSCE-ja, nga shoqëria civile, nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut për çka edhe shfrytëzoj rastin që publikisht t'ju falënderohem.

Ligji kundër diskriminimit ka hyrë në fuqi në vitin 2004 edhe pse është ligj shumë i rëndësishëm që nga hyrja në fuqi për herë të parë është monitoruar tani nga Komisioni ynë.

Që në fillim të punës Komisioni organizoi seancë dëgjimore me udhëheqësit e institucioneve kompetente për zbatim të këtij ligji dhe me shoqërinë civile me ç'rast konstatuam se ligji për shkak të mangësive dhe paqartësive që i ka si dhe për shkak të mos themelimit të qendrës për trajtim të barabartë e cila qendër sikur të ishte themeluar së bashku me institucionin e Avokatit të Popullit, do të kishte kompetencat kryesore për zbatim të këtij ligji që në praktikë nuk po gjen zbatim.

Andaj, Grupi Punues përgatiti pyetësorët të cilët për plotësim ua dërgoj njësite për të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe lokal, institucionit të Avokatit të Popullit, Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Në pyetësorë u përgjigjen njësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të ministrive dhe komunave të cilat i keni të shënuara në raport.

Përgjigjet në pyetësorë të njësive për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel lokal dhe qendror, Këshilli Gjyqësorë, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë, janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

Pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet kompetente për zbatim të ligjit Komisioni organizoi seancë të dytë dëgjimore ku përfaqësuesit e institucioneve kompetente për zbatim të ligjit si dhe shoqëria civile patën rastin të japin kontributin e tyre duke u ofruar grupit punues dhe anëtarëve të Komisionit propozime në formë verbale dhe të shkruar.

Të gjeturat e Grupit punues në lidhje me moszbatimin e Ligjit kundër diskriminimit janë si në vijim.

Ligji aktual kundër diskriminimit është i pazbatueshëm, përmban dispozita të paqarta si dhe parasheh organin joekzistues të zbatimit, qendrën për trajtim të barabartë.

Dispozitat e pazbatueshme kryesisht janë në Kreun e II dhe të III të këtij ligji.

Neni 7.3 thotë: Pas kompletimit të procedurës së ankesës për diskriminim sipas Ligjit në fuqi mbi procedurat e përgjithshme administrative, ankuesi i pakënaqur mund të paraqet ankesë në pajtim me kapitullin e titulluar Dispozitat e veçanta në Ligjin mbi kontestet administrative në Gjykatën e cila është kompetente sipas ligjit në fuqi. Derisa Ligji për konfliktet administrative i Republikës së Kosovës nuk përmban kapitullin Dispozitat e veçanta. Ligji duhet plotësuar ashtu që të saktësohet procedura dhe gjykatat.

Neni 9.5, thekson që mjetet e grumbulluara nga gjobat do të administrohen nga një organ i caktuar administrativ apo gjyqësorë deri në themelimin e Qendrës për Trajtim të Barabartë. Është e paqartë se cili organ është përgjegjës për këtë, kurse Qendra për Trajtim të Barabartë nuk është themeluar, edhe pse sipas ligjit ka qenë e obligueshme të themelohet.

Neni 10, organet për promovimin e trajtimit të barabartë janë Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Qendra për Trajtim të Barabartë, por me që qendra nuk është themeluar kompetencat IAP-së janë shumë të limituara.

Zyra për Qeveria të Mirë dhe Njësitë për të Drejtat e Njeriut janë organe tjera që trajtojnë çështjen e diskriminimit në nivel qendror dhe lokal. Këtë mandat e morën sipas udhëzimeve administrative numër 04/2006 dhe 2007/8. Ky mandat nuk është i paraparë në Ligjin kundër diskriminimit.

Nga të gjeturat rrjedhin edhe rekomandimet të cilat janë tri.

Qeveria e Kosovës në një kohë sa më të shkurtër të marrë nismën për ndryshim dhe plotësim të Ligjit kundër diskriminimit, i njëjti të hynë në strategjinë legjislative të vitit 2013 dhe të procedohet në Kuvend.

Siç u thashë më herët ky raport ka kaluar në Komision qysh më 18 dhjetor të vitit 2012 dhe këtë rekomandim Qeveria e ka marrë parasysh duke futur në strategjinë legjislative dhe tani në program të punës së Kuvendit edhe pse këtë ligj e ka paraparë shumë vonë çka do të thotë se i njëjti me siguri këtë vit edhe nuk do të miratohet.

Si rekomandim i dytë është se Qeveria e Kosovës gjatë amendamentimit të ligjit të shqyrtojë çështjen e formimit të organeve siç janë: Qendra për Trajtim të Barabartë, themelimi i të cilit organ është paraparë me këtë ligj por asnjëherë nuk është themelua.

Dhe si rekomandim i tretë, Qeveria e Kosovës ta pezullojë strategjinë për zbatim të këtij ligji deri në plotësim dhe ndryshim të njëjtit, sepse kemi pasur informacione se nga Qeveria ka filluar të hartohet një strategji për implementim të këtij ligji dhe kemi bërë vërejtje, sepse kemi parë të paarsyeshme hartimin e një strategjie për zbatim të këtij ligji kur ky ligj edhe ashtu ka treguar se nuk është i zbatueshëm në praktikë edhe këtë rekomandim e ka marrë parasysh Qeveria.

Prandaj, krejt në fund, kërkoj nga deputetët që raportin dhe rekomandimet t'i përkrahin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të Partisë Demokratike, deputeti Kurtan Kajtazi.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e çmon shumë angazhimin e Grupit punues, gjegjësisht Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione për punën që ka bërë rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit ka qenë vlerësimi i zbatueshmërisë së tij në praktikë që nga hyrja e tij në fuqi në vitin 2004 siç e

tha edhe kryetarja e Komisionit, ky ligj nuk është mbikëqyrur asnjëherë deri më tash dhe ne duke qenë si një ndër komisionet e vetme parlamentare që monitorojmë ligjet që kanë të bëjnë në fushën e lirive dhe të drejtat e njeriut, kemi qenë edhe më herët të informuar për vështirësitë rreth zbatimit të këtij ligji në praktikë dhe ligjeve tjera që kanë lidhshmëri me Ligjin kundër diskriminimit.

Gjithashtu, gjatë mbikëqyrjes është vlerësuar edhe përmbushja e detyrimeve që dalin nga ky ligj rreth akteve nënligjore, përputhshmëria e tyre me ligjin të cilat janë pengesat dhe mangësitë e ligjit dhe identifikimi i problemeve që dalin nga ky ligj.

Grupi punues kishte për qëllim të vlerësojë edhe nëse Institucionet e Avokatit të Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë, njësitë për të drejtat e njeriut dhe gjykatat a janë duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj.

Gjatë shpërndarjes të pyetësorëve grupi punues është fokusuar jo vetëm në zbatimin e ligjit, por edhe propozimet eventuale lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e ligjit.

Krejt në fund ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike i mbështesim këto rekomandime dhe shpresojmë që të njëjtat të përfshihen në plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji i cili është i përfshirë tani më edhe në strategjinë legjislativë të Qeverisë së Kosovës për vitin 2013. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDK-së e ka fjalën deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sipas raportit të Ligjit kundër diskriminimit, Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se ky ligj ka dështuar së zbatuari në praktikë. Këtë e themi me plotë përgjegjësi, sepse në praktikë asnjë rast i vetëm nuk është regjistruar që ka të bëjë me diskriminimin e që do të thotë që ky ligj ka mbetur vetëm në letër dhe asnjëherë nuk është zbatuar.

Është shumë shqetësuese fakti se asnjë rast i vetëm i diskriminimit nuk është regjistruar nga institucionet e Kosovës, jo pse në vendin tonë nuk është i pranishëm diskriminimi, përkundrazi në vendin tonë ka diskriminim të hapur, por moszbatimi i ligjit ka ardhur në shprehje si pasojë e mungesës së mekanizmave për zbatim dhe për këtë gjë e kanë fajin Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përkatëse të cilat e kanë pasur për detyrë ta zbatojnë këtë ligj.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se ky raport duhet të miratohet sot nga deputetët e Parlamentit të Kosovës, po ashtu rekomandimet të cilat janë dhënë para se të vijë Ligji për plotësim e ndryshim të zbatohet nga ana e Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes” e ka fjalën Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Tashmë kanë kaluar nëntë vjet nga miratimi i Ligjit kundër diskriminimit, ligji ky i cili ka për qëllim t'u sigurojë subjekteve të drejtën për barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë, barazi të mundësive për të gëzuar dhe ushtruar të drejtat dhe mbrojtje efektive nga çdo sjellje diskriminuese apo që e nxitë atë.

Mirëpo, sikurse edhe shumë ligje të tjera as ky ligj nuk po zbatohet. Shumë nene të këtij ligji janë të paqarta, gjë që ka pamundësuar zbatimin e tij në praktikë duke filluar nga nenet 7, 8, 9 e neni 10.

Si rezultat ka pasur një numër shumë të vogël të ankesave edhe pse dihet që rastet e diskriminimit në Kosovë janë shumë të shpeshta dhe të natyrave të ndryshme.

Në nenin 7.1, nuk është e qartë nëse rastet e diskriminimit do të shqyrtohen dhe të vendosen nga gjykatat e rregullta apo nga organet administrative. Edhe nëse mund të kuptohet se rastet e diskriminimit shqyrtohen nga një organ administrativ, nuk është e përcaktuar se cili organ do të jetë ai.

Në nenin 9.4, parashihet që mjetet e nxjerra nga shqiptimi i dënimeve të parapara me këtë ligj të grumbullohen në një fond të veçantë i cili u dedikohet për ndihmë juridike falas personave fizikë dhe juridikë të cilët ankohen se u është shkelur e drejta për trajtim të barabartë.

Ky nen po ashtu është i paqartë, sepse nuk ka ndonjë udhëzim për personat fizikë apo juridikë që me vendime gjyqësore shpallen të diskriminuar, me çfarë procedure ligjore ata do të mund të iniciojnë kërkesën për kompensim material.

Në këtë ligj po ashtu parashihet edhe Qendra për Trajtim të Barabartë, mirëpo edhe pas nëntë vjetëve që nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kjo qendër nuk është themeluar.

Normat aktuale bëjnë që Ligji kundër dhe diskriminimit të mos gjejë zbatim në praktikë as në organet administrative e as nëpër gjykatat e rregullta, gjë që bën që qytetarët të jenë të diskriminuar nga vetë Ligji kundër diskriminimit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së e ka fjalën deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të mos jesh i diskriminuar do të thotë të jesh i barabartë para ligjit.

Ligji kundër diskriminimit i aprovuar në vitin 2004 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, për shkak të mangësive të caktuara edhe më tutje vazhdon të mos jetë i zbatueshëm në praktikë.

Shtresat e popullatës të cilat janë viktime të diskriminimit janë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, pakicat, individët dhe familjet me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, gratë apo burrat e papunësuar, pensionistët e të tjera.

Nëse shihen të gjeturat në raportin e monitorimit të ligjit nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, është konstatuar se ligji është i paqartë dhe i pazbatueshëm.

Në vend se Qeveria të ndërtojë mekanizma të cilat janë të vendosur në Ligjin kundër diskriminimit siç është Qendra për Trajtim të Barabartë dhe të nxirren aktet nënligjore të parapara në ligj..

KRYETARI: Deputetë, ju lutem zini vendet e juaja se tash shkojmë në procedurën e votimit.

KYMETE BAJRAKTARI: Që ligji të jetë i zbatueshëm edhe në praktikë, këta kanë nxjerrë akte nënligjore të cilat nuk janë të parapara në ligj.

Nëse kalojmë te rekomandimet, ku rekomandimi i fundit është që të pezullohet zbatimi i strategjisë për implementimin e Ligjit kundër diskriminimit, ku më përpara ka ekzistuar një strategji e cila është aprovuar në vitin 2005.

Sipas kësaj strategjie nëse ka vazhduar të implementohet atëherë nuk kemi aspak rezultate.

Para të shumta janë harxhuar nga taksapaguesit tanë për t'i vetëdijesuar ata se nëpër komuna ekzistojnë ose nuk ekzistojnë zyrat tek të cilat ata kanë të drejtë ankese nëse janë të diskriminuar.

Në përgjigje të pyetësorëve vërejmë se nëpër institucionet komunale dhe qeveritare nuk ka ankese nga ana e qytetarëve dhe kjo po i bie se qytetarët tanë nuk janë të diskriminuar. E realiteti është se jo vetëm që janë të diskriminuar, por edhe se ka ligje të cilat ka nene diskriminuese të përmendura në raport.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta votojë raportin e Komisionit për monitorimin e Ligjit kundër diskriminimit dhe kërkon nga Qeveria që në afat sa më të shkurtër kohor ta sjellë në plotësim ndryshim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi për diskutim.

Të pranishëm 63 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit.

Të nderuar deputetë, kalojmë në pikën:

- Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore për periudhën 22 prill 2011 deri më 29 gusht 2012

Pra, këtë e keni hequr nga rendi i ditës me qenë se kur është marrë vendimi për ta venë në rend të ditës kanë qenë gati të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe realisht komisioni është dashur kohë më parë të raportojë për punën e vet. Pastaj edhe sot u fol shumë për zgjedhjet edhe mendoj që është dashur të flitet për raportin e komisionit përkatës.

Kërkoj nga Administrata që deputetëve t'ua shpërndajë transkriptin nga seanca e dëgjimit publik më 5 mars 2013, që ka të bëjë me Ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të miratuar në vitin 2012. Pra, është fjala për transkriptin e Gjykatës Kushtetuese të seancës të dëgjimit publik.

Mirupafshim në seancat e ardhshme!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë